

Zoran Zaevi
Optimizëm për
ftesë në korrik
për në NATO

Fq.4



**ZORAN
KITANOV**
Shkup-Bllacë,
Kitanov kërkon
mirëkuptim!

Fq.5



**S'kishim
kokë,
dhe as
këmbë**

Fq.19



Koha

www.koha.mk



**KOHA për
kulturë**

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3381 · E martë, 5 qershor 2018

15°C | 27°C

15 DEN

EDITORIAL

**Kur Shkodra
e Shkupi
bëhen bashkë**



Ditë më parë në Shkodër u mbajt Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë në të cilin morën pjesë autorë që me kompozimet e tyre kishin sjellë në skenë fëmijët e gjithë hapësirës shqiptare. Pati edhe nga Shkupi. E veçantja e këtij festivali, ishte mikpritja dhe ngrohtësia dashamirëse e nikoqirëve shkodranë, por edhe e mbarë komunitetit të artistëve e pedagogëve të muzikës. Gjatë tri netëve sa zgjati ky Festival, fëmijët dhe prindërit e tyre jetuan çaste...

Fq.2

RAJON

**Pajtim apo
njohje mes
Kosovës dhe
Serbisë?**

Fq.16

GLOBI

**A do të
shpërblehet
Gjermania për
refugjatët?**

Fq.17



PROFESIONALIZMI I MUNGUAR I SHOQËRISË SHQIPTARE

REVOLTË PA EPILOG!



Organizatave adekuate ndërkombëtare dhe institucionet tjera të Bashkimit Evropian si dhe të Kombeve të Bashkuara, fare pak janë të njoftuar me shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Maqedonisë. Mungesën e një sektori civil profesional shqiptar, i cili kryekëput do të merrej me procedimin, analizën dhe arkivimin e rasteve të dyshimta kur shkelen të drejtat e njeriut shqiptar, më së mirë e shpjegon rasti i Almir Aliut

Fq.6

Xhamia në Kodrën e Diellit drejt përfundimit

Tetovë, 4 qershor - Një ëndërr e kamotshme e besimtarëve mysliman të Tetovës me rrethinës për të pasur një objekt kulti fetar të besimit Islam edhe në Qendrën turistike Kodra e Diellit si duket po bëhet realitet. Ndërtimi i xhamisë në Kodrën e Diellit ka arritur në fazën karabina, gjegjësisht në fazën finale të ndërtimit, ndërsa kanë mbetur edhe disa punë të tjera që ky objekt të finalizohet tërësisht dhe të jetë në

funkcion të besimtarëve mysliman. "Kjo xhami ka arritur deri në këtë nivel që është që do të thotë se skeleti i objektit është bërë, është duke u vendosur rryma, kanalizimi dhe uji është duke u instaluar, janë vendosur dritaret. Jemi afër përfundimit të punëve. Deri diku është punuar edhe në ndërtimin e minares, por bazamenti ka marrë kohë, dhe javën e ardhshme do të vazhdohet me ndërtimin..."

Fq.9



EDITORIAL

KUR SHKODRA E SHKUPI BËHEN BASHKË



Emin AZEMI

Ditë më parë në Shkodër u mbajt Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë në të cilin morën pjesë autorë që me kompozimet e tyre kishin sjellë në skenë fëmijët e gjithë hapësirës shqiptare. Pati edhe nga Shkupi. E veçantja e këtij festivali, ishte mikpritja dhe ngrohtësia dashamirëse e nikoqirëve shkodranë, por edhe e mbarë komunitetit të artistëve e pedagogëve të muzikës. Gjatë tri netëve sa zgjati ky Festival, fëmijët dhe prindërit e tyre jetuan çaste të paharruara dhe u larguan nga ky qytet verior i Shqipërisë me përshtypjet më të mira. Publiku ishte gjatë gjithë kohës pjesëmarrës i atmosferës imponante, duke ndjekur me vëmendje të gjitha pikat e interpretimit. Qyteti i Shkodrës ato ditë u shndërrua në arenë gëzimi për dhjetëra fëmijë, të cilët po sprovonin talentin në një konkurrencë të forte, kurse edhe prindërit e tyre u ndodhën nën pushtetin e drithërimit dhe bëheshin me ritmin e emocioneve që jepte kënga në skenë.

Në këtë atmosferë të rrallë festive, nuk munguan edhe dromcat shpirtërore të mikpritjes që lëvizën nëpër kalldërmin e Shkodrës, bashkë me hapin e shkuarës të mysafirëve. Këta të fundit kishin shumë arsye të ndjehen si në shtëpinë e tyre, sepse shkodranët kanë mikpritjen, humorin dhe këngën, tre asetet më të çmueshme etno-psikologjike që vlejnë sa margaritarët e gjithë botës. Krijoheshin miqësi të atypëratyshme midis peronave që për herë të parë shiheshin dhe e kishe vështirë të refuzosh ofertën për kafe, e cila mund të përfundonte në një darkë të stërgjatur buzë Bunës apo rrëzë Kalasë së stërlashtë të Rozafës.

Shkodra ka publik të formuar. Tradita kulturore e këtij qyteti, që daton nga kohët e lashta ilire, për të marrë një dimension më të formuar në vitet e tridhjeta, të shekullit të kaluar, është integruar në vertikalen shpirtërore të banorëve. Fishta, Mjedja, Harapi, Prenushi, Migjeni e shumë emra të nderuar të letrave shqipe i lanë gjurmët e tyre të ndikimit estetik në brezat e mëvonshëm dhe kjo u manifestua edhe në këtë festival mbarëkombëtar. Trajatat e këtij ndikimi mund t'i shohësh gjithkund në Shkodër, kurse kjo mjafton të perceptohet edhe te publiku i ngritur, i cili ishte pjesa integrale e atmosferës artistike të këtij festivali.

Se edukimi estetik i publikut shkodran nuk është i reduktuar vetëm brenda qarqeve kulturore e akademike, dëshmon edhe prania e njerëzve të profileve të ndryshme që nuk kishin ndonjë pikëtakim të drejtpërdrejt me kulturën. Në mesin e këtyre të fundit mund të takosh, si askund tjetër, edhe ndonjë biznesmen i cili ndan disa çaste nga koha e tij e çmueshme për të ndjekur, jo vetëm natën finale, por edhe provat e Festivalit. Është ky një tregues se njeriu shkodran frymon me ritmin e vlerave që sjell arti e kultura dhe mund ta imagjinojmë se çfarë ndikimi mund të kenë njerëzit e tillë mendjendritur në rrethet ku ata jetojnë e veprojnë. Në këtë Festival Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë Shkupin e përfaqësoi edhe vogëlushja simpatike nga Shkupi, Lina Dullovi, me një vokal të ngrohtë e tepër shpresëdhënës. E shoqëruar nga prindërit dhe pedagogu i saj, Lina e la Shkodrën me një bagazh emocionesh, por edhe eksperiencash për ballafaqimet e radhës në këtë arenë të madhe të konkurrencës muzikore. Vetëm në festival të tilla, talentët e vërtetë shkëlqejnë, kurse Lina nga Shkupi solli kandilin e pashuar të Dardanisë së lashtë. Publiku dhe profesionistët e këtij Festivali sigurisht do ta kenë fiksuar këtë kandil si një pikë që tubon shumë referenca përkushtimi për artin e të kënduarit.

Kënga mbarëkombëtare e fëmijëve shqiptarë i bëri për tri net Shkup e Shkodër bashkë. Ky nuk është vetëm refren që mund të shkëputet nga ndonjë këngë, por edhe ide lëvizëse për një integrim brendakombëtar më të avancuar kulturor e shpirtëror. Filozofia e konkurrencës, e kombinuar me galerinë e individualiteteve krijuese mund të kenë pikëpajtim, sa herë që rezoni profesional i njerëzve të artit e kulturës bëhen bashkë me mikpritjen e ngrohtë të banorëve vendas. Në këtë sens Shkodra mund të jetë një model, aty ku prindërit e pedagogët e këtij qyteti e konsideronin si fëmijë të tyre edhe Linën nga Shkupi.

Kjo pra është Shkodra.

GËRDITOLGJIA DHE GËRDITOLGJU

"Viteve të fundit ka zënë fill dhe është duke u zhvilluar një fushë e studimeve shkencore dhe nga kjo edhe një profesion i ri. Fjala është për shkencën e cila në botën anglo-saxone (Britani, SHBA, Australi, Kanadë, Zelandë, etj.) quhet 'Disgustology' kurse njeru (studjesi) që merret me këtë lëmi quhet Disgustologist.

Në gjuhën shqipe këto dy fjalë përkthehen kështu:
1. Disgustology - Gërditologjia: shkencë që merret me studimin e gërditjeve;
2. Gërditologu - njeriu që merret me studimin e gërditjeve.

Gërditologjia ose gërditologu, në mënyrë më të gjërë, studjon efektin që krijojnë gjërat e gërditshme ndaj njeriut. Pra, kjo shkencë ose gërditologu analizon dhe bënë me dije se si ndikojnë gjërat e gërditshme në shëndetin tonë dhe në sjelljet tona njerëzore të përditshme. Gjërat e gërditshme të të gjithë popujt janë: jashtëqitja, vjellja, ushqimi i prishur, lëngjet që kanë dalur nga organet seksuale e kanë mbetur të shihen nga tjerët, pamja e disa shtazëve, njerëzit e papastër, etj.

Por, në rastin e shqiptarëve definicioni i kësaj shkencë duhet të jetë kështu:

Gërditologjia - shkencë që merret me studimin e efekteve që krijojnë gjërat e gërditshme në sjelljet e shqiptarit.

Ndër gjërat më të gërditshme në botën shqiptare janë veprimet politike që shkaktojnë qeveritë gërditëse, të pështira apo të fëlliqura shqiptare të cilat janë duke e çmendur dhe tjetërsuar njeriun shqiptar i cili poashtu luan rol në krijimin e fëlliqësirave në fjalë.

Natyrisht që këtij definicioni mund t'i shtoni edhe ndonjë karakteristikë tjetër gërditëse pasi që ato na kanë kapluar nga të gjitha anët", shkruan në profilin e tij në Facebook, studiuesi në Londër, Daut Dauti.

NGA E THËNA NË TË BËRË...

"Derisa Bujar Osmani bën filma promovimi (pariako-personal) me hartat në dorë dhe luan rolin e projektantit për projekte (në Maqedoninë Perëndimore) që përsëriten çdo vit në buxhet dhe pastaj me Rebalanc të buxhetit hiqen.

Të tjerët po ndërtojnë dhe realizojnë.

T'ja kujtoj Bujar Osmanit që 'nga e thëna në të bërë ka një det të tërë'. Ama kujt t'ja thuash!", shkruan në profilin e tij në Facebook, ekonomisti Visar Ademi, duke komentuar infrastrukturën rrugore që po ndërtohet në Lindje të Maqedonisë, ndërsa stagnon në pjesët e banuara me shqiptarë.

NËSE NUK E KENI DITUR...

CILË ISHTE EMRI I PARË I OHRIT?

Ohri i ka rrënjët në parahistori. Fisi ilir i enkelejve e ndërtoi vendbanimin e parë me emrin Lyhnicos. Ata banonin në këtë rajon që përfshinte liqenin e Ohrit dhe trevat rreth tij. Pas vitit 148, qyteti u bë pjesë e Perandorisë Romake. Më 29 dhe 30 maj të vitit 526, Lyhnicosi u shkatërrua nga një tërmet i fuqishëm. Për fatin e qytetit të lashtë faktet historike nuk japin më të dhëna. Vetëm tre shekuj më vonë përmendet një qytet bullgar me emrin Ohrid, çfarë do të thotë "mbi kodër". Gjatë mesjetës, Ohri ishte qendër e veprimtarisë artistike dhe kulturore e bullgarëve. Në atë kohë, Klementi i Ohrit e themeloi Shkollën e Ohrit. Por edhe Shën Naumi ishte një dijetar i rrënjësishëm i atij institucioni. Në Shkollën e Ohrit mësohej

MEDIACitate

NJË PARTI KUNDËR EMIGRANTËVE FITON ZGJEDHJET



Partia konservatore SDS e ish-kryeministrit, Janez Jansa doli forca kryesore në zgjedhjet parlamentare në Slloveni të dielën duke fituar 24.4% të votave.

Forca e dytë në zgjedhje doli partia anti-sistem e komedianit, Mark Sarec me 12,6% të votave. Partia e kryeministrit të deritanishëm, Miro Cerar doli në vend të tretë me 9,8%. 59 vjeçari Jansa ka bërë të ditur, në rast se do të jetë kryeministri i ardhshëm ai do të izolohet vendin kundrejt refugjatëve. Me këto rezultate priten mjaft vështirësi në krijimin e qeverisë së re në Slloveni. Presidenti i vendit, Borut Pahor ka bërë të ditur se ngarkon fituesin e zgjedhjeve me krijimin e qeverisë së re. Gjatë dhënies së votës në Ljubljana të dielën, Jansa u shpreh se besoj se do të bëhet hapi i parë, që ta bëjmë "Slloveninë një vend, ku slloveni, siguria e tij dhe mirëqenia e tij dalin në plan të parë."

Jansa, që ka qenë dy herë kryeministër slloven në vitet 2004-2008 dhe 2012-2013 ka si udhërrëfyes politik, kryeministrin hungarez, Viktor Orban. Orban bëri fushatë për Janez Jansan në Slloveni. Ai e ka cilësuar Jansan si "garant të mbijetesës së popullit slloven". Gjatë fushatës zgjedhore, Jansa iu referua shpesh krizës së refugjatëve në vitet 2015-2016, kur Sllovenia ishte një vend tranzit për qindra mijëra refugjatë.

(DW, 4 qershor)

gjuha e vjetër kishtare sllave, gjuha më e vjetër e shkruar sllave. Në shekullin e dhjetë, Ohri për 17 vjet ishte në kohën e sundimit të mbretit Samoili kryeqyteti i Perandorisë Bullgare. Atraksioni më i madh i Ohrit është liqeni i tij. Ndër më të vjetrit dhe më të thellët në Evropë, ai tërheq jo vetëm pushues por edhe sportistë, peshkatarë dhe shkencëtarë. Nga kalaja ka një pamje të jashtëzakonshme mbi qytet, liqen dhe deri tek malet rrethuese të tij. Edhe pse vuan nga ndotjet njerëzore, sidomos nga ana e Shqipërisë, ai mbetet një nga atraksionet më të pasur të gadishullit ballkanik. Kalaja ndodhet mbi qytet dhe mbi kodrën kryesore. Kalaja i ka rrënjët në lashtësi, por në formën ekzistuese ajo u ndërtua nga mbreti bullgar Samoili në shekullin e dhjetë.

Renata Deskova nga LSDM fillimisht mori postin e ministres së Drejtësisë nga Bilent Saliji dhe më pas bëri dorëzimin e postit të Arsimit tek Arbër Ademi i BDI-së. Tek sektori i Kulturës, Asaf Ademi i BESËS - krahu i Afrim Gashit, mori postin nga ministri i deritashëm Robert Alazgiovski, ndërsa Bardhyl Mahmuti i PDSH-së mori postin e ministrit pa resor që mbulon Investimet e huaja në vend

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 4 qershor - Pas votimit në Parlament, të hënën në zyrat e ministrisë së Drejtësisë, të Arsimit dhe të Kulturës dhe të ministrisë për Investime të huaja është bërë pranidorëzimi i posteve ministore. Përkatesisht, Arbër Ademi, deri më tani zëvendësministër i Arsimit, dje ka marrë postin nga ministria e deritashme Renata Deskovska, e cila kaloi në postin e ministres së Drejtësisë që më parë ishte mbajtur nga Bilent Saliji i BDI-së. Ky i fundit dha dorëheqje morale pas protestave kundër riakualifikimit të veprës së rasti të Almirit të vogël nga "vrasje me paramendim" në "aksident komunikacioni me pasojë vdekje". Ndryshe, Arbër Ademi para së të vjen në postin e zëvendësministrit të Arsimit, për një vit e gjysmë gjatë Qeverisë teknike të Emil Dimitrievit mbante postin e zëvendëskryeministrit për çështje evropiane. I njëjti mori lëvdata nga ministria e deritashme e Arsimit, Renata Deskovska, e cila tha se postin po e lë në duar të sigurt tek një kuadër i përgatitur profesionalisht.

LLOGARI PËR ZBATIMIN E TË PËRCAKTIMEVE ARSIMORE

Ademi kohë pas kohë kishte lëvdata për punën e tij në Qeveri edhe nga ambasadorët e huaj, ku më i theksuari ishte ambasadori francez Kristian Timonie. Ademi ka mbaruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Juridik, drejtimi civil me temën: "Zgjidhjet e kontesteve tregtare para arbitrazhit tregtar ndërkombëtar". Ai ka kryer Masterin në drejtimin juridiko-civil në Universitetin shtetëror të Tetovës, dhe po në të njëjtin fakultet ka kryer Fakultetin Juridik. Ademi fillimisht ka punuar asistent me kohë jo të plotë në Fakultetin e Administratës së Biznesit, ndërsa më pas i rregullt, si dhe duke ushtruar njëkohësisht dhe postin e prodekanit për Arsim, po në këtë fakultet gjatë viteve 2009-2012. Pas mbarimit të doktoratës merr titullin docent për lëndët juridiko-civile në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

"Së bashku, në partneritet i

BËHET PRANIM DORËZIMI I POSTEVE MINISTRORE

MINISTRAT E RINJ ME PREMTIME TË MËDHA



tejkalojmë të gjitha sfidat, së bashku arrijmë sukses në realizimin e aktiviteteve të shumta dhe sipas bindjes time personale mendoj se kemi treguar shpejtësinë, këmbënguljen dhe angazhimin e sinqertë ndaj përmirësimit të gjendjeve në sistemin arsimor kombëtar", theksoi Ademi për bashkëpunimin e deritashëm me Deskovska.

Ai theksoi se edhe në të ardhmen entuziaste, me të gjithë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, do të vazhdojnë me realizimin e të gjitha prioriteteve, aktiviteteve, masave dhe projekteve, të cilët janë pjesë e programit të Qeverisë. "Fokusi, gjithsesi, mbetet në reformimin e arsimit fillor dhe të mesëm përmes zbatimit të zgjedhjeve të reja ligjore, si dhe zbatim të programeve të reja mësimore", potencoi ministri i ri i Arsimit dhe Shkencës.

Ademi theksoi se po punohet për përgatitjen e teksteve shkollore me përmbajtje të korigjuar, promovim më të madh të arsimit të mesëm profesional, si dhe nxitjen e kreativitetit të arsimtarëve dhe nxënësve. "Në pjesën e arsimit të lartë, gjithsesi, mbetet të mbajmë llogari për zbatimin e të gjitha përcaktimeve të cilat janë pjesë e ligjit të ri për arsimin e lartë, që duhet të sigurojë standarde më të mira për punë dhe cilësi në atë sferë", theksoi Ademi.

Ademi informoi se në përputhje me përcaktimet e përgjithshme të Qeverisë, Ministria për arsim dhe shkencë do të përipiqet të ndajë më shumë mjete për mundësi të reja dhe zhvillim të shkencës. "Ministria është në dispozicionin tuaj, për bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara, me gjithë ata të cilët kanë propozime më të mira me qëllim për të përmirësuar gjendjen", shtoi Ademi.

ADEMI: IDENTITET UNITAR KULTUROR PËR TË GJITHË

Pranim-dorëzimi i postit u bë edhe tek ministria e Kulturës, përkatesisht mes Robert Alazgiovskit dhe Asaf Ademit i nominuar nga grupi i deputetëve të Lëvizjes BESA - krahu i Afrim Gashit. "Do të jem ministër i të gjithëve, pa dallim përkatesisë fetare, etnike dhe partiake. Do të përipiqem të krijojë identitet unitar kulturor për të gjithë dhe të ndërtoj ura të bashkëpunimit kulturor mes të gjitha bashkësive dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë", ishte deklarata e parë e ministrit të ri të Kulturës, Asaf Ademi, menjëherë pas marrjes së postit. Ai shtoi se me Alagjovskin kanë konstatuar se jemi në rrugën e vërtetë për eurointegrimin e vendit.

"Kjo duhet të reflektojë pozitivisht edhe në jetën kulturore në Maqedoni dhe do të përipiqem maksimalisht që të realizohet kjo gjë", ka thënë Ademi. Ministri i deritashëm Robert Alazgiovski ka kaluar në kabinetin e kryeministrit Zoran Zaev duke u emëruar nga ky i fundit për koordinator nacional për kulturë dhe bashkëpunim me resorët qeveritar. Ndryshe, ministri i ri Asaf

Ademi është i lindur në vitin 1980 në Gostivar. Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka përfunduar në Gostivar, ndërsa Fakultetin e Ndërtimitarisë në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup. Nga viti 2003 është punësuar në Komunën e Gostivarit si konsultues për implementimin e projekteve, ku më pas është avancuar në udhëheqës të njësisë për zhvillim ekonomik lokal dhe udhëheqës i sektorit të urbanizmit. Në vitin 2009 është punësuar në Ministrinë e Jashtme dhe është emëruar për ambasador në Danimarkë deri në vitin 2013, i nominuar nga BDI e Ali Ahmetit. Pas kryerjes së mandatit të ambasadorit, ai është angazhuar si drejtues i kompanisë "Inskejl" me 100 të punësuar me përfaqësinë e saj në Shkup. Ademi në zgjedhjet e fundit lokale ishte kandidat për kryetar i Komunës së Gostivarit nga radhët e Lëvizjes BESA. Ai ka qenë pjesëmarrës i shumë projekteve ndërkombëtare. Tek sektori i Drejtësisë, ministria e re Renata Deskovska pas pranimit të postit nga Bilent Saliji tha se angazhimi i saj kryesor do të jetë përmirësimi i gjendjes së qytetarëve, ushtrimi i të drejtave të tyre sipas ligjit dhe reformat në gjyqësor.

Njëri ndër prioritetet e para, sipas Deskovskës, është ndryshim i Ligjit për ekzekutimin vendimeve të përmbartuesve, përmes një sistemi më të drejtë dhe kosto më të ulët në procedurën përmbartuese. "Prioriteti i dytë janë reformat në gjyqësor, pasi veçmë Ministria e Drejtësisë ka përpiluar Strategjinë për reforma", tha ministra Deskovska. Ajo shtoi se periudhën në vijim do të ndjek negociatat me opozitën për ligjet prioritare, sepse siç tha ajo, një pjesë e ligjeve tashmë janë miratuar me dy të tretat e votave dhe një pjesë pritet të miratohen së shpejti.

"Me të vërtetë kemi vullnetin për ta bërë gjyqësorin të pavarur dhe për të siguruar një bazë ligjore që do të çojë drejt kësaj pavarësie", theksoi Deskovska. Nga ministrinë tjera, ajo pa resor që mbulon Investimet e huaja që më parë u mbajt nga Ramiz Merko i BDI-së, ulet Bardhyl Dauti, ish-deputet dhe nënkryetar i PDSH-së. Dauti nga PDSH llogaritet si aset i fortë profesional që mund të bëjë shumë në sjelljen e investimeve të huaja në vend. Bardhyl Dauti ishte kandidat i kësaj partie në zgjedhjet e fundit lokale për kryetar të Komunës së Tetovës.

Dauti, ministër për Investime të huaja, ka diplomuar në Fakultetin e ekonomisë në UEJL, ka magjistruar në Universitetin në Stafordshire të Anglisë ndërsa studimet e doktoraturës i ka mbaruar me sukses të lartë në Universitetin në Lubjanës. Prej vitit 2006 i punësuar në UT. Me politik merret aktivisht në PDSH, nga viti 2012-2016, nga vitit 2016-2017, deputet në Parlament, ndërsa prej vitit 2014 mban postin e nënkryetarit të PDSH-së.

SHPALLET KONKURSI PËR ANËTARËT E PËRKOSSHËM TË KSHZ

Pas miratimit nga Parlamenti në seancën e së premtes të vendimit për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, është publikuar konkursi me kriteret për përzgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të tjerë. Në këto funksione mund të konkurrojnë çdo shtetas që nuk është anëtar partie, ka kryer arsimin e lartë dhe të ketë një përvojë pune prej tetë vitesh. Konkursi zgjat tetë ditë, ndërsa dokumentacioni dorëzohet në Parlament. Kandidaturat do të shqyrtohen nga Komisioni i zgjedhjeve dhe emërimeve, ndërsa partitë do të parashtrajnë propozime për anëtarët e rinj. Opozita duhet të propozojë kryetarin dhe dy anëtarë, ndërsa partitë e koalicionit qeveritar zëvendëskryetarin dhe tre anëtarë. Kjo përbërje e re

e KSHZ është zgjidhje e përkohshme dhe mandati i tyre do të zgjasë gjashtë muaj, ndërsa mes partive vazhdojnë bisedimet për të arritur dakordimin rreth rregullativës ligjore për organizimin e zgjedhjeve dhe proceseve zgjedhore. Në muajin tetor pritet që të arrihet marrëveshja për të ndryshuar Kodin Zgjedhor dhe konform ndryshimeve duhet të bëhet edhe zgjedhja e anëtarëve të rinj të KSHZ. Pas dorëheqjes së anëtarëve që nga dhjetori i vitit të kaluar KSHZ nuk është në gjendje të miratojë asnjë lloj vendimi, apo të përmbushë detyrimet e saj ligjore. Një prej tyre mund të jetë edhe organizimi i një referendumi, siç paralajmëroi kryeministri Zaev lidhur me votimin e qytetarëve për çështjen e kontestit të emrit. (E.H)

BISEDIMET PËR EMRIN, ZAEVI INTERVISTË PËR MAGAZINËN CORD

OPTIMIZËM PËR FTESË NË KORRIK PËR NË NATO

"Nëse orientohemi të gjithë drejt zgjidhjes, viti 2018 mund të jetë vit për t'u mbajtur mbajtur mend edhe për Republikën e Maqedonisë, por edhe për rajonin edhe për BE-në edhe për NATO-n. Prandaj, jam optimist i palodhshëm dhe pres në korrik ftesë për hyrjen e Maqedonisë në NATO", ka thënë Zaevi

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 4 qershor - Kryeministri Zoran Zaev pret që në muajin korrik Maqedonia të marrë ftesë për hyrje në NATO. Për vete thotë se është optimist i palodhshëm, por potencon edhe se të gjithë duhet të orientohen ndaj gjetjes së zgjidhjes për kontestin me emrin me Greqinë. Nga ana tjetër, sondazhi i fundit i bërë atje tregon se një prej dy grekëve mendon se tani duhet të arrihet zgjidhje. Optimizmin e tij kryeministri e shprehu në intervistën për magazinën CorD, e cila botohet në Beograd, ndërsa për lexuesit e saj i ka përfaqësuesit e korit diplomatik në vendet e rajonit.

"Nëse orientohemi të gjithë drejt zgjidhjes, viti 2018 mund të jetë vit për t'u mbajtur mbajtur mend edhe për Republikën e Maqedonisë, por edhe për rajonin edhe për BE-në edhe për NATO-n. Prandaj, jam optimist i palodhshëm dhe pres në korrik ftesë për hyrjen e Maqedonisë në NATO", theksoi kryeministri Zoran Zaev në intervistë. Në pyetjen nëse ndryshimet e Ballkanit Perëndimor e bëjnë faktor të stabilitetit në rajon ose është ende rajon që prodhon kriza, Zaev potencoi se Ballkani Perëndimor u shpreh se mund të ketë udhëheqësi të sinkerta, energjike dhe të përkushtuar politike, të cilët dëshirojnë, mund dhe dinë të vlerësojnë se çka është e nevojshme për qytetarët e vet, por edhe më gjerë dhe janë të gatshëm, pa kalkulime, t'i vendosin shtetet në rrugën e duhur.

"Nëse ndonjëherë Ballkani Perëndimor ka qenë i fortë në pikëpamjet e tij ndaj ardhmërisë së përbashkët, ajo është tani. Ky është një moment shumë i rëndësishëm. I njohim nevojat për lidhje dhe bashkëpunim të ndërsjellë dhe i tregua Evropës se është e plotë, e sigurt dhe stabile vetëm me integrim të plotë të të gjitha shteteve që në mënyrë gjeografike, historike, kulturore i përkasin. Jemi faktor i stabilitetit të Evropës, jo të jostabilitetit, nuk ka më dilema. Për tu përshëndetur është që edhe Evropa e njeh atë dhe e shtri dorën drejt Ballkanit



Perëndimor", theksoi kryeministri Zaev. Në pyetjen si do të harmonizohen porositë e volitshme të BE-së për Republikën e Maqedonisë, posaçërisht pas rekomandimit për përcaktimin e datës për negociatave, me çështjen e hapur për problemin që Greqia e ka me emrin e vendit tonë, kryeministri Zoran Zaev tha se me vendimin e KE-së për rekomandim kristal të pastër për fillimin e negociatave me BE-në, u konfirmuan politikat e qeverisë aktuale, me të cilat për vetëm 10 muaj janë zhbllokuar procese, të cilat ishin thellë të ngujuara për shkak të sjelljes papërgjegjshme të pushtetit paraparak dhe për shkak të krizës politike.

"Pres që viti 2018 të sjell ndryshime të reja të rëndësishme pozitive në realizimin e qëllimeve strategjike, euro-atlantike të shtetit dhe në cilësinë e jetesës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Bisedat me Republikën e Greqisë i vendosëm në nivel miqësor dhe dinjitoz dhe pritjet e mia çojnë drejt zgjidhjes që sjell ardhmëri të mirë për qytetarët e Maqedonisë dhe Greqisë, por edhe të tërë rajonit", tha Zaev. Në pritje të bisedës telefonike Zaev - Cipras dhe harmonizimit

të të gjitha çështjeve teknike nga marrëveshja eventuale, televizioni grek "Action24" e publikoi anketën që për të e kanë përpunuar agjencia "Rass", sipas së cilës pothuajse gjysma e grekëve të anketuar pajtohen se Qeveria greke duhet në këtë moment të synojë drejt arritjes së zgjidhjes për emrin

Në pyetjen "nëse pajtoheni ose jo me mendimin se kushtet për zgjidhjes së çështjes së Shkupit janë më të volitshme dhe qeveria duhet të synojë drejt zgjidhjes së saj tani", 43.8 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se pajtohen, ndërsa 4.5 për qind kanë dhënë përgjigje "me siguri pajtohem", 40.7 për qind kanë thënë se nuk pajtohen, ndërsa 3.2 për qind se me siguri se nuk pajtohen. Përgjigje nuk kanë dhënë 7.8 për qind. Nga ana tjetër, ata që nuk pajtohen ose me siguri nuk pajtohen me qëndrimin se kushtet janë të volitshme për zgjidhje, janë të moshës nga 35 deri në 44 vjeç (50.3 për qind), shumica janë meshkuj (50.6 për qind), në zgjedhjet e fundit në vitin 2015 kanë votuar për Demokracinë e Re (59.3 për qind), ndërsa jetojnë në veri të Greqisë (48.3 për qind).

ATHINA E PRET HAP ZAEVIN

Topi është në terrenin e fqinjëve që ta bëjnë hapin vendimtar drejt zgjidhjes, ndërsa ne presim, thotë zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa portofol Dimitris Xanakopulos në intervistën për televizionin grek "Kontra". "Atë që e presim është që udhëheqësia politike në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ta bëjë hapin vendimtar që përfundimisht të shkojmë përpara drejt zgjidhjes së pranueshme të përbashkët drejt të cilës synojnë edhe të dyja vendet. Zotin Zaev duhet të përfundojë me aktivitetet e nevojshme politike në brendësi të vendit të tij dhe kjo është ajo që e presim", thotë Xanakopulos në intervistë. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, ai nuk dëshirojë kur do të realizohej biseda telefonike midis Zoran Zaevit dhe Aleksis Ciprasit dhe edhe një herë tha se "asgjë nuk është dakorduar që të arrihet deri te zgjidhja. Xanakopulos theksoi se Greqia nuk ka kurrfarë presioni, "nëse marrëveshja do të arrihet në mënyrë kohore apo në një mënyrë tjetër", dhe për këtë thotë se topi është në terrenin e palës tjetër, ndërsa Athina atë që mund ta bëjë është vetëm të presë. Duke folur për televizionin grek, tha se marrëveshja qartë dhe konkretisht do ta garantojë përfundimin e fazës së ndërrimit të emrit, ndërsa shfaqti bindje se partitë në Greqi vështirë se do të gjejnë argument që mos ta mbështesin zgjidhjen.

CIPRAS-BATROLOMEJ: TË ZGJIDHEN DALLIME QË TË EKZISTOJË BASHKËPUNIM

Athinë, 4 qershor - Aspekti kishtar i problemit midis Maqedonisë dhe Greqisë ishte një ndër temat për të cilat biseduan kryeministri grek dhe Patriarku Ekumenik në takimin e tyre 80-minutësh në pallatin kryeministral, njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina. Aleksis Cipras i përshëndeti angazhimet e Patriarkut Ekumenik për tejkalimin e problemit, ndërsa Ekumeniku tha se janë duke punuar në bashkimin mbarëortodoks dhe bashkëpunim.

"Dëshiroj t'i përshëndes tentimet tuaja për zgjidhjen pozitive të aspektit kishtar të dallimeve që kemi me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Besoj se po e shihni edhe ne po tentojmë t'i zgjidhim dallimet të cilat ekzistojnë për shumë vite dhe pengojnë që dy vende fqinje të kenë bashkëpunim normal dhe rrjedhë të përbashkët. Besoj se mundësia për zgjidhje do të mund të krijojë mjedis të stabilitetit dhe zhvillimit në Ballkan, diçka që na duhet, por edhe bashkëpunim, bashkëpunim të mirë midis dy popujve fqinj të cilët në shumicë kanë konfesion ortodoks edhe ky është element kryesor të cilin nuk duhet ta anashkalojmë", tha Cipras në fillim të takimit me Patriarkun Ekumenik dhe iu falënderua dhe i përshëndeti nismat e Patrikanës. "Lidhur me kishën në Shkup, çështjen që e përmendët, është në kuadër të obligimeve kanonike të Patrikanës Ekumenike të tentojë t'i mënjanojë përçarjet ku ekzistojnë dhe të punojë në bashkimin mbarëortodoks dhe bashkëpunim siç kemi bërë gjithë këto vite", tha Bartolomej.

ORBAN MUNDOHET TA MINOJË ZGJIDHJEN E KONTESTIT ME EMRIN

Bruksel, 4 qershor - Portali evropian Euraktiv në mëngjes i transmeton porositë e kryeministrit hungarez Viktor Orban të publikuara gjatë tubimit të partisë më të madhe opozitare të Maqedonisë në të cilin ai i përshëndet përpjekjet e VMRO-DPMNE-së ta bllokojë zgjidhjen me Greqinë dhe "të mos gjunjëzohet nën presion të forcave të huaja". Euraktiv thekson se porositë e Orbanit janë në kundërshtim me ato të udhëheqësve tjerë demokristherë si Elmar Brok, bashkëpunëtor i afërt i kancelares gjermane Angela Merkel, por edhe kryetari i EPP-së, Zhozef Doll, i cili, gjithashtu, shprehu përkrahje për "zgjidhje të përbashkët të pranueshme" për të dyja palët. Euraktiv e citon nënkryetarin e Parlamentit Evropian dhe anëtarin e Syrizes, Dimitris Papadimulis, të cilin Orban e quan "përrjashtim i trishtuar" dhe thotë se pothuajse të gjithë liderët politikë evropianë dhe eurodeputetët i përkrahin përpjekjet e Zaevit dhe Ciprasit të gjejnë zgjidhje për kontestin.

"Emër për të gjitha përdorimet, me ndryshime të vërteta që t'i vihet fund irredentizmit dhe kontesteve të mundshme të ardhshme", ka deklaruar Papadimulis për Euraktiv. Kjo nuk është hera e parë Orban të jetë në përleshje me partnerët e tij nga djathtë evropiane, si dhe me liderët e tjerë evropianë. Partia demokristiane holandeze CDA të shtunën kërkoi përjashtim të partisë së Orbanit, Fides, nga EPP përderisa vazhdon me politikat e tij.

EDHE NJË PREMTIM PËR AUTOSTRADËN E SHUMËPËRFOLUR

RRUGA SHKUP-BLLACË, KITANOV KËRKON MIRËKUPTIM!

"Për afate konkrete se kur pritet të fillojë ndërtimi, sinqerisht nuk dua të spekuloj. Sektori i ndërtimtarisë është i ndërlikuar. Tani, nëse ne themi se brenda tetë muajve do të përfundojnë të gjitha aktivitetet ndërtimore dhe gjatë kontrollave mekanike vërtetohet se toka nuk është siç duhet, atëherë në këto rrethana duhet të përpunohet projekti", tha Kitanov



hapa konkrete për tu ndërtuar ajo rrugë. Përprakisht vetëm është folur se duhet të bëhet, ndërsa ne sot jemi duke punuar konkretisht. Presim që opinioni të na mirëkuptojë dhe të na pret ta bëjmë një projekt cilësor. Në pyetje janë 12 kilometra rrugë, me mjete të miratuara nga Bashkimi Evropian në vlerë për 1.3 milion euro. Për momentin, rruga është në fazën e projektimit dhe më pas vijon faza e tenderimit dhe e ndërtimit, gjithsesi. Të jeni të bindur se kjo rrugë do të bëhet. Ndërkohë, ne si ndërmarrje në programimin tonë e kemi paraparë rehabilitimin e plotë të rrugës ekzistuese derisa projekti kryesor të realizohet. Duhet ta keni parasysh se çdo vend ku ekziston autostradë, duhet të ketë edhe rrugë të dytë", ka thënë Kitanov, ndërsa nuk ka dhënë një datë konk-

rete se kur mundet të përfundojë projektimi dhe kur të nisin punimet.

"Për afate konkrete se kur pritet të fillojë ndërtimi, sinqerisht nuk dua të spekuloj. Sektori i ndërtimtarisë është i ndërlikuar. Tani, nëse ne themi se brenda tetë muajve do të përfundojnë të gjitha aktivitetet ndërtimore dhe gjatë kontrollave mekanike vërtetohet se toka nuk është siç duhet, atëherë në këto rrethana duhet të përpunohet projekti. Lejoni që të bëhet një rrugë e mirëfilltë dhe cilësore, gjegjësisht jo si përvojat e deritanishme që i kemi. Ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër është projektuar shumë shpejtë, mirëpo ndërtimet po ecin shumë ngadalë. Nuk duam të ballafaqohemi me këso situata edhe në autostradën Shkup-Bllacë", tha drejtori Kitanov.

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 4 qershor - Ndërtimi i autostradës Shkup-Bllacë vazhdon të mbetet temë aktuale në çdo paraqitje të përfaqësuesve të Qeverisë. Kështu ndodhi edhe të premten, ku drejtori i Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, Zoran Kitanov edhe njëherë u prononcuar për risitë dhe aktivitetet e Qeverisë që ndërmerren për momentin për këtë aks rrugor.

"Bëhet fjalë për një rrugë tejet të rëndësishme për shtetin tonë, për komunikacion dhe lidhjet me Kosovën. Ajo rrugë është përmendur me dhjetëra herë. Tash janë marrë

Jankullovska si të gjithë qytetarët, do të trajtohet sipas ligjit

Shkup, 4 qershor - Gordana Jankullovska nuk ka arsye aspak të shqetësohet, sepse ajo ashtu si të gjithë qytetarët, do të trajtohet sipas ligjit, u përgjigj ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska, në letërën e ish-ministres së Punëve të Brendshëm, në të cilën i drejtohet asaj dhe ministres së re të Drejtësisë, Renata Deskoska, për shkeljen e të drejtave të saj në gjykimin për lëndën

e PPS-së në të cilën ajo është një nga të akuzuarit. Carovska shtoi se nëse ka ndonjë problem i cili është nga dikasteri me të cilin ajo udhëheq do të ndihmonte pa asnjë problem, por tha, një gjë e tillë tani për tani nuk ekziston. "Lidhur me atë që shkruan në letër, ndërsa ka të bëjë me vendimet gjyqësore, praktikat dhe procedurat, kjo nuk është në kompetencën time", tha Carovska

duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve para Konferencës së dytë ndërkombëtare "Gratë në energjetikë 2018". Jankullovska letërën e hapur deri te Deskoska dhe Carovska e dërgoi të shtunën dhe u ankua në realizimin e të drejtave të saj në fushën e gjyqësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave, gjegjësisht shkeljen e tyre të rëndë.

KRONIKË

E rrahin shitësen dhe demolojnë dyqanin sepse nuk kishte marrë birrë!

Një banor i fshatit Banicë të Strumicës e ka sulmuar shitësen e një dyqani pasi ajo nuk i kishte dhënë birrë me pagesë të shtyrë. Burri i revoltuar fizikisht e sulmoi edhe bashkëshortin e saj dhe më pas me edhe disa persona e kanë demoluar dyqanin. Në lidhje me rastin, janë arrestuar K.R. (20), A.R. (26), D.R. (25), që të gjithë nga f. Banicë dhe janë mbajtur në stacionin policor për procedurë të mëtejme. Pas zbardhjes dhe dokumentimit të plotë të rastit do të parashtrihen parashtrësia adekuate.

Shkup, 244 gjoba për parkim të gabuar

Për parkim të parregullt këtë fundjavë në rajonin e qytetit të Shkupit janë shqiptuar masa për 244 automjete, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 37 automjete. Sipas raportit të policisë të SPB Shkup, gjatë fundjavës kanë ndodhur gjithsej 15 aksidente nga të cilat në dy ka pasur dy persona të lënduar rëndë. Në shtatë aksidente kanë persona të lënduar më lehtë, ndërsa në gjashtë është shkaktuar dëm material. Gjatë fundjavës janë evidencuar 88 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa nga komunikacioni janë përjashtuar 59 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 20 para se ta marrin të patentën dhe shtatë fillëstarë. Janë përjashtuar nga komunikacioni edhe 31 automjete të paregjistruara dhe një automjet teknikisht i parregullt. Gjatë fundjavës nuk janë marrë masa kundër këmbësorëve. (O.XH)

Siguria në rrugë, Maqedonia mes 5 vendeve të fundit

Shkup, 4 qershor - Maqedonia mbetet prapa vendeve evropiane sa i përket sigurisë së komunikacionit në rrugë. Analizat tregojnë se në vendet e Bashkimit Evropian, mesatarisht ka 5.2 viktima në trafik në 100.000 banorë, ndërsa në Maqedoni, 7.1 viktima në 100.000 banorë.

Për këtë arsye, nga institucionet kompetente paralajmërojnë në vjeshtë formim të trupit ek-

zekutiv për siguri në rrugë në të cilën do të marrin pjesë përfaqësues nga institucionet kompetente. Qëllimi i tij do të jetë të punojnë në rritjen e sigurisë në rrugë. "Bëhet fjalë për numra të tmerrshëm dhe për këtë nga ana jonë do të ndërmarrim gjithçka që ta zvogëlojmë numrin e viktimave në rrugë dhe maksimalisht ta rrisim sigurinë. Në vendet nga Bashkimi Evropian ka mesatarisht

5,2 viktima në komunikacion në 100.000 viktima, ndërsa në Maqedoni ka 7,1 viktima në 100.000 banorë", deklaroi Sugareski në suaza të konferencës ndërkombëtare "Siguri në rrugë".

Vlerësimi i përgjithshëm i pjesëmarrësve është që të rritet siguria në rrugë është e nevojshme rehabilitimi i rrugëve ekzistuese, projektim i rrugëve të reja të rritet në nivel më të lartë, të ketë vetë-

dije më të madhe te shoferët dhe kontroll më të madh dhe ndëshkime nga institucionet kompetente. "Për herë të parë në Maqedoni, ka pikë kontrolli ku xhirohet një pjesë e autostradës Demir Kapi-Smokvicë. Vitin e ardhshëm deri në këtë kohë do të mbulohet edhe pjesa nga Velesi deri në Demir Kapi. Ka kontroll, por duhet të ketë edhe dënime. Është e papërgjegjshme kur shihni dikush në tunel

duke ngarë 180 kilometra në orë", tha drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore Zoran Kitanov.

Për vitin e ardhshëm planifikohet tërësisht pjesa rrugore nga Korridor 10 të mbulohet me kamera. Sipas analizave të caktuara, të ndarë me 32 shtete në Evropë, Maqedonia është pesë vendeve të fundit sipas sigurisë në komunikacion. (O.XH)

PROFESIONALIZMI I MUNGUAR I SHOQËRISË SHQIPTARE

REVOLTË PA EPILOG!

Organizatave adekuate ndërkombëtare dhe institucionet tjera të Bashkimit Evropian si dhe të Kombeve të Bashkuara, fare pak janë të njoftuar me shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Maqedonisë. Mungesën e një sektori civil profesional shqiptar, i cili kryekëput do të merrej me procedimin, analizën dhe arkivimin e rasteve të dyshimta kur shkelen të drejtat e njeriut shqiptar, më së mirë e shpjegon rasti i Almir Aliut

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 4 qershor - Shoqëria shqiptare në Maqedoni, edhe atëherë kur ka tema të dhimbshme brenda saj, i trajton në mënyrë shumë stihike, me njëfarë vullnetarizmi të pakoordinuar dhe me mungesë të theksuar të qasjes profesionale. Shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut, në këtë rast të qytetarit shqiptar në Maqedoni, vite me radhë manifestohet vetëm me protesta dhe pakënaqësi të shprehura nëpër rrugët e Shkupit e më gjerë dhe këtu përfundon aksioni shoqëror.

Mungesa e trajtimit dhe analizës profesionale të rasteve të montuara gjyqësore dhe diskriminimet tjera që shqiptarëve iu bëhet nga organet shtetërore, paraqet një rëndësi prej arsyeve kryesore se pse ankesat dhe revolta e shprehur ndër vite nuk ka epilog. Për dallim nga rastet e montuara siç janë "Monstra" e "Sopoti", për të cilët opinioni vendas vazhdimisht ka reaguar bujshëm, Organizatat adekuate ndërkombëtare dhe institucionet tjera të Bashkimit Evropian si dhe të Kombeve të Bashkuara, fare pak janë të njoftuar me shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Maqedonisë. Mungesën e një sektori civil profesional shqiptar i cili kryekëput do të merrej me procedimin, analizën dhe arkivimin e rasteve të dyshimta kur shkelen të drejtat e njeriut shqiptar, më së mirë e shpjegon rasti i Almir Aliut.

Luftën për drejtësi, si në shumë raste tjera edhe tani kur në fokus ishte vrasësi i Almir Aliut,



Boban Iliq nga Kumanova, muaj më parë e zhvilluan mediat, qytetarët dhe disa aktivistë të cilët u organizuan enkas për këtë ngjarje. Kryetari i Shoqatës së të burgosurve politik në Maqedoni, Shpëtim Pollozhani, shpreh pakënaqësi sa i përket organizimit të sektorit civil shqiptar në vend dhe sipas tij duhet sa më shpejt të formohet një asociacion i qytetarëve shqiptarë,

i përbërë nga juristë dhe ekspertë të fushave të ndryshme, kuptohet me përvojë, por edhe të rijë, angazhimi i të cilëve do të fokusohet në monitorimin e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve në vendin tonë.

A I KA KAPLUAR SHQIPTARËT "SINDROMI I STOKHOLMIT"?

"Në vendin tonë funksionojnë mbi 4 mijë organizata joqeveritare. Por, asnjëra prej tyre nuk disponon me kuadro të ri dhe profesional të cilët do ta trajtonin çështjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit shqiptar. Përderisa publikisht dihet se në Maqedoni qytetarëve që më së tepërmi iu shkelen të drejtat, janë pikërisht shqiptarët, prandaj edhe e kemi menduar të themelojmë një shoqatë e cila do të merrej ekskluzivisht me këtë çështje. Monitorimi apo trajtimi i problematikës për të drejtat e njeriut, me theks të qytetarëve shqiptarë para çdo organi shtetëror, do të ishte alfa dhe omega e aktiviteteve të kësaj shoqate. Ideja ishte që ky lloj subjekti të dal nga protestat të cilat i realizuam muaj më parë, megjithatë komuniteti shqiptar nuk reflektoi pozitivisht. Fatkeqësisht ne jemi mësuar me këtë "Sindromin e Stokholmit", thotë Pollozhani.

Veprimi i kësaj organizatë duhet të jetë e modelit të Komitetit të Helsinkit, respektivisht jo se ky komitet është një nacional, megjithatë reagimet e tija mendoj se më tepër kanë të bëjnë me të drejtat qytetare, ndërkohë që shqiptarëve më së tepërmi ju shkelen të drejtat kombëtare, sqaron Pollozhani.

Pavarësisht faktit se komuniteti ndërkombëtarë përmes mekanizma të tij e mbikëqyr procesin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Maqedoni, në raportet vjetor që publikohen mund të shihet mungesa e shumë rasteve apo ngjarjeve që kanë të bëjnë me shqiptarët. Gjendjen e shoqërisë shqiptarë në Maqedoni, më së miri e shpjegon fakti se ajo përveç organizimit mediatic dhe ofrit të kuadrove individuale profesionale, për 27 vite me radhë nuk ka arritur të formojë një sektor civil profesional i përbërë nga kuadro të ndryshëm, detyrë e të cilit do ishte çështja e shqiptarëve në raport me respektimin e të drejtave të njeriut.

AKTIVIZMI SHOQËROR NUK MUND TË BËHET PA FINANCA

Njohësi i zhvillimeve shoqërore në vendin tonë përgjatë dekadave të fundit, juristi Naser Zyberi, për gazetën KOHA, thotë se situata në sektorin joqeveritar shqiptar është pasqyrë e situatës së përgjithshme të shqiptarëve në Maqedoni. Sipas tij organizimi i shqiptarëve në më shumë sfera tjera nuk është më i mirë.

"Organizata të tilla të shqiptarët vlerësoj se nuk janë të stimuluar me mjete financiare, qoftë nga burime ndërkombëtare apo atyre të brendshme. Dhe

aktiviteti i tyre për shkaqe financiare nuk mund të organizohet dhe të zhvillohet. Proceset gjyqësore shpesh herë të dyshimta, të cilët politikisht dhe etnikisht janë të motivuara, kërkojnë qasje më serioze nga aktivist dhe njerëz të cilët janë të specializuar në çështje të caktuara. I gjithë ky proces mund të monitorohet dhe ndihmohet vetëm nëse këta aktivist kanë mbështetje financiare. Organizimi i protestave dhe shprehjes së revoltës është një çështje e cila mund të manifestohen me një çast të caktuar dhe që nuk kërkon ndonjë trajtim më analitik dhe ndonjë investim. Ndërsa çështja e studimit, hulumtimi, mbledhja e fakteve dhe ndjekja e proceseve gjyqësore është punë dukshëm më e ndërlikuar dhe kjo kërkon angazhim më serioz. Pa një çaje të thuktë të subjekteve të caktuara, shoqatave të juristëve, të profesorëve universitar apo fakulteteve juridike, nuk besoj se mund të ketë një nuk ndonjë efekt. Të gjitha këto subjekte kërkojnë një lidhshmëri, një iniciator apo promotor të aktivitetit dhe shprehjes së interesit. Tash për tash përveç rasteve sporadike nuk shoh ndonjë angazhim më serioz", thotë Zyberi.

Ndryshe, vetëm pas ndryshimit të pushtetit në Maqedoni pas qershorit të vitit 2016 e deri më sot, në kampusin maqedonas janë themeluar disa asociacione të cilat merren me trajtimin e rasteve të montuara gjyqësore në aspektin civil, administrativ dhe atë penal. Së fundmi ato arritën marrëveshje me Qeverinë për një qasje më të lehtë deri te të gjitha dëshmitë dhe provat që pushteti i kaluar i ka penguar.



SHPËTIM POLLOZHANI

Përderisa publikisht dihet se në Maqedoni qytetarëve që më së tepërmi iu shkelen të drejtat, janë pikërisht shqiptarët, prandaj edhe e kemi menduar të themelojmë një shoqatë e cila do të merrej ekskluzivisht me këtë çështje. Monitorimi apo trajtimi i problematikës për të drejtat e njeriut, me theks të qytetarëve shqiptarë para çdo organi shtetëror, do të ishte alfa dhe omega e aktiviteteve të kësaj shoqate. Ideja ishte që ky lloj subjekti të dal nga protestat të cilat i realizuam muaj më parë, megjithatë komuniteti shqiptar nuk reflektoi pozitivisht. Fatkeqësisht ne jemi mësuar me këtë "Sindromin e Stokholmit"



NASER ZYBERI

Organizata të tilla të shqiptarët vlerësoj se nuk janë të stimuluar me mjete financiare, qoftë nga burime ndërkombëtare apo atyre të brendshme. Dhe aktiviteti i tyre për shkaqe financiare nuk mund të organizohet dhe të zhvillohet. Proceset gjyqësore shpesh herë të dyshimta, të cilët politikisht dhe etnikisht janë të motivuara, kërkojnë qasje më serioze nga aktivist dhe njerëz të cilët janë të specializuar në çështje të caktuara. I gjithë ky proces mund të monitorohet dhe ndihmohet vetëm nëse këta aktivist kanë mbështetje financiare. Organizimi i protestave dhe shprehjes së revoltës është një çështje e cila mund të manifestohen me një çast të caktuar dhe që nuk kërkon ndonjë trajtim më analitik dhe ndonjë investim. Ndërsa çështja e studimit, hulumtimi, mbledhja e fakteve dhe ndjekja e proceseve gjyqësore është punë dukshëm më e ndërlikuar dhe kjo kërkon angazhim më serioz

Në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, sikurse tregon drejtori Zeqiri, për provimin e anglishtes ishin paraqitur po aq nxënës sa edhe për provimin e obligueshëm të gjuhës amtare. "Për lëndën e gjuhës shqipe janë paraqitur 543 maturantë. Po kaq maturantë, pra 543 ishin paraqitur për provimin e gjuhës angleze. Për lëndën e matematikës, të cilën e zgjedhin mes lëndëve të tjera, janë përcaktuar vetëm 15 nxënës"

PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2018

VETËM 15 NXËNËS ZGJEDHIN MATEMATIKËN!



zgjedhin të japin maturë shkollore, e cila ka vetëm provime me vlerësim intern (nga komisione që formohen brenda shkollës) nuk mund të pretendojnë regjistrimin e fakultetit pasi për këtë është më se e nevojshme matura shtetërore, pra notat e provimeve me vlerësim ekstren (të vlerësuara nga komisioni i jashtëm).

Nga QSHP nuk kanë dalë ende me të dhënë konkrete për numrin e maturantëve që kanë paraqitur matematikën si provim ekstren, në nivel shteti. Kjo pritet të mësohet, në 13 qershor ku edhe është caktuar të zhvillohen provimet në këtë lëndë. Sakaq provimet e gjuhës amtare (maqedonisht, shqip dhe turqisht) janë caktuar për në datën 9 qershor, ndërsa provimet e fizikës, kimisë, biologjisë, historisë, filozofisë, estetikës dhe biznesit do të organizohen në datën 11 qershor. Në kuadër të provimeve të maturës shtetërore, nxënësit u nënshtrohen verifikimit të dijeve në tre provime ekstere edhe atë në mënyrë të obligueshme në lëndën e gjuhës amtare apo gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, në lëndën e anglishtes apo matematikës dhe në një lëndë tjetër që ata mund të zgjedhin nga lista përkatëse.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 4 qershor - Kur janë në pyetje zgjedhjet e nxënësve sa i takon verifikimit të dijeve, të gjithë e shmanjin lëndën e matematikës. Edhe këtë vit, pjesa dërmuese e maturantëve në provimet ekstere, pra të atyre që vlerësohen nga komisione jashtë shkollë janë përcaktuar të japin për provim të maturës shtetërore gjuhën e huaj dhe jo matematikën. Edhe në këtë zgjedhje ka sërish një tendencë të dallueshme të përcaktimit të nxënësve drejt gjuhës angleze. Rreth 95 për qind e nxënësve që kanë paraqitur provimet e maturës shtetërore për afatin e qershorit, kanë zgjedhur gjuhën e huaj. Kështu, sipas të dhënave të Qendrës Shtetërore të Provimeve (QSHP) në provimet e gjuhëve së huaj të cilat u zhvilluan të shtunën

ishin paraqitur 14.391 maturantë. Ndërkaq, numri i kandidatëve për dhënien e provimeve të maturës shtetërore për afatin e qershorit është rreth 15.000, që do të thotë se mbi 95 për qind e nxënësve në nivel të gjitha shkollave të Maqedonisë zgjedhin të verifikojnë dijet në lëndët e gjuhëve të huaja, kryesisht në lëndën e anglishtes.

Ka shkolla, si gjimnazi "Zef Lush Marku" i Shkupit ku 100 për qind e maturantëve zgjedhin anglishten dhe ku matematika për një numër shumë të vogël nxën-

sish ka paraqitur interes si lëndë e tretë. Drejtori Faruk Zeqiri thotë se këtë vit, ZLM numëron 543 maturantë dhe se të gjithë e kanë paraqitur Maturën Shtetërore.

"Për lëndën e gjuhës amtare, respektivisht për gjuhën shqipe janë paraqitur 543 maturantë. Po kaq maturantë, pra 543 kishin paraqitur për provim edhe gjuhën angleze. Për lëndën e matematikës, të cilën e zgjedhin mes lëndëve të tjera si biologjia, fizika, kimia, historia e kështu me radhë, janë përcaktuar 15 nxënës", dekla-

ron Zeqiri. Pra, sikurse tregon drejtorit, matematikën e kanë zgjedhur vetëm 2.7 për qind e nxënësve të këtij gjimnazi. Ajo, që gjithashtu bie në sy është orientimi i nxënësve për maturën shtetërore. Mes zgjedhjes për këtë lloj mature apo për llojin e maturës shkollore, asnjë në këtë gjimnaz nuk është përcaktuar për këtë ët fundit. Kjo duhet të lidhet me përparësinë që ka matura shtetërore, për dallim prej maturës shkollore, në vazhdimin e shkollimit në nivelin e arsimit të lartë. Ata që

REZISTOI ME BOMBA, VRITET I PAKAPSHMI I POLICISË

Nuk dorëzohet, vriteti shumëkërkuari Jeton Rexhepi

Diku në mesditë, trupi i pajetë i Jeton Rexhepit është marrë për obduksion nga ana e policisë, ndërsa ekipet e gazetarëve deri vonë nuk janë lejuar që të hyjnë në fshat

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 4 qershor - Banorët e fshatit Llërcë të Komunës së Zhelinës janë zgjuar këtë të hënë nën zhurmën e plumbave dhe bombave. Fshati ishte rrethuar nga forca të mëdha policore, të cilët kërkonin të arrestonin 38 vjeçar, Jeton Rexhepi. Personi në fjalë kërkohet për shumë vepra dhe ishte i njohur si për policinë, por edhe për opinionin për kryerjen

e shumë veprave penale të cilët atë e ngarkonin me burg prej 26 vitesh e 10 muajve. Personi në fjalë disa herë kishte arritur që t'i shmangej arrestimit, madje disa herë edhe duke plagosur pjesëtarët e policisë gjatë tentimeve për arrestim. Ai ishte kthyer në një njeri të pakapshëm për autoritetet policore vendore, të cilët kishin lëshuar edhe urdhërrrest vendor dhe ndërkombëtar.

"Kemi të bëjmë me një person, i cili në periudhë prej vitit 2000 deri në vitin 2016, deri te Prokuroria Themelore Publike në Tetovë dhe Prokuroria Themelore Publike në Shkup, janë shqiptuar gjashtë akuzat penale, për 16 forma të rënda të veprave penale edhe atë, për 'vrasje', 'tentim vrasje', 'grabitje', 'armëmbajtje pa leje', 'rrembim' e kështu me radhë. Në periudhën kur Jeton Rexhepi i njohur me nofken

Llapi, ka qenë në ikje, nga ana e pjesëtarëve të policisë katër herë është tentuar që i njëjti të privohet nga liria, megjithatë në të gjitha rastet, ai ka dhënë rezistencë aktive, me përdorimin e llojeve të ndryshme të armëve ndaj pjesëtarëve të policisë", thuhet në njoftimin e policisë së Tetovës. Duke patur parasysh që policia disa herë kishte dështuar gjatë arrestimit, është përgatitur një plan më i gjerë për arrestimin e tij.

"Duke marrë parasysh njohuritë dhe vlerësimet e sigurisë, se Jeton Rexhepi paraqet kërcënim serioz të sigurisë për jetën e qytetarëve dhe të pjesëtarëve të policisë, është përgatitur plan i posaçëm, që i njëjti të privohet nga liria dhe të arrestohet. Sot, në orët e hershme të mëngjesit, në shtëpinë e tij në fshatin Llërcë, gjatë marrjes së masave dhe aktiviteteve për ta

privuar nga liria, ai ka hedhur një bombë dore ndaj pjesëtarëve të policisë dhe më pas ka ikur. Ka qenë i veshur me xhakëtë antiplumb, i armatosur me pushkë automatike, me tre karikator të mbushur, me municion për pushkë automatike, me karabinë, armë zjarri e tipit TT 7.62, me karikator të mbushur me municion dhe katër bomba dore. Pas tentimit të dytë që ta privojnë nga liria, në një distancë prej rreth 200 metra në afërsi të shtëpisë së tij, përsëri ka hapur zjarr ndaj pjesëtarëve të policisë, prapë është kapur për bombën e dorës dhe ka tentuar që ta përdor të njëjtën ndaj tyre, kështu që policia është përgjigjur dhe i njëjti është vrarë", thonë nga Policia. Përndryshe, që nga orët e hershme të mëngjesit të së hënës, forca të mëdha policore kanë qenë të pranishme në këtë fshat për çka edhe banorët janë sh-



prehur të shqetësuar për praninë e madhe të policisë në fshatin Llërcë. Diku në mesditë, trupi i pajetë i Jeton Rexhepit është marrë për obduksion nga ana e policisë, ndërsa ekipet e gazetarëve deri vonë nuk janë lejuar që të hyjnë në fshat. Po ashtu, në vendngjarje kanë qenë edhe ekipet e Mjekësisë Ligjore dhe të Prokurorisë Themelore të Tetovës.

KRONIKË

Dëmtohet
vetura nga
plumbi
pa cak

Të dielën, sipas dyshimeve, nga një plumb pa cak është dëmtuar vetura "Opel Frontera" me targa të Gostivarit, pronë e 23-vjeçarit A.A. nga Gostivari, e cila ka qenë e parkuar në oborrin e shtëpisë në rrugën "Trajko Jovanovski". Plumbi ka rënë dhe e ka thyer pjesën prej qelqi të veturës. Pas kryerjes së hetimeve, xhami është marrë për ekspertizë. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit dhe të gjitha detajeve, kush, ku dhe pse ka shtënë me armë zjarri, dhe ka dëmtuar veturën e personit A.A.

27-vjeçari
sulmohet
nga 15 qen
endacak

27-vjeçari me initiale D.M. nga Gostivari ka denoncuar se të dielën mbrëma, derisa ka lëvizur nëpër parkun përballë shkollës së mesme komunale ekonomike në Gostivar, ka qenë i sulmuar nga një grup prej 15 qenve endacak ku tre prej tyre janë vërsulur ndaj tij dhe e kanë kafshuar në pjesën e poshtme të shpinës. Personi i sulmuar ka arritur të ikë dhe të largohet, prej ku është drejtuar në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murat" në Gostivar, për dhënien e ndihmës së mjekësore.

Konsumon
tableta,
vajza
përfundon
në spital

Në qendrën urgjente të Spitalit të përgjithshëm "Ferid Murat" në Gostivar, të dielën rreth orës 18.00, është pranuar 17 vjeçarja nga rrethi i Prilepit, e cila paraprakisht ka konsumuar dhe është helmuar me tableta të llojllojshme. Pas dhënies së ndihmës mjekësore, në gjendje kontaktibile, minorenja është dërguar në Klinikën për Toksikologji në Shkup. (U.H)

KONFERENCË DYDITORE PËR ENERGETIKË

GRATË, PA HAPËSIRË
VEPRIMI NË ENERGETIKË

Konferenca që u mbajt të hënën në Shkup do të ndihmojë të promovohen modelet për inkuadrim më të madh të grave profesioniste, si një nga parakushtet për përmirësimin e suksesit të kompanive dhe zhvillimit të sektorit energjetik

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 4 qershor - Përkundër faktit se studentet në Maqedoni dhe rajon janë më të mira dhe përbëjnë afër gjysmën e studentëve të diplomuar në fakultetet teknike, ato pas diplomimit shumë pak i gjejmë në pozitë udhëheqëse në sektorin e energjetikës në Maqedoni. Është kjo fushë që tradicionalisht dominohet nga burrat, për shkak të teknologjive që janë shfrytëzuar në të kaluarën si dhe për shkak të kushteve të rënda të punës.

Megjithatë, edhe pse teknologjia e reja mundësojnë lehtësimin e angazhimit fizik në një numër të madh të aktiviteteve, sërisht nevojitet të ndryshohet edhe perceptimi i njerëzve se gratë, edhe në këtë profesion mund ti përgjigjen të gjithë pozitave të punë, në mënyrë të barabartë me burrat. Bile edhe statistikat tregojnë se shumë pak ka gra në pozitë udhëheqëse, ose pak gra menaxhojnë me kompanitë e mëdha energjetike në rajon.

E njëjtë është situata edhe në Maqedoni. Andaj, edhe konferenca që u mbajt të hënën në Shkup do të ndihmojë të promovohen modelet për inkuadrim më të madh të grave profesioniste, si një nga parakushtet për përmirësimin e suksesit të kompanive dhe zhvillimit të sektorit energjetik. Kjo ndër të tjerash u theksua në ngjarjen e dytë kushtuar iniciativës për promovimin e pjesëmarrjes dhe inkuadrimin më të madh të grave në sektorin e energjetikës. Konferenca "Gratë në energjetikë", organizuar nga Institucioni i inxhinierëve të Maqedonisë dhe EVN Maqedoni, përkrahur edhe nga më shumë kompani dhe organizata si Elektranat e Maqedonisë, MEPSO apo Kompania e largpërcimit të rrymës së Maqedonisë etj, kishte për qëllim të rrisë vetë-



PELLAGONIA KRYESON ME VENDE TË LIRA PUNE

Në tre muajt e parë të vitit në Maqedoni ka pasur 8331 vende të lira pune. Më së shumti punëtorë kanë munguar në veprimtaritë shërbyese dhe shitje, ndërsa sipas rajonit, më të kërkuar kanë qenë punëtorët në rajonin e Pellagonisë. Enti Shtetëror për Statistikë publikoi se në tremujorin e parë të vitit 2018, shkalla e vendeve të lira të punës arrin 1.68 për qind. Shkallë më të lartë të vendeve të lira të punës ka në sektorin Veprimtari shërbyese administrative dhe ndihmëse, 4.25 për qind, derisa më e vogël është shkalla në sektorin e Drejtorisë publike dhe mbrojtjes, sigurimit dhe obliguar social, ku arrin 0.20 për qind. Më së shumti punëtorë janë kërkuar në subjektet afariste me numër të të punësuarve prej tre deri në nëntë, ku shkalla e vendeve të lira të punës ka arritur 1.91 për qind. Shkalla e vendeve të lira të punës në rajonin e Pellagonisë arrin 3.15 për qind. Por sipas numrit më së shumti vende të lira të punës ka pasur në rajonin e Shkupit, 4137. Sipas të dhënave të publikuara në grupin e punëtorëve në veprimtaritë shërbyese shitje ka pasur për 2929 vende të lira pune.

dijen për balansin gjinor në komunitetin e biznesit, si dhe të identifikojë strategjitë dhe programet për mundësi të barabarta në sektorin energjetik

"Një nga qëllimet e kësaj konference është edhe mënyra si të gjejmë përgjigje se pse ka shkapërdhje pas përfundimit të studimeve të tyre dhe, deri në avancimin e tyre në top pozitë menaxheriale në kompanitë energjetike. Kam bindjen se mendësia tradicionale për gratë që kujdesen për familjen apo fëmijët, nuk i mundësojnë asaj të avancohet në aspektin profesional", tha profesoresha universitare Hristina Spasevska, kryetare e In-

stitucionit të Inxhinierisë së Maqedonisë, ku janë anëtare mbi 20 shoqata të ndryshme të fushës së inxhinierisë

Sipas saj ky dallim gjinor nuk ekziston vetëm në Maqedoni, por edhe 12 shtetet e Evropës Juglindore që marrin pjesë në këtë konferencë, andaj nevojitet që gratë të inkurajohen më shumë të marrin vendin e tyre të merituar në këtë sektor. Në këtë drejtim do të formohet edhe Shoqata e grave në Energjetikë të Republikës së Maqedonisë, njoftoi Spasevska.

Nga ana tjetër, ministrja e Punës dhe Çështjes Sociale, Mila Çarovska, theksoi se hendeku gjinor jo vetëm në energjetikë duhet të tejkalohet me angazhimin jo vetëm qeveritar, por edhe të të gjithë faktorëve të rëndësishëm në shoqëri.

"Një nga çështjet që po debatohet këtu është edhe fakti se si të stimulojmë gratë që më shumë të inkuadronen në biznes. Në këtë drejtim nevojitet që të gjitha palët e përfshira të japin kontributin e tyre për shkak se vetëm një platformë për barazi gjinore nuk mund të jep rezultate", nënvizoi Carovska. Nga EVN Maqedoni ofruan mbështetjen e tyre në inkuadrimin sa më të madh të grave në sektorin e energjetikës.

"Hendeku gjinor akoma nuk është mbyllur andaj edhe mbajtja për herë të dytë e kësaj konference paraqet këmbënguljen tonë që të rrisim vetëdijen që të kemi më shumë gra në pozitë udhëheqëse, dhe atë jo vetëm në sferën e energjetikës", theksoi Shtefan Peter, kryetar i Këshillit drejtues të EVN Maqedoni.

Mbase, kjo konferencë dyditore, duhet të mundësojë që, përmes ligjëratave, punëtorëve dhe diskutimeve, të nxiten gratë, dhe sidomos intelektualët e reja, që të vazhdojnë me thëllimin e tyre profesional dhe arrijen e rezultateve të lakmueshme në karrierë.

FATURA MË TË ULËTA PËR NGROHJE QENDRORE PËR SHKAK TË DIMRIT TË NGROHTË

BEG - Furnizimi me energji ngrohëse më shumë se gjysmës së konsumatorëve ose 62 për qind, do t'u dërgojë fatura më të ulëta ose të barabarta me avanset, kumtojnë nga kompania. Vlera e faturave me parapagesë, sqarohet prej atje, është e ndryshme për çdo konsumator dhe varet nga karakteristikat dhe efikasiteti energjetik i objektit dhe gjithsesi nga sasia e matur e energjisë elektrike të objektit. "Edhe pse sezoni i kaluar ngrohës ka zgjatur gjashtë ditë më shumë se zakonisht, megjithatë, temperaturat e larta mesatare të jashtme gjatë dimrit të kaluar e

zvogëluan dërgesën e energjisë ngrohëse në sistemin qendror për energji elektrike në Shkup. Sasia më e vogël e energjisë ngrohëse të dërguar deri te konsumatorët nga parashikimi do të nivelizohet në faturat për muajt maj, qershor dhe korrik, kur zakonisht bëhet parapagesa mes energjisë ngrohëse të dërguar reale nga ajo e parashikuar", citojnë në kumtesë. Konsumatorët gjatë tërë vitit, në llogaritë e tyre kanë të dhëna për atë se sa energji kanë shpenzuar, si dhe për vlerën e dallimit mes energjisë ngrohëse të shpenzuar dhe të parashikuar.

KËRKESA 20 VJEÇARE DREJT REALITETIT

XHAMIA NË KODRËN E DIELLIT DREJT PËRFUNDIMIT

“Kjo xhami ka arritur deri në këtë nivel që është që do të thotë se skeleti i objektit është bërë, është duke u vendosur rryma, kanalizimi dhe uji është duke u instaluar, janë vendosur dritaret. Jemi afër përfundimit të punëve. Deri diku është punuar edhe në ndërtimin e minares, por bazamenti ka marrë kohë, dhe javën e ardhshme do të vazhdohet me ndërtimin edhe të minares”, tha myftiu i Tetovës, Qani ef.Nesimi



ardhshme do të vazhdohet me ndërtimin edhe të minares”, tha myftiu i Tetovës, Qani ef.Nesimi. Ai ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie. Sipas myftiut të Tetovës, nëse ka donacione të mjaftueshme dhe punët vazhdojnë me këtë dinamikë, xhamia nga fundi i muajt tetor të këtij viti pritet të hapet edhe zyrtarisht. Edhe pse deri më tani ka patur shumë kërkesa dhe peticione që të ndërtohet një xhami në Kodrën e Diellit, megjithatë çdoherë ka patur pengesa që e kanë penguar ndërtimin e së njëjtës. “Nuk ka fjalë se çdo xhami e bën xhemati i vet. Ajo është një xhami që ka një xhemat ndoshta sezonal atje, po gjithë xhemati i muftinisë së Tetovës është mjaft i interesuar dhe kemi edhe xhematë të muftinive të tjera, të cilët kanë shtëpitë apo vilat e tyre atje... pra të gjithë janë të interesuar që atje të ketë një objekt fetarë. Edhe rruga e financimit të atij objekti do të jetë është me kontributet vullnetare të popullatës dhe shoqërisë sonë dhe ne aspak nuk kemi dyshim se me kontributet e shoqërisë, do të arrijmë që atë objekt ta ndërtojmë ta finalizojmë që të jetë në shërbim të shoqërisë. Në këtë kontekst, xhamia do të jetë një objekt që do të shërbejë atij vendi që men-

doj se ky objekt ka munguar shumë”, deklaroi Nesimi. Gati se 20 vite, banorë të Tetovës, të cilët kanë vikend-shtëpiza në Kodrën e Diellit janë duke prituri leje nga Komuna për të ndërtuar një xhami, por assesi kjo leje të jepet. Përdërisa pronarët e vikend-shtëpizave janë mbi 50 për qind të përkatësisë fetare islame, në këtë pikë turistike ka vetëm kishë, madje edhe në pjesën më të dukshme të saj, ndërsa muslimanët nuk kanë asnjë objekt fetarë të tyre. Kërkesa e kamotshme daton që nga viti 1996, ndërsa në vitin 2006 është dorëzuar kërkesë në mënyrë zyrtare në Komunën e Tetovës për dhënien e lejes së ndërtimit të xhamisë në pikën turistike Kodra e Diellit. Prej vitit 2006 e kënde, sërish ka patur zhagjitje të ndryshme, gjithmonë me arsyetimin e lejes së ndërtimit. Në vitin 2014 sërish është dërguar në mënyrë zyrtare një kërkesë në Komunën e Tetovës për të realizuar këtë projekt. Në atë kohë, problem nuk ishte leja, por lokacioni. Më në fund edhe lokacioni pasi që u gjet, u fillua me punë, ndonëse kishte reagime nga mediat maqedonase për lejen e ndërtimit. Banorët e vikend-shtëpizave, por edhe qytetarët tjerë e kanë mirëpritur ndërtimin e xhamisë e cila pritet që në muajin tetor të jetë gati.

Mbi 2800 kërkesa për subvencione për biçikleta

Shkup, 4 qershor - Nga publikimi i thirrjes publike e deri më sot deri te Qyteti i Shkupit janë parashtruar 2860 kërkesa për subvencione për blerjen e biçikletës, ndërsa buxheti i paraparë për këtë dedikim mbesin mjete për edhe rreth 300 kërkesa, informojnë nga Qyteti i Shkupit. Mjetet që Qyteti i Shkupit i subvencionon janë në vlerë prej 50 për qind nga vlera e biçikletës, por jo më shumë se 3000 denarë për person, me tatim të përfshirë personal të të ardhurave, si dhe 50 për qind nga vlera e biçikletës së adaptuar për person me invaliditet trupor, por jo më shumë se 90.000 denarë për person, me tatim të përfshirë personal të të ardhurave. Për subvencionimin e qytetarëve për furnizim të biçikletës në buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2018, janë paraparë 10 milionë denarë, prej të cilave nëntë milionë denarë janë paraparë për subvencione, derisa një milion denarë për biçikleta të adaptuara, derisa një milion denarë për biçikleta të adaptuara për persona me invaliditet trupor. Thirrja publike realizohet sipas parimit "kush vjen i pari, shërbehet e pari". Rregulloren për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga buxheti i Qytetit të Shkupit për subvencionimin e qytetarëve në rajonin e Qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave për vitin 2018 qytetarët mund të marrin në linkun në vijim. Kërkesën për marrjen e subvencioneve qytetarët mund ta marrin në linkun në vijim. Subvencionimi i qytetarëve për furnizimin e biçikletave është njëra ndër masat e Qytetit të Shkupit për promovimin e biçikletës si mjete rekreativ dhe transportues.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 4 qershor - Një ëndërr e kamotshme e besimtarëve mysliman të Tetovës me rrethinës për të pasur një objekt kulti fetar të besimit Islam edhe në Qendrën turistike Kodra e Diellit si duket po bëhet realitet. Ndërtimi i xhamisë në Kodrën e Diellit ka arritur në fazën karabina, gjegjësisht në fazën finale të ndërtimit, ndërsa kanë mbetur edhe disa punë të tjera që ky objekt të finalizohet tërësisht dhe të jetë në funksion të besimtarëve mysliman. “Kjo xhami ka arritur deri në këtë nivel që është që do të thotë se skeleti i objektit është bërë, është duke u vendosur rryma, kanalizimi dhe uji është duke u instaluar, janë vendosur dritaret. Jemi afër përfundimit të punëve. Deri diku është punuar edhe në ndërtimin e minares, por bazamenti ka marrë kohë, dhe javën e

33.4 milionë dollarë grante për kopshtet dhe shërbimet sociale

Çashkë, 4 qershor - Grante për komunat për ndërtimin e kopshteve të reja, për renovim dhe ridedikim të objekteve ekzistuese në institucione për fëmijë të moshës parashkollore, paralajmëroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski në hapjen e kopshtit të parë në Komunën e Çashkës, ku mori pjesë edhe ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. Bëhet fjalë për projekt në vlerë prej 33,4 milionë dollarë, që Banka Botërore, gjatë takimeve të pranverës shfaqti interes që ta financojë.



Përveç ndërtimit dhe rikonstruimit të kopshteve nga huaja nga Banka Botërore do të shfrytëzohej

edhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në institucionet parashkollore, avancim të programeve

mësimore dhe trajnim të kuadrove. Gjithashtu, do të ndahen grante dhe shërbime të tjera sociale në ni-

vel lokal. “Në vijim është Misioni i ekipit të Bankës Botërore për vlerësimin e projektit. Negociatat midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe bankës duhet të fillojnë në fillim të korrikut. Për në fund të shtatorit planifikohet që projekti të aprovohet nga Bordi i drejtorëve të Bankës Botërore. Nënshkrimi i marrëveshjes duhet të ndodhë në fund të vitit”, deklaroi ministri i Financave, Tevdovski.

Siç theksoi ai, janë hasur një numër i madh të problemeve në arsimin parashkollor. Numri i kopshteve është i pamjaftueshëm, kapacitetet janë më të vogla nga ajo e nevojshme, gjithashtu edhe numri

i të punësuarve. Ndërkaq, siç tha Tevdovski, Qeveria menjëherë është angazhuar të tejkalohen këto probleme përmes sigurimit të më shumë mjeteve në buxhet. Ministri i Financave theksoi se buxheti i sivjetmë ka përcaktuar më shumë mjete për bllok dotacione për kopshte apo rreth 1,6 miliardë denarë. Janë paraparë edhe mjete për 200 punësime të reja në kopshte si dhe për rritjen e pagave të të punësuarve për pesë për qind, duke filluar nga shtatori i këtij viti. Tevdovski tha se në buxhetin për vitin 2018 ka 58 milionë denarë për ndërtimin dhe pajisjen e kopshteve për fëmijë dhe objekteve për mbrojtje sociale.

Për një lexues më shumë

Nga

Granit KURTI



Mund të ketë pasur ndonjë tjetër punë, por ia kishte mësyrë qendrës në kërkim të një libri, si në mjegull e kujtonte se bëhej fjalë për një histori me shqiptarë që dikur kishin qenë të zotë deri në Venedik, tek ngulmonte se e kishte botuar filan botues, se e kishte pasur në dorë, por s'i kishin qëlluar para në xhep ose diçka e tillë. Më vonë do ta kuptoja s'e libri që ai kërkonte ishte i një almet historiani britanik dhe do të botohej disa muaj më vonë, se historinë që kishte arritur ta kapte ishte paralajmërimi se ai do të përkthehej edhe në shqip. Do ta harroja si takim e si ngjarje sikur komshiu të mos ngulmonte për të dytën herë, edhe pasi shtrënguam duart tek më thoshte se më lexon përditë në gazetë, e kur nuk i del kohë, e ruan faqen ku është botuar artikulli im, i rikthehet me vëmendje. Më kishte "lexuar edhe dje, edhe pardje. Përditë të lume".

Kisha kohë që nuk shkruaja. Mbase edhe vite. Sikur tash, kur rikthimi i kohëpaskohshëm të ngarkon edhe më me ndjenjën se duhet të thuash diçka të madhe. Ai vazhdonte të më lexonte. "Veçmas reportazhet", më thoshte drejt në sy, me sigurinë e një berberi të moçëm që po të dojë të rruan edhe symbyllur. Kishte kohë, ash-tu si edhe sot, që shëtis trup e tërthor vendit me reportazhet e kolegëve tek i lexoj në gazetë. Doja të gjeja një lloj arsytimi edhe për të, edhe për vete, se në mos më kishte ngatërruar, por s'më la fort kohë kur krejt në fund më përmendi saktë në emër. M'u duk sikur u qesha, por kur e kujtoj tash, duhet te ketë qenë një lloj buzëqeshjeje si ajo kur ta kërkojnë për të dalë në ndonjë fotografi, që më fort i ngjan zgërdhirjes me vetveten.

Do ta harroja si takim dhe si ngjarje sikur libri që kërkonte komshiu të mos përurohej në Prishtinë, në majin e 2016-s. Salla që mbushur plot. Disa kishin ardhur kastile, disa sa për t'u parë aty, e nja tre-katër veta edhe të flisnin për librin krahas autorit. Në mesin e tyre ishte përbiruar edhe një profesor universitar. I sigurt ia mësyu foltores, përshëndeti të pranishmit dhe tha rafall atë që ia merre

mendja. Dikur guxoi ta quante edhe vepër monumentale apo diçka e tillë, almet pune shkencore e këtij historiani të huaj. Luajti në terren të sigurt: vepra mund të ishte monumentale, sepse autori ishte i njohur e i dëshmuar për të tilla. Bisedoi edhe me autorin, e përgëzoi për librin. Dhe mbase edhe ia rrahu krahët. Pastaj u kthye në realitet. Si kalimthi, në dalje të sallës dikush ia kërkoi një detaj për librin. "Çështje e vërteta...", ia nisi me elegancë arsytimit për ta thjeshtëzuar edhe më. "Dorën në zemër, s'e kam lexuar".

Para dorës në zemër, e para se të dilte në foltore, profesori do të duhej ta vinte gishtin në kokë. Mbase duhet t'i ketë rënë në dorë libri "Si të flasim për librat që s'i kemi lexuar?" i Pierre Bayardit, autor francez, profesor letërsie e psikanalist. Por rastësinë e ngre nga negacioni përgjigjja e tij. Sikur ta kishte lexuar këtë, përgjigjja do të ishte tjetër. Ose së paku ka shfletuar kapitullin e parë ku ta pranojë mosleximin është gjysma e punës, ballafaqimi me vetveten. Edhe atë tjetrin ku Bayard thotë se mund të flasësh edhe për veprat që s'na kanë rënë në dorë. Ka

një hile në krejt këtë studim shkencor të francezit, i cili e pranon se jo rrallë studentëve u zbërthen edhe romane, të cilat as që i ka shfletuar. Por kushti i tretë "që të flasësh për librin që s'e ke lexuar" është që ta përzgjedhësh titullin që s'e ka lexuar as auditori. Profesori e ka plotësuar pjesërisht një kusht të tillë pasi për veprën i ka folur edhe vetë autorit. Bayardi e kishte nisur ta shkruante këtë libër për çështje krejt praktike. I rritur në një ambient ku, siç thotë ai, lexohej pak, e pranon se s'është i dhënë fort pas kësaj veprimtarie. "Duke mos pasur as shumë kohë që t'i përkushtohem, në përvorjet jetësore jo rrallë më ka bërë vaki të përballem me situata të zorshme kur kam qenë i detyruar të flisja për libra që s'i kam lexuar", shkruan ai në hyrje të librit të tij. "Si profesor universitar, pashmangshëm jam i detyruar që të interpretoj vepra të cilat as që i kam shfletuar. Dorën në zemër, i njëjti rast është edhe me shumicën e studentëve që ndjekin ligjëratat e mia. Por mjafton të më dalë njëri që e ka lexuar tekstin për të cilin u flas e të reflektojë mbi ligjëratën time dhe në çdo moment të më

Le ta quajmë komshi, krejt për çështje praktike si puna e furrtarëve që kështu u drejtohen të gjithë myshterinjve të tyre, sa për të kryer punë a për të shitur një bukë më shumë. Banon ca kilometra larg meje, në lagjen - që siç ma kishin përshkruar Prishtinën, që unë s'e kam parë e përjetuar - dikur e paskëshin quajtur mëhallë shkrimtarësh, poetësh, me një kuart artistësh diku në mes. Për t'i rënë prerë, çerdhe intelektualësh. Kishte të atillë në mesin e tyre, por më pak sesa asi që bëheshin sikur



rrezikojë të përballem me situatë të palakmueshme". Në esencë, eseja e tij ka të bëjë me të pranuarit e konceptit të mosleximit. Mbase aty është pikënisja për të vepëruar kundër. Prej kësaj përvoje Bayard shkroi libër - për dikë shkencor e për dikë as afër kësaj - por ka vite që "Si të flasim për librat që s'i kemi lexuar?" është bestseller. Si puna e komshiu dhe e profesorit vendor ka pasur gjithëherë dhe po lindin ditaditës. Dhe shiten si bestsellerë.

Bashkëvendësit e Bayardit dolën keq si lexues në hulumtimin që "Eurostat" nxori prillin e kaluar. Prej vitit 2008 deri më 2015 kyshërbim evropian statistikor kishte anketuar respondentë prej moshës 24 deri në 70-vjeçare nga 15 vende anëtare të BE-së, si dhe të Norvegjisë, Serbisë e Turqisë. Francezët doli se lexojnë libër mesatarisht 2 minuta në ditë duke mbetur prapa austriakëve e rumunëve, që lexojnë 5 minuta në ditë, apo serbëve me 6 minuta. Listës i prinin estonezët që lexojnë mesatarisht 13 minuta në ditë pasuar prej finlandezëve e polakëve me një

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 4 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

minutë më pak. Ashtu sikurse edhe norvegjezët, hungarezët e kanë librin në dorë mesatarisht 10 minuta gjatë ditës. Po sipas këtij hulumtimi, familjet e këtyre vendeve kanë shpenzuar 90 miliardë apo 1.1 për qind të shpenzimeve në tërësi në libra, gazeta e material të botuar. Kjo i bie 0.6 për qind e bruto-produktit në BE. Llogaritur për kokë banori, bëhet fjalë për 200 euro të shpenzuara në libra e gazeta. Kësisoj i bie që familjet në BE për libra dhe material të botuar ndajnë më pak sesa gjysmën e mjeteve që shpenzojnë për rekreacion dhe përmbajtje kulturore.

"Eurostati" u mor edhe me ata që i quan "lexues të deklaruar", sa për të mos i quajtur mashtrues. Asi që do të gjente me bollëk në Kosovë, sikur hulumtimin ta shrinte edhe këndej. Me të tillë pati punë edhe organizata joqeveritare "ETEA", e cila në të njëjtën ditë me "Eurostatin" nxori rezultatet e hulumtimit "Lexueshmëria në shkollat e mesme të larta të Prishtinës". Ndër të tjera, në pyetjen se a lexojnë familjet e tyre, hiç më pak se 90 për qind e nxënësve u përgjigjën pozitivisht. "Shqetësues", qe përshkrimi më i lehtë që hulumtuesit ia bënë një dukurie të tillë. Se as shteti e as libri s'janë në gjendje të mirë, nuk është ndonjë konstatim i ri. Shtetin e kanë në dorë pushtetarët, librin duhet ta kenë në dorë lexuesit. Për ta shpëtuar shtetin, Charles Hill, diplomat e ligjërues në Universitetin e Yale, ka një formulë. "Sot edhe shteti, edhe letërsia janë në rrezik. Por burrështetasi duhet ta respektojë letërsinë si një thesar të dijes së neglizhuar dhe si një ilaç për kohë të vështira. Ata duhet ta përdorin atë si një kontekst për sfidat dhe detyrat e tyre politike, dhe ta kompensojnë atë për dobësitë e tyre personale", është porosia e tij. Fiks pesë minuta e tridhjetë sekonda më ka zgjatur rileximi i këtij teksti që po e lexon. Nëse profesori universitar do ta lexojë, do të bëhej një gjysmë finlandezi, apo dy herë francez dhe s'do t'i hynte në punë Bayardi. Nëse komshiu do ta gjejë veten në mes të rreshtave, ia kam arritur qëllimit - për një lexues më shumë.

Italia dhe Evropa hyjnë në territore të panjohura



Nga Bernard GUETTA

Më e pakta që mund të themi, është se Evropa po lëkundet.

Më 1 qershor, në Madrid, presidenti i këshillit të ministrave të Spanjës, konservatori Mariano Rajoy, është larguar nga posti i tij për shkak të një mocioni mosbesimi, që ka sjellë në pushtet socialistin Pedro Sánchez.

Në vetvete nuk do të ishte një problem për unitetin evropian, për të cilin socialistët spanjollë janë mbështetës të zjarrtë, por është gjithashtu e vërtetë që Sánchez formoi një koalicion jashtëzakonisht të ndryshëm, në të cilin gjejnë hapësirë separatistët katalanas, nacionalistët baskë dhe Podemos, formacioni radikal i majtë. Këto parti nuk kanë asgjë të përbashkët, përveç zemërimit kombëtar, po ai zemërim që tashmë ka dhënë disa dënime të rënda për korrupsion, kundër dhjetëra njerëzve të lidhur me Partinë Popullore të Rajoyt. Mocioni i mosbesimit, i justifikuar

plotësisht, hap një periudhë paqëndrueshmërie, gjatë së cilës socialistët do të duan të rindertojnë popullaritetin e tyre me anë të masave sociale (shpesh të pranueshme), përpara se sa zgjedhjet e ardhshme, të riformesojnë skakierën politike. Prandaj, për disa muaj, Spanja do të lëkundet.

Ndërkohë, në Itali, ekstremistët e krahut të djathtë të Le-gas dhe lëvizja me lëvizja antisistem, 5 Yjet, janë gati të marrin pushtetin. Të dy palët ranë dakord të mos ia besonin ministrinë e ekonomisë, një mbështetësi të deklaruar të daljes nga eurozona. Kreu i shtetit, Sergio Mattarella, këtë herë hapi rrugën. Pa dyshim kjo zgjidhje është më mirë se një kthim në zgjedhje në vjeshtë, por mbetet fakti se ekonomia e tretë e BE hyn në një territor të panjohur, pikërisht kur Donald Trump po sfidon Evropën duke imponuar tarifa doganore prej 25% për çelikut, dhe 10 për qind për aluminin.

Evropa po lëkundet dhe kjo i bashkohet krizës së Ukrainës, kaosit në Lindjen e Mesme, kërcënimeve të Lindjes dhe nacionalistëve të Evropës Qendrore dhe "fetishizmit fiskal" të Evropës Veriore, theksuar fort nga Emmanuel Macron. Evropa po lëkundet, nuk ka dyshim për këtë, por përtej ndarjeve, evropianët janë të vetëdijshëm për një sulm frontal amerikan, një sulm që i ka bërë të gjithë ta kuptojnë, nga veriu në jug, dhe nga lindja në perëndim, në Romë ashtu sikurse në Madrid, se në këtë pikë është e nevojshme të shtrëngohen radhët, duke kundërvënë "Evropën e bashkuar" me "Amerikën të parën".

Bashkimi Evropian është duke u përgatitur për t'iu përgjigjur rimës së amerikanëve, me masat e menjëhershme të hakmarrjes dhe adresimin e Organizatës Botërore të Tregtisë. Fluctuat nec mergitur: "lëkundet, por nuk fundoset". (France Inter)

Evropa po lëkundet dhe kjo i bashkohet krizës së Ukrainës, kaosit në Lindjen e Mesme, kërcënimeve të Lindjes dhe nacionalistëve të Evropës Qendrore dhe "fetishizmit fiskal" të Evropës Veriore

Ilindita me luanë të zgjebosur



Nga Dr. Bekim TATESHI

Maqedonia, kjo gocë 27-vjeçare pa emër dhe mbiemër, hyn në një fazë vendimtare për definimin e rrugëtimit të saj në procesin e rregullimit të rendit të ri botëror. I ndjeri Arben Xhaferi duke shkruar se "Maqedonia më shumë ka problem me mbiemrin sesa me emrin" me një fjali na qet në sipërfaqe një të vërtetë e mbështjellur me shumë politikë pise alla-ballkançe. Ndarja e vështirë me gjysëm zemër nga ish-Jugosllavia dhe për shkak të situatës të rikrijuar, paraqitja e dëshirës për formim të një shteti të ri duke u bazuar në eliminimin dhe mosrespektimin e vullnetit të popullit autokton në Gadishullin Ilirik, rezultoi me krijim të një problemi të ri në këto hapësira me shumë turbullira gjatë shekujve të kaluar. Ndoshta kjo periudhë kohore edhe nuk është shumë e gjatë, por për gjeneratën time edhe ka vlerë se gjith jetën e kemi kaluar në reforma afatshkurte dhe të papalnikuara mirë apo të planifikuara me qëllime të caktuara nga armiq

dhe bashkëpunëtorë të tyre shqipfolës, ndikimi i të cilëve vazhdon edhe në ditët e sotme.

Problemi disadekadësh i emrit ndërthen ne vete kryqëzime të interesave të ndryshme lokale por edhe më gjerë. Personalisht mendoj se më shumë bëhet fjalë për problem artificial me të cilin rryma të errëta me sukses shtyn integrimin e këtyre hapësirave në proceset euroatlantike si dëshirë e shumë popujve të Gadishullit Ilirik. Tani më erdhi koha t'i jepet fund këtij cirku me palaço të maskuar dhe demaskimi i tyre do të ishte më se i nevojshëm për të mirën e të gjithëve që jetojmë këtu. Se çdo vonesë mund të trazojë edhe një here regjionin që do na çonte në edhe një katastrofë ekonomike me pasojat e saj në çdo sferë të jetës. Mos harrojmë se përveç shumë arsyeve tjera socioekonomike, mosintegroimi po ashtu është një faktor shumë i rëndësishëm në emigrimin shqetësues të rinisë drejt perëndimit për jetë më të mire dhe më e rëndësishme, për jetë më të sigurt për më të dashu-

rit e tyre.

Jemi dëshmitar për propozim-emrin e ri nga qeveritarët momental, i rrezikshëm dhe qesharak. Më të mjerë dhe bizar na dolën përfaqësuesit e integristëve që na befusuan si rrufeja në qiell të pastër, Republika Ilinditase e Maqedonisë. E paparë, e pamundur, e pabesueshme pa marrë parasysh kush e ka propozuar dhe me çfarë prapavije. Emri i gjoapropozuar ndoshta do të zgjidhte kontestin me Greqinë dhe do të ndihmonte në integrimin euroatlantik, por në planin e brendshëm do të ishte një mollë shërri që do të shkaktoje trazira të reja dhe mosmarrëveshje interetnike dhe intraetnike në gjeneratat e ardhshme, në të dyja taboret. Ky cirk ma kujton edhe idenë poashtu bizare dhe të rrezikshme për propozim-stemën e re me luan me arsyetime amatore-ske nga po të njëjtit aktorë. Në të dyja rastet ofendohet rëndë inteligjenca shqiptare e çdo qytetari dhe pa fije turpi mundohen të imponojnë diçka në të cilën edhe vet ata nuk besojnë. Injoranca shkon



Sipas të gjitha gjasave, duket se Ilindita do të mbarojë në Drislla së bashku me luanët e zgjebosur të stemës dhe ideve të shumta anormale, me shpresë që autorët të dënohen me votë në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që do të mbahen

deri në pakufi duke harruar se shqiptarët në Maqedoni kanë edhe opozitë me votues më shumë se pozita dhe moskujqja e opozitës në këto bisedime është jodemokratike dhe joparimore, por një gjë është e sigurt se në referendumin eventual ky propozim nuk do të kalonte nga shumica e shqiptarëve në Maqedoni. Si nxënës më kujtohet që nëpër librat e historisë maksimalisht është minimizuar roli dhe pjesëmarrja e shqiptarëve

në kryengritjen e Ilindenit, për të cilën duhet të na ligjërojë historianët dhe ta zbardhin këtë ngjarje që të kemi pasqyrë më reale çfarë ka ndodhur dhe ku jemi ne në këtë ngjarje historike.

Për fat të mire, shumë shpejtë ky propozim u anulua dhe tani shkohet me një emër tjetër që ndoshta do të kalojë barrierat dhe do të jetë i pranueshëm për të gjitha palët e kyqura dhe të të interesuara dhe kështu do të hapen dyert e integrimi të shumëpritura që përveç gjeografikisht, në Europë të jemi të integruar edhe gjeopolitikisht që do na mundësohet një bashkim shpirtëror me shqiptarët e shumë shteteve përreth dhe një bashkëpunim me popujt tjerë në këtë gadishull jo të qetë për shekuj me radhë. Pra, sipas të gjitha gjasave më duket se Ilindita do të mbarojë në Drislla së bashku me luanët e zgjebosur të stemës dhe ideve të shumta anormale, me shpresë që autorët të dënohen me votë në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që do të mbahen.



HAPET EDICIONI JUBILAR I PANAIRIT TË LIBRIT NË PRISHTINË

Sot më 5 qershor në prishtinë, hapet edicioni i 20-të jubilar i panairit të librit. Panairi i cili mbahet nga 5 deri më 10 qershor, në ambientet e pallatit të rinisë në kryeqytet, organizohet nga shoqata e botuesve të Kosovës. Kësaj, sivjet pritet që në këtë panair të marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora ndërsa numri i titujve të rinj sillet rreth 1400-1500.

Në vijim po sjellim të plotë agjendën e panairit të librit në prishtinë, aty ku mysafir special do të jetë shkrimtari francez, François-Henri Désérable i cili vjen në prishtinë më 7 qershor.

panairi jubilar, i 20-të, do të mbahet nga 5-10 qershor 2018 në ambientet e pallatit të rinisë, organizuar nga Shoqata e botuesve të Kosovës.

ceremonia e hapjes do të bëhet më 5 qershor, në orën 18:00 dhe transmetohet drejtpërdrejt, traditë kjo e televizionit publik të Kosovës – RTK-së. Panairi do të mbyllet më 10 qershor, në orën 18:00.

Panairi do të jetë i hapur për vizitorë çdo ditë, nga 9.00-20.00.



hyrja për vizitorë: gratis.} pritet të marrin pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora. numri i titujve të rinj, rreth 1400-1500. numri i titujve të viteve të fundit, rreth 5000.

panairin pritet ta vizitojnë rreth

40000 vizitorë: studentë, nxënës të shkollave të mesme dhe fillore të Kosovës, qytetarë dhe personalitete të shquara nga jeta akademike, letrare, politike e intelektuale e Kosovës.

Duke qenë panair tashmë me traditë të konsoliduar, dhe në 10-

vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, do të ketë edhe një varg aktivitete, të cilat përkohë me përvjetorë të mëdhenj të personaliteteve letrare shqiptare:

– 550-vjetori i vdekjes së heroit kombëtar gjergj kastroti – skënderbeu – vitit të skënderbeut, 300-vjetori i lindjes së teodor kavaliotit, 200-vjetori i lindjes së Zef Jubanit, 100-vjetori i lindjes së Tajar Hatipit, 100-vjetori i lindjes së Vorea Ujkos, 100-vjetori i lindjes së Spiro Çomorës, 100-vjetori i lindjes së Pashko Gjeçit

dhe botërore: – 200-vjetori i lindjes së turgenjev, 100-vjetori i lindjes së moris dryonit, 100-vjetori i lindjes së Solzhenicinit

SHBK-ja po ashtu ka paraparë darkën solemne më 7 qershor në hotel prishtina, ku do të nderohen me trofeun e panairit, sipas vlerësimit të jurisë speciale, librat më të mirë në:

– prozë, poezi, kritikë/studime letrare/eseistikë/publicistikë, përkthim letrar, projektin capital, si dhe shpallet:

– shkrimtari i vitit (letërsi shqipe)

– shkrimtari i vitit (letërsi e huaj)

– stenda më e vizituar

Panairi do të ketë edhe mysafirët e nderit, shkrimtarë të shquar shqiptarë dhe të huaj dhe do të organizojë përrurime, debate, paraqitje, dedikime shkrimtarësh: – më se 50 aktivitete.

BOTIME TË REJA

Bardi letrar kosovar në kontekstin politik



Autori i monografisë më elokuencë na njofton për ndikimin që patën shkrimtarët e huaj të Esat Mekuli si gjimnazist. Në këtë kohë mbase fillojnë edhe sprovat e para të djaloshit të ri. Poezitë e para i paraqet si kushtim ndaj motrës së tij 3 vjeçare e cila ju nda nga jeta. "Aventurat" e tij letrare të tjera në këtë periudhë janë edhe romani i tij i parë "Vendeta" (1928), ku për lexues të parë do t'i kishte shokët e tij Xhemal Kada dhe Ramiz Sadiku. Miqësia e familjes së tij me familjen Kada nëpërmjet martesës së motrës së tij me Rexhë Kadën do t'isillte afërsi të madhe me shokun e tij të ngushtë të shkollës Xhemal Kadën. Arratisja e Xhemalit në vitet 36-37, do ta pikëllonin Esatin. Korrespondenca e tij me Xhemalin për një periudhë u bë me letra.

Duke bërë fjalë mbi rolin e intelektualit si Esat Mekuli autori shtron disa dilema nëse Esat Mekuli ishte oportunist? Esat Myftari merr shembuj se si ka njerëz që e quajnë Mekulin "oportunist". Mbështetja te ky pietet qëndron te krijimtaria poetike e tij.

Shembull tipik është poezia e tij "Ramizo vëlla". Në kujtimet e viteve 80 Mekuli na dëfton se kjo poezi u shkrua në kohën kur ai qëndronte në Plavë në vitet 42-43. Pastaj shembuj të tjerë janë edhe poezitë kush-tuar "Njegoshit" me rastin e 100 vjetorit të tij. Të gjitha këto përshkruhen dhe arsye-tohen me ndershtëmeri nga Mekuli me rastin e shënimeve të tij në Rilindje. Esat Mekuli ndërroj jetë më 1993 në moshën 77 vjeçare. Për të do të flisnin figurat më të shquara të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kosovë si Idriz Ajeti, Enver Gjergjeku, Vehap Shita etj.



'Skenderbeu: Manuskripti i Marlout' i Ag Apollonit

Doli nga shtypi libri më i ri i shkrimtarit Ag Apolloni, i titulluar "Skenderbeu: Manuskripti i Marlout". Kjo dramë vjen si homazh për "Vitin e Skenderbeut" dhe na sjell një histori të shkruar sipas poetikës postmoderne të dorëshkrimit, pra si gjetje e një drame elizabetiane të shekullit 16 e cila konsiderohet dramë e humbur.

"Skenderbeu: Manuskripti i Marlout" është ndërtuar si një rrjet intertekstual me tekste historike, letrare, kinematografike dhe teatrore, duke krijuar kështu besueshmërinë e rrefimit dhe duke na prezantuar një hero të dualizuar, që perveçse mit, shfaqet edhe si një njeri i thjeshtë.

Drama është e përbërë nga dy pjesë, të ndara në skena. Skenderbeu i Apollonit është një Skenderbe postmodern, që aq sa i afrohet historisë, po aq i largohet asaj, duke u shfaqur

si një hero që i flet më së miri lexuesit të ditëve të sotme.

"Skenderbeu: Manuskripti i Marlout" nuk tenton të jetë një paraqitje strikte e fakteve historike, por synon të jetë një tekst që shfaq erudicionin e autorit dhe e largon këtë figurë historike nga patetizmi romantik. Ag Apolloni, në këtë dramë, nuk sjell risi vetëm artistike, por prish edhe funksionin mimetik të dramës, duke inkorporuar në tekst narrativin, që i mvesh dramës edhe statusin diegjetik.

Drama "Skenderbeu: Manuskripti i Marlout" plotëson kushtin që parashihet Horaci për letërsinë, "dulce et utile", pasi përveçse përcjell vlera estetike, i paraqet lexuesit një hero që nuk mund të qëndrojë i distancuar nga ana njerëzore.

Drama ka 287 faqe dhe është botuar nga Shtëpia Botuese OM, dega e Tiranës.

Studiuesit kanë analizuar mbi 1,700 romane, për të zbuluar gjashtë lloje të fabulave që mund të zbatohen në tregimet më të dashura, analizon Miriam Quick për BBC Culture

TREGIMI E KA BAZËN NË 6 MODELE FABULASH



“Kontributi im më i bukur për kulturë” ishte se si romancieri Kurt Vonnegut e kishte përshkruar tezën e vjetër të magjistraturës së tij në antropologji, “e cila u refuzua për shkak se ishte shumë e thjeshtë dhe dukej shumë zbavitëse”. Teza u fundos pa lënë gjurmë, por Vonnegut vazhdoi gjatë gjithë jetës së tij të promovojë idenë e madhe prapa saj: “Rrëfimet kanë forma të cilat mund të vizatohen në fletat me katrorë”.

Në një leksion të vitit 1995, Vonnegut vizatonte me shkumës në tabelën e zezë, harqe të ndryshme të tregimeve, duke treguar se si fati i protagonistit ndryshon gjatë rrjedhës së rrëfimit në boshtin që shtrihet nga “i mirë” te “i keq”. Harqet përfshinin “njeriun në vrimë”, në të cilën personazhi kryesor futet në telash e pastaj del përsëri (“njerëzit e duan atë histori, ata kurrë nuk lodhen nga kjo!”) dhe “djali merr vajzën” tek e cila protagonistit gjen diçka të mrekullueshme, e humb, pastaj e merr përsëri në fund. “Nuk ka asnjë arsye pse format e thjeshta të tregimeve nuk mund të analizohen në kompjuterë”, vuri në dukje ai. “Ato janë forma të bukura”.

Fal teknikave të reja, kjo tani është bërë. Profesori Matthew Jockers nga Universiteti i Nebraska dhe më vonë hulumtuesit në Universitetin e Vermontit, kanë analizuar të dhënat nga mijëra romane, për të zbuluar gjashtë lloje themelore të fabulave – që mund t’i quani arketipe – që formojnë blloqet ndërtuese për tregimet më komplekse. Studiuesit e Vermontit i përshkruajnë format e gjashtë fabulave – prapa 1,700 romaneve – si më poshtë:

Nga zhelani te pasaniku – një rritje e vazhdueshme nga fati i keq te i miri; Nga pasaniku te zhelani – rënie nga e mira në të keqe, një tragjedi; Ikarit – ngritje dhe rënie në fat; Edipi – rënie, ngritje, rënie; Hirushja – ngritje, rënie, ngritje; Njeriu në një vrimë – rënie, ngritje.

Hulumtuesit përdorën analizat e sentimenteve për të marrë të dhënat – një teknikë statistikore që shpesh përdoret nga marketingu për të analizuar postimet e mediave sociale, në të cilat secilës fjalë i jepet një “pikë sentimentit” të veçantë. Në varësi të fjalorit të zgjedhur, një fjalë mund të kategorizohet si pozitive (e lumtur) ose negative (e trishtuar) ose mund të shoqërohet me një ose më shumë

nga tetë emocionet më delikate, përfshirë frikën, gëzimin, habinë dhe pritshmërinë. Për shembull, fjala “lumtur” është pozitive dhe shoqërohet me gëzim, besim dhe pritshmëri. Fjala “braktisje” është negative dhe shoqërohet me zemërim.

Bëjeni analizën e sentimenteve në të gjitha fjalët e një romani, poeme ose drame dhe është e mundur të shihni se si ndryshon disponimi gjatë rrjedhës së tekstit. Teksa nuk është një mjet i përsosur – i shih fjalët në izolim, duke injoruar kontekstin – mund të jetë çuditërisht i dobishëm kur zbatohet te pjesë të mëdha të tekstit, siç tregojnë të dhënat për romanet e Jane Austenit, të ofruara nga shkencëtarja Julia Silge. Mjetet për të bërë analiza të sentimenteve janë të disponueshme falas dhe shumëçka nga literatura pa autorësi mund të shkarkohet nga interneti përmes Projektit Gutenberg. Ne i analizuam disa nga tregimet më të pëlqyera nga anketat e BBC Culture, për 100 veprat që ndryshuan botën, për të gjetur gjashtë llojet e fabulave.

LLOJI I FABULËS:

NGA ZHELANI TE PASANIKU

Poema jashtëzakonisht simetrike “Komedia hyjnore” e Dante Lighierit, gjurmon udhëtimin imagjinar të autorit në Ferr, në Inferno, i shoqëruar nga – kush tjetër? – pos poetit Virgjil. Gjërat fillojnë keq në “Komedinë hyjnore”,

me pikë të ulëta të sentimenteve që bien më shumë kur dyshja zbrit nëpër qarqet e Ferrit (aty gjen “njeriun në vrimë”). Duke mbijetuar Ferrin, ata ngjiten në malin e Purgatorit ku banojnë shpirtrat e ekskomunikuar, përtacët dhe lakmuesit, si dhe Beatrice – gruaja ideale e Dantes – që e zëvendëson Virgjilin si shoqëruesin e tij. Ngjitja e çiftit në qiell, në Paradiso, karakterizohet nga një gëzim në rritje, teksa poeti e kupton natyrën e vërtetë të virtytit dhe shpirti i tij bëhet një me “dashurinë që lëviz Diellin dhe yjet tjerë”.

LLOJI I FABULËS:

NGA PASANIKU TE ZHELANI

Është një moment në tregimin e Flaubertit (“ZONJA BOVARI”) për një shtëpiake të mërzitur dhe të pabesë, ku protagonistja Emma Bovary mendon se pasi jeta e saj deri tash ka qenë e keqe, pjesa tjetër duhet patjetër të jetë më mirë. Jo ashtu! Emma bie në afera të dështuara dhe të dëshpëruara të dashurisë, që i ofrojnë veç një kënaqësi të shkurtë nga mërzia e të qenët një grua imagjinateve e martuar me njeriun më të mërzitshëm në botë. Ajo futet në borxhe dhe në fund vret veten duke pirë arsenik. Burri i saj i pikëlluar, pasi zbulon pabesitë e shumta të saj, vdes gjithashtu, ndërsa vajza e tyre jetime dërgohet për të jetuar me gjyshen e cila gjithashtu vdes. Vajza e vogël shkon për të jetuar me një hallë të varfër, e cila e dërgon të

punojë në një fabrikë pambuku. Është pra një tragjedi e teksteve shkollore, i nxitur nga qëllimi i pamëshirshëm drejt rënies totale dhe një historie “të kënaqshme”!

LLOJI I FABULËS:

Ikarit: një ngritje, pastaj rënie. Djali duhet ta gjejë vajzën dhe të bie në dashuri me të para se të dy të humbasin njëri-tjetrin. Kulmi romantik ndodh në skenën e famshme të ballkonit në të cilën ata deklarojnë dashurinë e tyre të pavdekshme për njëri-tjetrin. Gjithçka është rënie nga aty. Romeo vret Tibaltin dhe ik, plani i Frattit për ta “kontrabanduar” Zhuljetën për t’u bashkuar me të është shpresë e rreme. E, sapo Zhuljeta e pi potionin, asgjë nuk mund të parandalojë tragjedinë përfundimtare.

LLOJI I FABULËS:

NJERIU NË VRIMË OSE HIRUSHJA

Gjysma e parë e romanit “Krenari dhe paragjykim” të Jane Austen është festa e ballos dhe e argëtimit (megjithëse të përmbytur), e kritikave dhe propozimeve joserioze të martesës nga tipat si famullitari komik z. Collins. Gjërat marrin një kthesë të errët kur Bingley largohet dhe Elizabeth krijon një antipati për Darcyn (bazuar në një keqkuptim, natyrisht). Senti-

menti i romanit përqendrohet në territor shumë negativ, pas propozimit të tij të keq, duke arritur në pikën më të ulët kur Lydia arratiset me Wickhamin e pabesë. Kjo sigurisht se është mundësia e Darcyt për të dëshmuar veten, të cilën gjë e bën me dinjitet dhe gjakftohtësi, duke fituar zemrën e Elizabethas dhe duke ofruar një fund të lumtur e të matur në të cilin të gjithë janë më të mençur se më parë.

LLOJI I FABULËS: EDIPI

Romani kryesor i Shelleyt (“FRANKENSHTAJNI”) tregon historinë e mjerueshme të Krijesës së Viktor Frankensteinit, me fjalët e Victorit, përmes kapitenit Walton, në një seri letrash për motrën e tij. Në një moment, Krijesa merr narracionin, duke e bërë romanin një tregim brenda një tregimi brenda një tregimi. Ky është në fakt një moment i kalimit në atë që është në përgjithësi një trajektore e rënies – nga përshkrimi i lumtur i jetës së tij të hershme, me të cilën Victori hap tregimin e tij – deri në fund të tmerrshëm. Në një moment Krijesa i ofron viktimës një rrugëdalje – t’ia bëjë një shoqe. Por, Victor refuzon. Prej kësaj pike, fati i tij është vulosur. “Mbani mend, unë do të jem me ju në natën tuaj të dasmës”, kërcënon Krijesa. Dhe, kështu del.

LLOJI I FABULËS: KOMPLEKSE

Historia më e shkurtë nga të gjitha përrallat e famshme të Hans Christian Andersenit, “ROSAKU I SHËMTUAR” ka gjithashtu strukturën më komplekse, përfshirë harkun e sentimentit të dy njerëzve në vrimë (ose një rosë në një vrimë) brenda kornizës narative të zhelanit drejt pasanikut. Pra, gjërat në përgjithësi janë të mira për rosakun në rrjedhën e tregimit, por ka shkëndija drite dhe errësirë përgjatë rrugës: ai del nga veza, por ngacmohet se është ndryshe; zbulon se mund të notojë më mirë se rosat e tjera dhe vëren një shenjë të keqe të përkatësisë në grup, sepse mjellmat fluturojnë më gjatë; e pastaj, pothuajse ngordhë në të ftohtit e dimrit. Në fund bëhet mjellmë, në mënyrën e parathënë në fillim. Kjo është esenca: “Të lindësh në një fole rosash, në një oborr ferme, nuk ka asnjë pasojë për një zog nëse del nga një vezë e mjellmës”. Historia mbaron me notat më të larta, pasi “kurrë nuk ëndërronte një lumturi si kjo”.

Poet unik

Poet dhe gazetar me prejardhje greke, u lind më 29 prill 1863 në Aleksandri (Egjypt), ku i ati zotëronte një firmë import-eksporti. Botoi sa qe gjallë 154 poezi, shumica të frymëzuara nga lashtësia; shumë të tjera i mbetën në dorëshkrim ose të papërfunduara. Poezitë më të ndjera i shkroi pas të dyzetave. Pas vdekjes së babait jetoi disa vite në Liverpool dhe në Londër, më pas në Stamboll. Pas vitit 1885 u rikthye në Aleksandri, ku jetoi deri në fund të jetës. Vdiq më 29 prill 1933, ditën që mbushi shtatëdhjetë vjeç. Kultura e madhe helene, me letërsinë e saj në qendër, që do të bëhej themeli i letërsisë europiane e më gjerë, dihet se ka qenë e shtrirë në tre kontinente dhe ishte mitër e njëkohësisht krijesë/prodakt i tërë këtij universi kulturor, të formuar prej racash e popujsh të ndryshëm. Ajo letërsi do të vijonte të kishite ndikimet dhe autoritetin e vet edhe në shekujt e mëpasëm. Ndër këta poet grekë që ushtroi ndikim edhe te formimi i autorëve grekë e shqiptarë, është edhe Konstandin Kavafis. Kavafis, poeti i madh grek i viteve '30, i cili edhe pse kishte një ide të qartë për rolin dhe rëndësinë e artit në jetën njerëzore në përgjithësi, dhe në jetën personale në veçanti, nuk e inkuadroi asnjëherë veten në asnjë rrymë apo tendencë letrare. Ai ishte unik, ashtu si çdo letërsi është unike, e bukur, edhe pse shpesh fsheh një tragjedi njerëzore... Nje nga poezitë më të preferuara "Itaka" ka pasur perherë një domethënie të madhe pasi përshkruan udhëtimin e shpirtit drejt çerdhes që quajme "shtëpi". Një udhëtim që tregon që kuçedrat egzistojne ne brendesite tona si individë, ashtu si dhe Itaka. Itaka, ajo mburojë shpirtërore, është shkaku i atij udhëtimi, por nëse nuk marrim kohën e duhur për të njohur bukuritë e saja, bashkë me njerezit dhe veçurite e tyre që e karakterizojne, do jene shqisat tona ne gjendje ta njohin ate çerdhe kur ta kemi arritur? Sido qe te jete, kudo qe te te çojte ai udhëtim, "mbaj perhere ne mendje Itaken".



KOSTANDINOS KAVAFIS

DUKE PRITUR BARBARËT

Ç'presim këtu te sheshi i tregut?
Barbarët, thonë që vinë sot.
Po ata të Senatit, pse nuk tunden?
Përse s'ulen, të bëjnë ndonjë ligj?
Sepse sot po vinë barbarët.
E ç'ligj mund të bëjnë senatorët?
Ligjet i bëjnë barbarët kur të vinë.
Përse kaq herët perandori ynë
ka dalë hijerëndë te porta e qytetit
me gjithë kurorë mbi krye?
Sepse barbarët vinë sot.
Perandori pret t'i japë mirëseardhjen
të parit të tyre. Ka bërë gati
dhe një pergamenë për të,
me emra dhe shumë tituj të lartë.
Përse dy konsujt dhe pretorët
dolën sot me pelerina të kuqe qëndisura?
Ç'ne ata bylyzqë me gurë të çmuar,
ato unaza me smeraldë të ndritshëm?
Ç'i kishin ata bastunë të gdhendur
me ar dhe argjend stolisur?
Sepse vinë barbarët sot,
këto sende atyre u bëjnë përshtypje.
Përse gojëtarët tanë të vyer
nuk vinë të mbajnë fjalime?
Sepse sot vinë barbarët;
ata llafet e tepërta nuk i honepsin.
Përse kjo rrëmujë papritur?
(Të mërzhitur duken njerëzia.)
Përse kaq shpejt u zbrazën rrugë dhe sheshe
dhe të gjithë nëpër shtëpi po kthehen të sëkëlldisur?
Sepse barbarët nuk erdhën.
Ca, që sapo erdhën nga kufiri
thanë se barbarët s'po duken.____
Po tani, çdo të ngjasë me ne, pa barbarët?
Gjithsesi, ata qenë një farë zgjidhje.

HARRESË

Mbyllur brenda në lulëtari,
nën xhamari, lulet nuk dinë,
si është shkëlqimi diellor,
as si fryjnë flladet kur shkojnë freskitë.

MURET

Pa mendim, pa dhimbje, pa turp,
rreth meje ndërtuan mure të mëdhenj, të lartë.
Dhe rri tani e rrobëtohem këtu,
nuk mendoj tjetër, trurin ma bluan imi fat.
Meqë jashtë kisha për të bërë shumë gjëra,
kur ndërtuan muret, si nuk i pashë.
Po nuk dëgjova as zhurmë ndërtuesish, as zëra,
pa u menduar nga bota më lanë jashtë.

MONOTONI

Një ditë tjetër monotone përsëri
monotone, e njëjlojtë vjen. Janë për t'u bërë
të njëjtat gjëra, do të ribëhen sërish
çaste të ngjashme na gjejnë e na lënë.
Muaj kalon dhe sjell muaj tjetër.
Ato që vijnë askush me mend nuk mund t'i marrë,
janë ato të djeshmet ato të mërzhitshmet.
Dhe katandiset e nesërmja që e nesërme të mos ngjajë.
Ionike
Përse vall i thyem, shtatorët e tyre,
nga tempujt e tyre, përse i dëbuam
gjithsesi, prej kësaj, nuk vdesin perënditë.
O tokë lonase, mbenë me ty dashuruar.
Si gdhahet mbi ty, i gushtit mëngjes
fuqi jetësore, po e trand ajrinë
pastaj i etertë, një vizion i pubertë
i pa eksploruar, në ecje të shpejtë,
kodrinave të tu endet, tej!

TË KRYEME

Përbrenda frikës edhe dyshimesh
me mendje trandur, sy llahtaruar
shkrimë, projektojmë, se si do të bëjmë
të mund të shmangim, çfarë është e sigurt
rrezikun, që hepon tmerruar.
Gabohe mi, gjithsesi, kjo nuk është udha
Të gjithë mesazhet, ishin hile
(a, s'i dëgjuam... a, mirë s'i ndjemë)
Tjetër shkatërrim, që s'e gjykuam,
befas, papritur, do bjerë mbi ne
pa përgatitur—ku të gjesh kohë—u sakatuam!

Zija ÇELA



shkonte, ndërsa mua më duhej të pranoja se isha treguar i ngathët. Por as nëpër mend...

Kështu si flet ti, e ndërpreva, duket sikur e ke hetuar ngjarjen. Vërtet ke bërë hetime?

Bashkudhëtari im ktheu kokën nga dritarja e vagonit. E kishte kthyer disa herë dhe unë po krijoja përshtypjen se i vlerësonte ndijimet pamore. Në një pellg ndanë trasesë lahej një tufë rosash dhe ai kapsalliti sytë. Pastaj pellgu mbaroi, por m'u duk se ai vazhdoi të mendonte për rosat, dhe të mendonte si për ca krijesa që s'dihej kujt i përkisnin më shumë: ujit apo tokës. Kur mbaroi rreshti i plepave, në të majtë u duk toka e rrafshët dhe andej ajri ishte i bollshëm. Ai nuk i kapsalliti më sytë. Ndoshta ia kishte platitur vështrimin fusha, me atë thellësinë ndjellëse dhe intime të qetësisë së saj. Edhe vetë sikur u bë më intim, duke m'u drejtuar me "ti".

Pra, vazhdoi, përmende hetimet, kështu? E dija se do të ma bëje këtë pyetje. Kushdo në vend tënd do ta bënte. Kur ndodh një vrasje, jemi mësuar të kërkojmë fajin e individit. Prandaj dhe thirret hetuesi, që të vërë gishtin. Por unë jam Baltazari, babai im binte kushëri i largët, nga e ëma, me doktor Zhavellon. Mos më

merr për tjetër njeri? Papritur, si ta kishte ngacmuar një shkak më tepër, u zgjat dhe mori çantën e dorës në skarën sipër ndenjësve.

Hetime u bënë, por i bëri tjetërkush. Unë u thirra vetëm për të dëshmuar, kaq. Dosja u mbyll, s'kishte kush të dilte para gjykatësit për t'u gjykuar. Për atë që kishte ndodhur, na duhej që secili të gjykonte vetveten. I gjithë Bardhgolemi. Sidomos unë... E di ti ç'do të thotë të jesh zgjedhur shoqëruer i dhëndrit?! Nuk e di. Se mos vetëm ti nuk e di.

Baltazari bëri të hapte çantën, po gishtërinjtë iu mpinë në tokëzat e kapakut. Gjatë kësaj vonese të pavullnetshme, kapsalliti sytë përsëri, sikur ajo që po matej të thoshte ishte e pamundur të rrokej me pak fjalë, pasi i përkiste vërtet edhe tokës, edhe ujit, edhe ajrit.

Sa gjëra nuk dihen në këtë botë, foli më në fund. Megjithëse, të thua sh të drejtën, bota nuk është dhe aq e madhe. Njeriu është i madh. Dhe njeriu është i mash, se mes njerëzish të ngjashëm është i pangjashëm. Ajo që ndodh me të dhe që duket e ngjashme me çfarë i ka ndodhur një tjetri, është vetëm një shajni. Të lutem, mundohu të vësh në hesap

qoftë edhe këtë hollësi. Ai Kristo Kubati që u vra, kishte një zakon të habitshëm: një Zot e di pse e kruante fytyrën gjithnjë dhe pse lëkura i rripej përreth mollëzave. Ti ke dëgjuar për gjarprin që e lëshon lëkurën e vjetër në pranverë: po edhe ai ashtu dukej, sikur kishte disa shtresa dhe gjithnjë ngutej për t'i nxjerrë fytyrës lëkurën që i duhej. Atë natë që vdiq, ka qenë më ngacmues se kurrë.

Tashmë Baltazari e kishte hapur çantën. Lëvizja e dorës së tij po bëhej e vrullshme dhe, ndërsa prisja të nxirrte ndonjë atlas të botës ose ndonjë fotografi të Kristos, ai nxori një libër.

E ke lexuar besoj, tha pa e vënë në dyshim. Unë pardje e bleva në Vlorë. Mbarova shërbimin, u mbylla në hotel dhe e lexova gjithë natën. E nisa nga fundi, sepse në fund të pasqyrës së lëndës gjeta titullin: "Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar". Po, lexoja e mendoja me bindje se bota është me të vërtetë e vogël dhe njeriu është me të vërtetë i madh. Ashtu si natyra, njeriu nuk përsërit. E çuditshme, apo jo?

Nuk e mora për pyetje që kërkonte përgjigje, por edhe diç më pengoi që ta merrja si të tillë. Dhe ai, duke u përgjigjur po vetë, e mbledhi tërë lëmshin në një pikë:

Është e çuditshme, sepse ajo vdekje për të cilën bën fjalë ky libër, u paralajmërua shumë herë, madje edhe pak çaste para se të bëhej vrasja, e megjithatë krimi u krye. Santiago Nasari u vra, binjakët Vikario pranuan se e kishin vrarë me paramendim, dolën në gjyq dhe u dënuan aq sa u dënuan. Të më falësh që po hyj në atë zonë rreptësie, ku i lejohet të hyjë vetëm shkrimtarit. Por unë kam bindjen time. Po të mund të ndodhte edhe një herë ajo që ndodhi, Santiago Nasari nuk do të vritej. Ai nuk do të vritej, sepse Anhela Vikario nuk do të mund të gënente për herë të dytë. Nuk do të vritej, sepse nga të gjithë ata njerëz që e dinin se krimi do të kryhej, do të dilte të paktën njëri që do ta lajmëronte në kohë Santiago Nasarin, duke provuar kështu se fati vetëm një herë mund të na bëjë të padukshëm. Më në fund, ai nuk do të vritej, sepse vetë vëllezërit Vikario do të pendoheshin, ata nuk do të ishin në gjendje ta ribënin vrasjen.

Në rastin e Kristos dhe Çondës asnjë paralajmërim nuk pati dhe askush nuk mund të thotë se ditën e dasmës kapi ndonjë shenjë. Denoncimi përpara se të ndodhnin vrasjet, ishte i pamundur. Megjithatë, njëqind herë po të mund të rindodhte ngjarja, njëqind herë do të përfundonte njëlloj. Finalja po, për ndonjë peng të hershëm finalja ishte paracaktuar, sepse e tillë është raca dhe kodi ynë i sjelljes. Por hajde kapi ato paralajmërimet që jepen, për shembull, vite më parë... A të mbushet mendja tani se ajo që ka ndodhur ia vlen të ta tregoj?

Kishim për të udhëtuar nja gjashtë orë të mira bashkë dhe ajo që vura më tepër në hesap ishte koha. Po ta ndërprisja me gjithfarë përgjigjesh e gjithfarë pyetjesh që më ngjallte kërshtëria e parë, koha s'do të mjaftonte. Më erdhi në ndihmë edhe instikti i Shternit: njerëzit duhen lënë të tregojnë ashtu si dinë. (Nga "Gjaku i dallëndyshes", botimi i parë 1990)

CHAPLIN: Lakmia ka pushtuar shpirtrat e njerëzve...

Në fjalimin e tij të fundit në filmin "Diktatori i madh", Charlie Chaplin dha porosi, të cilat mbeten aktuale edhe në ditët e sotme. Më poshtë do të keni mundësi të lexoni një pjesë të fjalimit të tij që do t'ju përлотë.



"Më falni, por unë nuk dua të jem një perandor. Kjo gjë nuk i përket interesave të mia. Unë nuk dua të urdhëroj dhe as të mposht të tjerët. Unë dua t'i ndihmoj të tjerët – të gjithë nëse është e mundur – hebrenjtë, xhentilët, personat e bardhë, personat me ngjyrë. Ne të gjithë duam ta ndihmojmë njëri-tjetrin. Kështu funksionojnë qeniet njerëzore. Ne duam të jetojmë me lumturinë e njëri-tjetrit, dhe jo me mjerimin e njëri-tjetrit. Rruga e duhur e jetës mund të jetë

e lirë dhe e bukur, por ne kemi humbur rrugën.

Lakmia ka pushtuar shpirtrat e njerëzve, ka rrethuar botën me urret dhe na ka shtyrë ne në mjerim dhe gjakderdhje. Ne kemi ecur

drejt zhvillimit, por duke kycur veten tonë brenda. Makinat që na japin bollëk, na kanë lënë në mjerim. Njohuritë tona na kanë bërë cinikë. Zgjuarsia jonë na ka bërë të ashpër dhe të pasjellshëm. Ne

mendojmë shumë dhe ndiejmë pak. Më shumë se për makineri, ne kemi nevojë për humanizëm. Më shumë se për zgjuarsia, ne kemi nevojë për mirësi dhe xhentilesë. Pa këto cilësi, jeta do të jetë e dhunsh-

me dhe ne të gjithë do të jemi të humbur...

Aeroplani dhe radioja na kanë afruar me njëri-tjetrin. Natyra e vërtetë e këtyre shpikjeve thërret për mirësinë tek ne – thërret për vëllazëri – thërret për bashkim. Edhe tani zëri im po arrin në veshët e miliona njerëzve të dëshpëruar dhe atyre që mund të më dëgjojnë, u thëm – Mos u dëshpëroni. Mjerimi që gjendet mes nesh, është pasojë e lakmisë, e zemërimit të njerëzve që i tremben progresit të humanizmit. Urrejtja e njerëzve do të kalojë, diktatorët do të vdesin dhe fuqia që ata morën prej njerëzve, do t'u kthehet njerëzve.

Ju keni fuqinë të krijoni lumturinë. Ju, njerëz, keni fuqinë ta bëni këtë jetë të lirë dhe të bukur, ta bëni këtë jetë një aventurë të mrekullueshme

PAJTIM APO NJOHJE MES KOSOVËS DHE SERBISË?

Analistët thonë se si Kosova po ashtu edhe Serbia, janë të vetëdijshme se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve do të duhet të përmbyllet me një marrëveshje ligjërish të obligueshme



Pajtimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është një nga frazat shpesh të përdorura nga liderë e përfaqësues politikë. Por, për analistët politikë, pajtimi nënkuptohet më shumë si një çështje teknike, duke potencuar se relaksimi i raporteve dhe njohjet reciproke mes të dyja shteteve, do ishin fillimisht forma më e mirë dhe më normale që një ditë do të rezultonte edhe më atë që po cilësohet si pajtim. Politologu Ramush Tahiri, thotë për Radion Evropa e Lirë, se pajtimi mes Kosovës dhe Serbisë, mund të shihet si një çështje teknike, por edhe çështje e ngritur emocionale.

Sipas tij, zhvillimi i marrëdhënieve normale nënkupton njohjen reciproke dhe nënkupton pranimin, i cili në fakt do të nënkuptonte një lloj pajtimi. "Por nëse mendohet pajtimi sepse dikush e pranon fajin për gjerat që kanë ndodhur në Kosovë dhe një çështje morale e cila ngritet mbi politike atëherë është çështje tjetër. Përndryshe në kategorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare sot është vendosja e marrëdhënieve diplomatike njohja reciproke dhe bashkëpunimi sipas konventave ndërkombëtare

dhe sipas marrëveshjeve bilaterale", tha Tahiri. Luftërat dhe konfliktet, kanë si pasojë viktima në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, çka ndodhi edhe me rastin e Kosovës dhe Serbisë.

Ramush Tahiri thotë se çfarëdo pajtimi, nuk do të duhej të nënkuptonte edhe amnistinë për ata që kanë kryer krime luftime. Ndjekja e këtyre personave, vijon ai, mund të bëhet edhe pas fazës së njohjes eventuale reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Unë mendoj se si kategori nuk ka nevojë për pajtim ndërmjet popullit serb dhe popullit shqiptar sepse nuk janë të armiqësuar dhe nuk janë të nivelit të barabartë sa i përket asaj që ka ndodhur në Kosovë. Ndërsa Serbia dhe Kosova duhet t'i zhvillojnë marrëdhëniet normale dhe të respektojnë kushtetutat dhe ligjet e veta. Kurse krimet që kanë ndodhur, kompensimet për krime do të thotë dënimet duhet të kryhen në bazë të ligjeve në fuqi dhe në bazë të konventave dhe standardeve ndërkombëtare", tha Tahiri.

Ndërkohë, edhe Jeta Krasniqi, analiste nga Instituti Demokratik i

Kosovës, tha për Radion Evropa e Lirë, se pajtimi i plotë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vjen vetëm në momentin kur dy shtetet do ta njohin njëra tjetrën. Por, ajo thotë po ashtu se pajtimi i vërtetë mund të ndodh kur Serbia do të kërkojë falje për krimet e luftës. "Pajtimi i plotë vjen kur Serbia do të kujdeset për sanimin e dëmeve të luftës dhe kur do të zbardhet fati i 1500 të pagjeturve dhe do të vihet drejtësi për 20 mijë gratë e dhunuara. Pajtimi do të ndodhte kur marrëveshjet e Brukselit do të zbatoheshin dhe kur shkëmbimi ekonomik, politik e akademik do të ishte në nivel të shtuar. Kësi soji edhe marrëdhëniet

ndëretnike në Kosovë do të ishin më mirë. Ky do të ishte bazamenti i duhur për pajtim të plotë ndërmjet palëve", u shpreh Krasniqi.

Ndërkaq, politologu Tahiri thekson se për të pasur një rezultat në procesin e dialogut, faktori ndërkombëtar duhet t'i bej presion shteti serb, në të kundërtën arritja e një pajtimi mund të zgjas shumë. "Nëse behet një presion në Serbi e që në fakt nuk po bëhet edhe nëse Kosova insiston në sovranitetin e saj dhe në reciprocitetin kjo është e mundshme sepse alternativ tjetër nuk ka. Por, nëse Serbisë i lihet një status special mbi çështjen e Kosovës, ndërsa Kosova shkon jo si

subjekt i barabart në bisedime ose në takime ndërkombëtare, atëherë kjo do të zgjasë me vite të tëra e ndoshta edhe me 10 vjet", tha Tahiri.

Kurse, Jeta Krasniqi vlerëson se është kohë e fundit për të dyja shtetet që të arrijnë marrëveshje dhe që përmbyllin të gjitha çështjet e hapura në procesin e dialogut. "Them se është treni i fundit për të dyja shtetet që të dakordohen dhe të arrijnë një marrëveshje më anë të secilës behet njohja formale reciproke dhe vihen bazamentet për të ndërtaur pastaj edhe paqen. Patjetër dëshpërlimi, kërkimfalja, krimet e luftës, suksesioni duhet të jenë pjesë e marrëveshjes dhe më pas Kosova dhe Serbia angazhohen për ndërtimin e një lloji tjetër të marrëdhënieve", deklaroi Krasniqi. Arritja e një marrëveshje juridikisht obliguese ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përveç zgjidhjes së problemeve ndërmjet dy vendeve, do ta lehtësonte edhe integrimin e tyre në Bashkimin Evropian.

Analistët thonë se si Kosova po ashtu edhe Serbia, janë të vetëdijshme se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve do të duhet të përmbyllet me një marrëveshje ligjërish të obligueshme. (REL)

SERBISË I OFROJMË PAJTIMIN NË KËMBIM TË NJOHJES

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka deklaruar se Kosova do të pranojë pajtimin me Serbinë, në këmbim të njohjes nga kjo e fundit. Gjithsesi, sipas tij, kjo nuk do të thotë se do harrohen krimet e bëra. "Ne i ofrojmë Serbisë pajtimin, nëse na njeh zyrtarisht si shtet. Pajtimi nuk është pak, pasi do të thotë të shkelësh mbi të zhdururit, të dhunuarit, të vrarët dhe plaçkitjen e rrënimin që na është bërë ndër vite. Ndaj mendoj se duke i ofruar pajtimin, i kemi ofruar shumë Serbisë, por gjithsesi pajtim nuk do të thotë të

harrojmë", deklaroi Haradinaj. Kryeministri kosovar tha se ky është viti kur Kosova duhet anëtarësohet në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale, INTERPOL, ndërsa u shpreh i bindur se do të ketë vende që do të kërkojnë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. "Sivjet është koha që Kosova të anëtarësohet në INTERPOL dhe unë besoj se ka vende që do ta kërkojnë dhe mbështesin anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë", tha kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

Pedro Sanchez e ka "prekur" vetë realitetin e Kosovës

Pas rrëzimit nga pushteti të kryeministrit spanjoll Mariano Rajoy, me miratimin e mocionit të mosbesimit gjatë paradites së kësaj të premtje, dhe me ardhjen e kryeopozitarit Pedro Sanchez në postin e kryeministrit, Kosova mund të ketë një "aleat" më shumë në arenën ndërkombëtare. Spanja është një prej 5 shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, ndërsa Rajoy refuzoi gjithashtu të ulej në të njëjtën tryezë me Thaçin gjatë samitit mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur gjatë majit në Sofje. Por, tashmë në karrigen e kryeministrit të Spanjës është ulur kryesocialisti Sanchez, një koleg i së njëjtës parti me Javier Solanën, ish-Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s gjatë ndërhyrjes së aleancës në Kosovë në vitin 1999 për të larguar serbët, e më vonë edhe përfaqësues i lartë i BE-së. Sipas disa medieve spanjolle, por edhe biografisë së tij online, Pedro Sanchez raportohet të ketë punuar në Kosovë, si pjesë e misionit të OKB-së, UNMIK.



Shqiptarët 1 mijë padi për kompensim të dëmeve të luftës, serbët 100 mijë

Jahir Bejta, kryetar i organizatës për dëmet e luftës "Ngritja e Zërit", thotë se janë hartuar rreth 1 mijë padi të cilat janë refuzuar nga gjykatat, por që pas ankesave 400 sosh ndodhen për shqyrtim në Gjykatën e Apelit, 100 në Gjykatën Supreme dhe 50 në Gjykatën Kushtetuese. Vetëm serbët e Leqinës së Skenderajt kërkojnë 500 mijë euro kompensim për dëme të luftës, shkruan gazeta "Zëri". Rreth 1 mijë kërkesëpadi janë hartuar nga organizata për dëmet e luftës "Ngritja e Zërit", selia e së cilës është në Skenderaj dhe janë dorëzuar nëpër gjykata, pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës, por të gjitha ato janë refuzuar nga gjykatat me arsyetimin se nuk mund të paditet një shtet tjetër. Jahir Bejta, kryetar i OJQ-së "Ngritja e Zërit", i tha "Zërit" se shpresën te paditësit e ka kthyer kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka premtuar se do t'i përkrahë të gjitha kërkesat e qytetarëve



sa i përket kompensimit të dëmeve të luftës. Bejta tha se kishte kërkuar një takim me kryeministrin e vendit, por që ky takim nuk ishte realizuar, pasi që siç tha Bejta, kryeministri nuk është njoftuar për kërkesën. "Kryeministri nuk e ka ditur se ekziston një organizatë që merret me dëmet e luftës. Me shkresë i kemi kërkuar atij që të takohemi dhe ta diskutojmë çështjen e dëmeve të luftës. 'Ngritja e Zërit' është shoqatë profesionale për dëme

të luftës. Në saje të kauzës kombëtare veprimtarinë profesionale të cilësisë së avokatit e kryen tërësisht falas. Mospërkrahja financiare nga niveli qendror dhe ai lokal ka ndikuar që të ketë ngecje, kurse palët (viktima) rrugëtojnë edhe me nga 100 kilometra në një drejtim për ta hartuar padinë për kompensim dëmi në Skenderaj", ka sqaruar Bejta. Ai ka thënë se refuzimi i kërkesëpadive nga Gjykata është për çdo gjykim

A DO TË SHPËRBLEHET GJERMANIA PËR REFUGJATËT?

Gjermania është përpjekur herë pas here që të arrijë një ndarje të drejtë të refugjatëve në shtetet anëtare të BE. Tani të paktën mund të vijë më shumë para për ato vende, të cilat pranojnë refugjatë në vendin e tyre

"Epo, kaq larg ende nuk kemi vajtur", me këto fjalë u përpoq ta zbusë zëdhënësi i Kancelares Angela Merkel raportin e gazetës "Frankfurter Allgemeine Zeitung". Thelbi i informacionit të gazetës: Gjermania do të marrë për periudhën e ardhshme buxhetore të BE, prej viteve 2021 deri 2027 rreth 4,5 miliardë euro si kompensim për barrën e refugjatëve. Edhe shtete të tjera, të cilat kanë pranuar një numër veçanërisht të lartë refugjatësh, si Italia p.sh., Greqia ose Suedia, sipas raportit do të marrin më shumë para. Kjo do të arrihet duke i ndarë fondet strukturore, të cilat janë parashikuar për rajone veçanërisht në nevojë, tani edhe sipas kritereve të barrës për imigrimin.



Deri tani, migrimi nuk ka luajtur rol në ndarjen e parave. Që Gjermania ka ngulur këmbë këtu për disa ndryshime, këtë e pranon Seiberti: "Gjermania nguli këmbë në negociata edhe që të merret parasysh angazhimi i rajoneve dhe komunave të shteteve anëtare në pranimin e refugjatëve dhe migrantëve". Megjithatë, ideja që u bë publike tani nga qarqet e Komisionit të BE duhet të vendoset nga shtetet anëtare dhe nga Parlamenti Evropian. Dhe se si do të pritet kjo ide që pikërisht Gjermania të marrë më shumë para nga

buxhetet e BE, për shembull nga shtetet evropianolindore, skeptike ndaj Evropës, këtë nuk e di askush. Kancelarja gjermane nuk pati sukses as në shkurt në Bruksel me idenë për t'u përcjellë shteteve të caktuara të BE më pak para nga fondet strukturore, për shkak të qëndrimit të tyre pak bashkëpunues në politikën ndaj refugjatëve. Supozimin e përgjithshëm se bëhej fjalë për një aksion dënimi të Gjermanisë së fuqishme, Seiberti e hedh poshtë prerë:

"Qeveria gjermane nuk synoi në asnjë fazë ndëshkimin. Ndë-

shkimi nuk është mjet veçanërisht efikas, kur dëshiron që të krijosh në Evropë bashkëpunim midis 27 shteteve". Por është fakt që prej kohësh BE nuk po arrin të bëjë një ndarje të drejtë të numrit të madh të refugjatëve midis shteteve anëtare. Midis viteve 2013 dhe 2017, sipas të dhënave zyrtare në BE erdhën më shumë se 1,7 milionë vetë, gjysma e tyre erdhën në Gjermani. Në fakt, Gjermania nuk është vend klasik që merr para nga fondet strukturore të Bashkimit Evropian: paratë që merr Gjermania nga këto fonde janë të pakta. Por kur tani do të luajë rol edhe politika ndaj refugjatëve, kjo e ndryshon pak punën. Sipas vlerësimeve të ekspertëve, Gjermania mund të llogarisë të marrë midis viteve 2021 dhe 2027 diçka më shumë se 15 miliardë euro. Gati një e treta e këtyre parave do të ishin për pranimin e refugjatëve.

Po nëse Gjermania do të marrë vërtet para nga BE, kjo është një pjesë tepër e vogël e të gjitha fondeve strukturore. Sa për krahasim: midis viteve 2014 dhe 2018 BE ka ndarë 280 miliardë euro nga fondet strukturore dhe të investimeve, në vitet e ardhshme është në dispozicion një shumë edhe më e madhe.



Salvini emigrantëve: Bëni gati valixhet

Siç premtoi gjatë fushatës, Matteo Salvini e ka nisur me betejën kundër emigrantëve ilegalë, mandatin e tij si zv/kryeministër dhe ministër i Brendshëm. Vizitën e parë pas betimit e bëri në Sicili, në ishullin që sipas tij është shndërruar në ishullin kampin e refugjatëve për Europën. Në takimin me drejtuesit lokalë, Salvini tha se situata do të ndryshojë. Më herët duke folur para qindra mbështetësve në Viçenca, Salvini u bëri thirrje emigrantëve të paligjshëm të bëjnë gati valixhet. Ministri i ri i Brendshëm tha se italianët nuk duhet të shpenzojnë më kohë e para për emigrantët. Vendeve të tyre të origjinës, kryesisht në Afrikën Veriore u bëri thirrje të ndalojnë emigrantët e paligjshëm që nisen nga brigjet e tyre. Siç është shprehur më herët Salvini, nga Italia do të dëbohen mbi 500 mijë emigrantë ilegalë, por kjo do të bëhet gradualisht dhe jo në mënyrë kaotike.

Edhe Assadi dëshiron ta takojë Kim Jong Un-in

Presidenti sirian Bashar al-Assad ka në program një samit në Phenian me liderin e Koresë së Veriut, Kim Jong-un. Lajmi është bërë i ditur nga agjencia shtetërore KCNA

që citon fjalët e Assad: "Do të vizitoj Korenë e Veriut dhe do të takohem me shkëlqesinë e tij Kim Jong-un". Samiti i mundshëm do të jetë i pari i diktatorit me një kryetar shteti në

Phenian. Sipas disa burimeve të Inteligjencës amerikane dhe koreano-jugore, marrëdhëniet mes dy vendeve përfshijnë edhe shitjen e armëve. Kohë më parë shumë ra-

portime kanë treguar se Koreja e Veriut ka ndihmuar Sirinë në ndërtimin e armëve kimike. Nga ana tjetër, regjimi i Assad ka ndihmuar në mënyrë financiare Phenianin.

Slovenia si Italia, një komedian ka në dorë fatet e qeverisë

Partia Demokratike Sllovene (SDS), një parti qartësisht antiemigracion, ka rezultuar më e madhja nga zgjedhjet e përgjithshme në Slloveni



Sipas zyrtarëve, me thuajse të gjitha votat të numëruara, SDS-ja ka fituar 25% të mbështetjes, ndërsa si parti e dytë me 12.7% të votave ka rezultuar "Lista e Marjan Sareçit", një parti politike e themeluar nga Marjan Sareç, një ish-gazetar, aktor dhe komedian.

Analistët politikë thonë se SDS-ja tashmë gjendet përballë vështirësive për të formuar një koalicion qeveritar.

Slovenia u detyrua të shkonte në zgjedhje që prej muajit mars, pasi kryeministri i qendrës së

majtë, Miro Cerar dha dorëheqjen mes greva, mosmarrëveshjeve brenda koalicionit dhe një vendimi të dëmshëm të Gjykatës Supreme. SDS-ja antiemigracion udhëhiqet nga ish-kryeministri Janez Jansa, i cili ka qenë një mbështetës i zë-

shën i kryeministrit nationalist hungarez, Viktor Orban. Të dielën në mbrëmje, teksa rezultatet bëheshin gjithnjë e më të qarta, ai tha se "dyert e partisë së tij janë të hapura për bisedime dhe koalicionë" ndaj të gjitha partive të tjera. "Jemi gati të nisim bisedime serioze bazuar mbi programin, mbi të cilin kemi punuar aq fort", tha ai.

"SDS"-ja do të ketë 25 vende në Asambleen Kombëtare 90-vendesh. E vetmja parti që ka deklaruar deri më tani se do të punojë me SDS-në është ajo e qendrës së djathtë, "Nova Slovenija", e cila fitoi 7.1% të votave dhe rrjedhimisht 7 vende në Parlament. Kjo mund ta bëjë LMS-në, një parti antiestablishmet që do të ketë 13 vende, të ketë një rol tejet të rëndësishëm në negociata.

SDS-ja është shprehur se paratë e shpenzuara ndaj emigrantëve do të mund të përdoren më mirë për forcat e sigurisë së vendit. Jansha thotë gjithashtu se dëshiron që Sllovenia "të bëhet një vend që do të vendosë përpara gjithçkaje mirëqenien dhe sigurinë e sllovenëve".

Lista e Marjan Sareçit udhëhiqet pikërisht nga komediani i kthyer në politikan satirist, Marjan Sareç, i cili e ka shpallur qysh në fillimet e tij veten si një politikan "antiestablishment". Ai e përshkroi rezultatin e së dielës si "një sukses tejet të madh" të arritur në zgjedhjet e para për partinë e tij. Rreth 25 parti ishin në garë për zgjedhjet e përgjithshme, në vendin me 1.7 milion banorë me të drejtë vote.

INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL PËR FËMIJË – ÇERDHJA PËR FËMIJË
“DIMÇE MIRÇEV” – VELES PUBLIKON

SHPALLJE
PËR PRANIM TË PUNËTORËVE PËR KOHË TË PACAKTUAR

1. IPKÇF “Dimçe Mirçev” – Veles ka nevojë për punësim për orar të plotë të punës për kohë të pacaktuar me orar të plotë të punës të punëtorëve për objektin në f. Karasllari – Veles edhe atë:

- EDUKATOR PËR FËMIJËT E MOSHËS PREJ 2 – 6 VJEÇARE..... 2 (DY) realizues;
- PËRKËDHELËS..... 2 (DY) realizues;
- MIRËMBAJTËS TË HIGJENËS..... 1 (NJË) realizues;
- ENËLARËSE/SHËRBYESE.....1 (NJË) realizues;

2. Kushtet e nevojshme:

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

Për vendin e punës edukator:

-Profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar të fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar shkalla e VII/1 ose arsim të mbaruar përkatës të lartë për edukator dhe licencë valide për edukator;
Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 07 -13,00, Neto pagesa fillestare: Me arsim sipëror...19.580,00; me arsim të lartë...18.514,00 denarë.

Për vendin e punës përkëdhelëse:

-arsim të mesëm të mbaruar katërveçar dhe licencë valide për përkëdhelës;
Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 09,00 -17,00, Neto pagesa fillestare...14.920,00 denarë.

Për vendin e punës Mirëmbajtës të higjienës:

-arsim fillor të mbaruar ose arsim të mesëm;
Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 05,30 -13,30 ose prej ora 09,30 -17,30, Neto pagesa fillestare...12.005,00 denarë.

Për vendin e punës Enëlarëse/shërbyese:

-arsim fillor/të mesëm të mbaruar (gjimnaz, hoteleri).
Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 07,00 deri në ora 15,00, Neto pagesa fillestare...12.005,00 denarë.

Krahas kushteve të lartpërmendura, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim: Shtetas i RM, i shëndosh fizikisht dhe psikikisht, njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje-ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepr penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepr penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe të përmbushë kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.

3. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

4. Së bashku me fletëparaqitjen, të parashtrihen: diploma për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, licencë përkatëse valide në origjinal, certifikatë të shtetësisë, dëshmi për masë të pashqiptuar për siguri nga Regjistri qendror dhe dëshmi se nuk është i dënuar nga Gjykata themelore jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

5. Dokumentacionin i kompletuar me fletëparaqitjen të parashtrihen në adresën: **IPKÇF “DIMÇE MIRÇEV” rr. Todor Hristov – Ificerçeto” nr. 1 në Veles, nr. i telefonit 043/231-226, personi për kontakt: Aco Petrushevski.**

UD DREJTOR
Branisllava Naceva

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09,130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15 dhe 72/15), Pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 18-2383/2 të datës 22.02.2018; dhe nr. 18-2384/2 të datës 22.02.2018 dhe nenit 31 të Statutit të IPKÇF “SNEZHANA” Drejtori i Institucionit publik publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar të

1. Edukator – numër i realizuesve 2 (dy)
2. Përkëdhelës – numër të realizuesve 1 (një)
3. Gjellëbërës kryesor – numër të realizuesve 1 (një)

Kushtet e përgjithshme që vlejné për të gjithë kandidatët:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për vepr penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepr penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;
- Të plotësojë kushte të tjera të caktuara në aktin për organizim të punës dhe sistematizim të vendeve të punës.

Përveç kushteve të përgjithshme që vlejné për të gjithë kandidatët, për secilin vend pune duhet të përmbushen edhe kushtet e posaçme edhe atë:

1. Për vendin e punës edukator për fëmijë prej 2-6 vjet
 - Fakulteti filozofik – Instituti për pedagogji ose Fakulteti pedagogjik – grupi pedagogjia parashkollore PSP VI-A me 240 kredi
 - Licencë valide për edukator
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari i punës së edukatorit gjatë ditës zgjatë prej ora 07:00 deri në ora 15:00 (30 orë të orarit të punës t’i kalojë me fëmijë dhe 10 orët tjera të orarit të punës për aktivitetet tjera programore), gjegjësisht 8 orë në ditë ose 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte

Neto pagesa themelore për vendin e punës: 19.581,00 denarë

2. Për vendin e punës përkëdhelës
 - Arsim të mesëm (katër vjeçar) të mbaruar
 - licencë të vlefshme për përkëdhelës
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari i punës së përkëdhelësit gjatë ditës zgjatë prej ora 08:00 deri në ora 16:00 (35 orë të orarit të punës t’i kalojë me fëmijë dhe 5 orët tjera të orarit të punës për aktivitetet tjera programore), gjegjësisht 8 orë në ditë ose 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte

Neto pagesa themelore për vendin e punës: 14.779,00 denarë

3. Për vendin e punës Gjellëbërës kryesor
 - Arsim të mesëm hotelierisë
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari i punës prej ora 06:00 deri në ora 14:00

Neto pagesa themelore për vendin e punës: 13.719,00 denarë

1. Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Lutje
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (kopje)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë për siguri ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Certifikatë të mjekut
- Vërtetim se njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
- Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për vepr penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepr penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet deri në IPKÇF “Snezhana” Çair – Shkup, rr. “Xhon Kenedi” nr. 1 përmes postës ose në Institucion.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet të plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e caktuar, si dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të përmbajnë dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit dhe nuk do të merren parasysh.

Shpallës është IPKÇF “SNEZHANA” Komuna e Çairit me seli në rrugën “Xhon Kenedi” nr. 1, personi për kontakt: Miradije Bushi – Mamut, numri i telefonit 02 2622-454

IPKÇF “SNEZHANA”

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 aalineja 7 e Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/09,36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14 ,180/14, 33/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 të Statutit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit dhe Vendimit të Këshillit drejtues nr. 02-1221/3 të datës 01.06.2018, Këshilli drejtues pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit

1. Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin kushtet në vijim të përcaktuara me ligj:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
 - Të kenë të mbaruar arsim sipëror të shkallës së VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, të profileve arsimore në vijim: punëtor i diplomuar social, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog,
 - Të kenë minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit,
 - Të parashtrijë program të përpiluar për udhëheqje me institucionin.

Neto pagesa është **28.956,00** denarë.

2. Kandidatët duhet të parashtrijnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - Certifikatë/vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
 - Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës – certifikatë ose diplomë;
 - Dëshmi për përvojën e punës pas diplomimit;
 - Certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet dhe
 - Program për udhëheqje me institucionin

3. Dokumentet parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

4. Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

5. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtriuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

6. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në arkivin e IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit ose përmes postës në adresën në vijim, rr. “Nikolla Vapcarov” nr. 11-Shkup (me shenjë shpallje publike për zgjedhje të drejtorit).

Vërejtje: Kandidati për drejtor i cili do të zgjidhet për drejtor deri më 01 shtator 2018 obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

Kandidati është e nevojshme të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS – së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English:Legal)-së paku niveli B2,
- FCE Cambridge English:First)-të dhënë,
- BULATS së paku 60 pikë ose
- APTIS – së paku niveli B2.

Drejtori i cili nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit KËSHILLI DREJTUES



Cross Border Cooperation Programme

Komuna Dibër në kuadër të projektit “Standardet bujqësore dhe certifikatat, ngritja e kapaciteteve për përthithjen e fondeve dhe strategjitë e marketingut për të mbështetur rritjen ekonomike dhe tregtinë” (IPA/2017/390-464) i financuar nga fondet e BE (IPA- Bashkëpunim Ndërkufitare) shpall:

Njoftim Punësimi

Konsulent Individual për hartimin e Planeve të Biznesit për agrobiznese (Referenca: 5.2.14)

Punëdhënësi: Komuna Dibër
Tipi i kontratës: Afatshkurtër (Kontratë Shërbimi)
Data e publikimit: 05.06.2018

Vendndodhja: Dibër, Maqedoni
Kohëzgjatja: E shtrirë në 10 muaj
Afati i aplikimit: 15.06.2018

Përshkrimi i Projektit

‘Standardet bujqësore dhe certifikatat, ngritja e kapaciteteve për përthithjen e fondeve dhe strategjitë e marketingut për të mbështetur rritjen ekonomike dhe tregtinë’ është një projekt dy-vjeçar, i financuar nga BE që mbështet zhvillimin e bujqësisë në rajonet e Peshkopisë dhe Dibërës së Madhe, si një nxitës për rritjen ekonomike ndërkufitare. Projekti i cili është në fazë zbatimi nëpërmjet një bashkëpunimi rajonal me Agjencinë Rajonale të Zhvillimit 2-Tiranë dhe Bashkinë e Dibërës së Madhe si partner, si dhe Creative Business Solution si partner kryesor. Si pjesë të ndërhyrjeve të saj, projekti do të zhvillojë një grup agrobiznesesh në zonën ndërkufitare, të cilat do të fuqizohen nëpërmjet tre komponentëve: (i) Certifikimi i produkteve bujqësore dhe ofrimi i trajnimeve të përshtatura për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e certifikimeve, (ii) Përgatitjen e saktë të paketave të aplikimeve për grantet Evropiane dhe programe të tjera financimi, së bashku me trajnime për ngritjen e kapaciteteve për të rritur absorbimin e fondeve (iii) Shërbimet e Konsulencës së Integruar mbi Strategjitë e Marketingut duke përfshirë markimin, etiketimin dhe marketingun digital.

Përshkrimi i punës

Konsulenti për hartimin e Planeve të Biznesit do të ofrojë asistencë teknike për përftuesit, fermerët, mbarështuesit e blegtorisë dhe agropërpunuesit për të hartuar Plane Biznesi. Konsulenti do të ndihmojë përftuesit në përgatitjen e paketave të aplikimit të granteve, në mënyrë që ata të mund të përfitojnë grante me sukses nga Qeveria e Maqedonisë. Programi IPARD ose donatorë të tjerë potencialë. Ai do të bashkëpunojë ngushtë me Komunën e Dibërës dhe Koordinatorin e Projektit për të ofruar trajnime për ngritjen e kapaciteteve përftuesve në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre për absorbimin e fondeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Konsulentit

- Mbështet përftuesit e projektit për të hartimin e planeve të biznesit sipas nevojave të tyre për investime;
- Bashkëpunon me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm për hartimin e strategjive të marketingut të projektit;
- Harton paketatë aplikimit të granteve në emër të përftuesve në mënyrë që të kenë qasje në mbështetjen financiare të donatorëve të ndryshëm;
- Bashkëpunon ngushtë me Koordinatorin e Projekteve dhe përftuesit e projektorit për zbatimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të përftuesve të projektit;
- Përgatit raporteve monitorimi dhe indikatorësh për Koordinatorin e Projektit sipas nevojës;
- Plotëson në kohë gjithë dokumentacionin e caktuar, raportet dhe detyrat;

Aftësitë e kërkuara dhe kualifikimet

- Diplomë universitare në Studimet Ekonomike Bujqësore ose në fusha të ngjashme; Diploma master ose kualifikimet shtesë janë një avantazh;
- Përvojë e dëshmuar në hartimin e planeve të biznesit dhe strategjive të marketingut;
- Së paku 3 vjet përvojë në planifikimin e biznesit dhe përpunimin e strategjive të marketingut;
- Njohuri të mira për programet mbështetëse financiare, siç janë skemat kombëtare, IPARD, Fondet Kombëtare për Bujqësinë etj.
- Aftësi të mira për të punuar në grup dhe nën presion;
- Sistematike dhe organizuar mirë në punën e tij;
- Shkathësi të mira komunikuese me gojë dhe me shkrim;
- Aftësi ndërpersonale dhe organizative;
- Njohuri të mira të Microsoft Office (Outlook, Word, Excel dhe Power Point).

Aplikimi

Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të dërgojnë CV të shoqëruar me letër motivimi në të dyja adresat e e-mailit: dibra@dibra.gov.mk, info@cbs.al dhe ediklobucishta@gmail.com, jo më vonë se afati i sipërpërmendur, me subjekt “5.2.14 Konsulent Individual për hartimin e Planeve të Biznesit për agrobiznese”. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

Nr. 09-500/1
04.06.2018

Kryatari i Komuës
Ruzhdi Lata



A project implemented by:



PANUÇI FLET PAS DY HUMBJEVE ME KOSOVËN DHE UKRAINËN

NUK KISHIM KOKË DHE AS KËMBË, LOJTARËVE U KISHTE MBARUAR BENZINA

"Ndjej keqardhje, sepse kemi humbur. Duhet të presim dy muaj për ndeshjet e tjera, por jam i bindur se, kur të jemi të gjithë bashkë, do të bëjmë një skuadër të mirë dhe do të provojmë të shkojmë në Evropian", pohon Panuçi

Kristian Panuçi e ka braktisur konferencën për shtyp, direkt pas ndeshjes me Ukrainën, i gjendur nën kritikën dhe vërshëllimat e tifozëve kuqezë. Megjithatë, ka bërë një intervistë shteruese të dielën në darkë për kanalin zyrtar të FSHF-së në "Youtube". Aty u jep përgjigje shumë pikëpyetje të ngritura pas tri humbjeve në miqësoret e fundit, ndaj Norvegjisë (1-0), ndaj Kosovës (3-0) dhe ndaj Ukrainës (4-1). Situata duket tejet e nderë në kampin kuqezë dhe e pashpresë, teksa në shtator nisin kualifikueset e Ligës së Kombeve, ku Shqipëria duhet të përballë me Skocinë dhe Izraelin.

-Skuadra nuk funksionon, nuk arrin ta ndezë zjarrin, çfarë nuk shkon?

Panuçi: Asgjë kaq e rëndë dhe kaq katastrofike, sikurse duan që të duket. Kemi zhvilluar dy ndeshje shumë negative, sepse skuadrës i kishte mbaruar benzina. Kishim shumë vështirësi, sepse ne nuk jemi Brazili apo Franca. Jemi pa Bashën, Xhakën, Memushajn, Grezdën, Sadikun. Mavraj ka 5 muaj që nuk luan, Memolla gjithashtu, kishte 5 muaj pa luajtur. Ukraina kishte të gjithë lojtarët e Shaktarit dhe të Dinamos së Kievit, pra kishte tjetër cilësi. Në këto momente, nëse nuk rikuperojmë të gjithë lojtarët e rëndësishëm, vuajmë shumë. Jam mëse i bindur që kur të rikthehen futbollistët e rëndësishëm, ata që fituan në Turqi, ata që zhvilluan ndeshjen kundër Italisë dhe ata që gjuajtën drejt portës së Spanjës plot 15 herë, atëherë do të jemi konkurrues.

-Kombëtarja e dy ndeshjeve të fundit nuk ishte e tillë. Pse duhet të mendojmë që do të përmirësohemi në të ardhmen, kur pas humbjes 3-0 me Kosovën, u mposhtëm 4-1 edhe me Ukrainën?

Panuçi: Sepse skuadra gjithmonë ka bërë mirë, sepse në fund të sezonit lojtarët ishin shumë të lodhur. Kishin pushuar për 15 ditë, pastaj erdhën në kombëtare. Nuk më pëlqen të shfaqësohem, por bateritë kishin rënë plotësisht. Më

vjen keq dhe jam shumë i zhgënjyer dhe i trishtuar si të gjithë shqiptarët, por është e pamundur që kjo të jetë ajo skuadër që fitoi me Turqinë. Kjo është krejt ndryshe, me shumë të rinj. Duhet të provojmë shumë të rinj, të rrezikoja, që të shihja nëse dikush ishte gati për kombëtaren. Në shtator, kur të kthehen të gjithë lojtarët, skuadra do të jetë kompetitive.

-Tre ndeshje, tetë gola të pësuar dhe vetëm një i shënuar. A nuk mendoni se është përkeqësuar shumë gjendja? Si mund të dilet nga kjo situatë?

Panuçi: Skuadra nuk ka bërë mirë në fazën mbrojtëse. Mavraj është një element shumë i rëndësishëm për ne, por në 5 muajt e fundit nuk ka luajtur. Edhe në mesfushë kemi humbur lojtarë të rëndësishëm, ndaj ishim të cenueshëm.

Isha unë i pari, që e dija këtë. Por jam i sigurt që kur të vijmë kualifikueset dhe të kthehen lojtarët, do të bëjmë shumë më mirë.

-Keni ardhur me mendimin për të ndërtuar një skuadër sulmuese, por me ç'shik, nuk kemi asnjë mundësi për të qenë të tillë?

Panuçi: Nuk kishim forcë, nuk kishim këmbë. Nuk kishim mendimin për të sulmuar. Edhe ndaj Ukrainës luajtëm vetëm 20-25 minuta, më pas 'black out' total dhe erdhi goli i parë. Duhet ta pranojmë situatën, duke shpresuar që të na kthehen shumë futbollistë.

-Çfarë do të thotë e kritika e duhur?

Panuçi: Kjo e duhur dhe e ekuilibruar, kur vlerësohen të gjitha situatat. Zhvilluam dy ndeshje negative, por ne nuk kemi 60 lojtarë. Kur na mungojmë vetëm 5-6 futbollistëve, shndërrohemi në një skuadër shumë më pak konkurruese. Ky është realiteti.

-A mendoni akoma që kjo skuadër duhet të luajë në sulm?

Panuçi: Absolutisht po, sepse mendoj se është e drejtë të bëjmë kështu, kur të kthehet Grezda, kur

Agolli është një futbollist 37-vjeçar, që do të thotë se në perspektivë nuk mund të na ndihmojë, ndaj duhet gjetur një zgjidhje tjetër. Pastaj, në katër muajt e fundit, Cikalleshi ka luajtur shumë më tepër se Sadiku. Ishte e drejtë që të thërrisja atë që kishte më shumë minuta në këmbë. Por në ardhmen, nëse do të luajë, do të grumbullohet



Unë bëj punën time me shumë seriozitet, duke qenë i bindur se kam një skuadër të mirë. Konferenca për shtyp ishte e keqorganizuar, sepse ishte vendosur të zhvillohej para tifozëve, që me të drejtë ishin të zemëruar me mua. Profesionalisht, edhe ju të federatës keni gabuar, sepse nuk duhet ta dërgonit aty trajnerin. Duke parë që nuk ishin kushtet e duhura për të vijuar intervistën, u largova

Roshi të jetë mirë, Sadiku të jetë mirë dhe Manaj të jetë mirë. Do të provojmë të luajmë. Në këto dy ndeshje problemi nuk qëndronte te taktika mbrojtëse, apo sulmuese. Nuk kishim as kokën dhe as këmbët.

-Je i trishtuar?

Panuçi: Ndjej keqardhje, sepse kemi humbur. Duhet të presim dy muaj për ndeshjet e tjera, por jam i bindur se, kur të jemi të gjithë bashkë, do të bëjmë një skuadër të mirë dhe do të provojmë të shkojmë në Evropian.

-Gazetarët pretendojnë se ndoshta nuk po merrni përgjigjet e duhura nga skuadra. A ju kuptojnë futbollistët?

Panuçi: Në këto dy ndeshjet e fundit ishte e vështirë, sepse ishin me pushime. Për mua ishte shumë e vështirë t'u ndizja dritën. Nuk ia dola, sepse u kishte mbaruar benzina. Gjithsesi, jam i bindur që skuadra më ndjek dhe se në shtator do të jetë krejt ndryshe.

-Jeni shprehur se lojtarët kanë talent, kanë potencial, por kjo nuk

posihet...

Panuçi: Nuk është se nuk po shihet, por nuk kishim gjysmën e formacionit titullar. Ne jemi ekip kombëtar, por nuk kishim shumë lojtarë të rëndësishëm si Xhaka, Grezda, Memushaj, Basha, pastaj Mavraj ka 5 muaj që nuk luan dhe në nivel ndërkombëtar këto gjëra peshojnë shumë.

-Të gjitha pyetjet lidhen për një mbrojtje me shumë probleme...

Panuçi: Në këto momente kemi shumë problem, sepse mund të bëjmë pak ndërrime. Kemi Ajetin, që nuk luan te Krotone, Veseli ka luajtur një ndeshje në muajin e fundit, Mavraj 5 muaj pa luajtur. Shpresoj që Mavraj të gjejë shumë shpejt një ekip të ri, sepse është shumë i rëndësishëm për ne dhe duhet të luajë.

-Kështu siç po shkojnë gjërat, e ndihesh i rrezikuar?

Panuçi: Për momentin, absolutisht jo, sepse kemi ekuilibrat e duhur për të kuptuar që në nëntor gjërat shkonin mirë, me Norvegjinë, brenda ndeshjes. Nëse mendojmë që duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet, atëherë gabojmë gjithçka. Nëse jemi të gjithë të bashkuar, atëherë mund t'ia dalim. Mund të humbasim, edhe të fitojmë. Nuk e mendoj aspak këtë rrezik, jam shumë i bindur në punën time.

-Si mund të humbasim 4-1 pa marrë një karton të verdhë?

Panuçi: Për këtë i pyeta edhe lojtarët në dhomat e zeshës. Pati shumë pak grintë, sepse lojtarëve iu mungonte forca. Kemi luajtur më mirë me Ukrainën se ndaj Kosovës. Ukraina është shumë më e fortë se Kosova, kjo na bën të kuptojmë shumë gjëra.

-Por diçka mungon kësaj skuadre...

Panuçi: I mungonin 7 lojtarë.

-Jo vetëm për sot...

Panuçi: Përkundrazi, në Turqi kishim "fenomen". Ishim një skuadër e madhe, që luante dhe dëfrente. Tani mungojnë 7 futbollistë nga ajo skuadër. Sot mungon gjithçka.

-Pas miqësore me Kosovën ju u shpreh se mungon "zjarri", futbollistët ndaj Ukrainës ishin më mirë fizikisht...

Panuçi: Jo, vetëm gjysmëorën e parë. Pastaj, skuadra nuk reagoi si duhet në kokë, por ky është një moment i veçantë i sezonit.





Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 158-d, 158-gj dhe 158-e e Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 112/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016 dhe 83/2018), Qeveria e Republikës së Maqedonisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për emërim të tre anëtarëve të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve (dy të angazhuar në mënyrë profesionale dhe një në mënyrë joprofesionale)

- Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë tre anëtarë të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve, dy të angazhuar në mënyrë profesionale dhe një në mënyrë joprofesionale
 - Organi i Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve është Këshilli i ekspertëve.
 - Këshilli i ekspertëve të Agjencisë përbëhet prej pesë anëtarëve prej të cilëve një është kryetar i cili udhëheqë me Agjencinë dhe e përfaqëson gjatë marrëdhënieve me palë të treta.
 - Mandati i anëtarëve të Këshillit të ekspertëve është pesë vjet, me mundësi për rizgjedhje, vetëm se kur ndonjë anëtar i Këshillit të ekspertëve do të ndërpresë të kryejë detyrën para kalimit të mandatit, në emër të tij emërohet person tjetër me mandat deri në kalimin e mandatit të anëtarit që i është ndërprerë kryerja e detyrës.
 - Kryetari dhe së paku dy anëtarë të Këshillit, të cilët në bazë të propozimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, janë të angazhuar në mënyrë profesionale në Agjencinë orar të plotë të punës dhe nuk mund të kenë funksion tjetër dhe të jenë të punësuar në vend tjetër të punës ose të marrin kompensim tjetër përveç pagesës dhe shtesave tjera të pagesës, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe marrëveshjen kolektive, si dhe kompensimeve nga honorarët e kohëpaskohshëm edukativ dhe autorial.
 - Për anëtar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - të ketë të mbaruar arsim sipëror;
 - të jetë ekspert i njohur nga sfera e sigurimeve, financat dhe të drejtën tregtare dhe të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e sigurimeve ose financave;
 - të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vite: TOEFEL IBT – me më së paku 74 pikë; IELTS – me më së paku 6 pikë; ILEC (Cambridge English: Legal) – me më së paku nivelin B2; FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – me më së paku 60 pikë ose Aptis – së paku B2
 - Për anëtar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë nuk mund të emërohet personi:
 - të cilin i është shqiptuar dënim me burg për veprë penale kundër financave publike, kundër qarkullimit të paguar dhe ekonomisë, kundër detyrës zyrtare ose kundër të drejtës;
 - të cilin i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - i cili është anëtar i organit për menaxhim, organit mbikëqyrës ose person i punësuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - i cili është aksionar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave, shoqëri për përfaqësim në sigurime ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - i cili është anëtar i organeve të ndonjë partie politike dhe
 - i cili është deputet ose personi i cili kryen detyrë tjetër ku është emëruar nga Qeveria ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.
 - Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:**
 - biografi të shkurtë;
 - certifikatë të shtetësisë;
 - diplomë për arsim sipëror të mbaruar;
 - dëshmi se është ekspert i njohur nga sfera e sigurimeve, financat dhe të drejtën tregtare dhe të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e sigurimeve ose financave;
 - dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim me burg për veprë penale kundër financave publike, kundër qarkullimit të paguar dhe ekonomisë, kundër detyrës zyrtare ose kundër të drejtës;
 - dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - dëshmi se nuk është funksionar që udhëheqë me organ shtetëror ose organ të administratës shtetërore;
 - dëshmi se nuk është anëtar i organit për menaxhim, organit mbikëqyrës ose person i punësuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - dëshmi se nuk është aksionar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave, shoqëri për përfaqësim në sigurime ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - dëshmi se nuk është anëtar i organeve të ndonjë partie politike dhe
 - dëshmi se nuk është deputet ose personi i cili kryen detyrë tjetër ku është emëruar nga Qeveria ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.
- Anëtarët e Këshillit të ekspertëve të Agjencisë të cilët janë të emëruar në periudhën nga dita e futjes në fuqi të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/2018), gjegjësisht prej 15 maj deri më 1 shtator 2018, obligohen të përmbushin kushtin e njohjes së gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tyre. Anëtarëve të Këshillit të ekspertëve që nuk do të përmbushin kushtin për njohje të gjuhës së huaj brenda afatit të caktuar u ndërpritet mandati.
- 9) Dokumentet nga pika 8 duhet të parashtrorin në original ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat duhet të parashtrorin në Arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup me shenjë "Për shpallje publike për emërim të tre anëtarëve të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve (dy të angazhuar në mënyrë profesionale dhe një në mënyrë joprofesionale)".
- 10) Afati për paraqitjen e kandidatëve të interesuar është pesë ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore, gjegjësisht deri më 11 qershor 2018.
- 11) Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.
- 12) Me publikimin e kësaj shpallje bëhet anulimi i shpalljes për emërim të anëtarit të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve të publikuar në gazetën ditore "Nova Makedonija", "Slloboden Peçat" dhe "Koha" më datë 1.6.2018.



Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për avokatit të shtetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007 dhe 104/2015), ndërsa në lidhje me Vendimin për përcaktimin e numrit të avokatëve të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/2008), Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, ka sjellë

VENDIM

Për publikim të Shpalljes për emërim të avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonin e Shkupit

- Shpallet emërimi i avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonin e Shkupit.
- Për avokat të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonin e Shkupit mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim: të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, të jetë jurist i diplomuar me përvojë pune të çështjeve juridike së paku pesë vjet pas provimit të dhënë të jurisprudencës dhe që të ketë reputacion në kryerjen e funksionit.
- Kandidatët e interesuar të cilët përmbushin kushtet e parapara në nenin 20 të Ligjit për avokatit të shtetit fletëparaqitjen me dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, t'i parashtrorin në arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë Bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup me shenjë "Për shpallje për emërim të avokatit të shtetit në Avokatinë e shtetit të Republikës së Maqedonisë për rajonin e Shkupit", në afat prej 15 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën ditore "Slloboden Peçat", "Nova Makedonija" dhe "Koha".
- Kjo shpallje do të publikohet në: "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në gazetën ditore "Slloboden Peçat", "Nova Makedonija" dhe "Koha".

Nr. 24-5598/1
29 maj 2018
Shkup

ZËVENDËSKRYEMINISTËR I QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Oliver Spasovski

Në bazë të nenit 20g paragrafi 1 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016) nënitet 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013,...21/18) lajmërimin nga Ministria e financave për mjetet e siguruar financiare nr. 18 – 5253 të 29.05.2018, Lajmërimin nga Ministria për mjetet e siguruar financiare nr. 18-6242/2 të datës 29.05.2018 dhe nenit 34 të Statutit të IPKÇF "7-mi Septemvri" Makedonski Brod, Drejtori i publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të dy realizuesve për kohë të pacaktuar për nevojat e IPKÇF "7-mi Septemvri" Makedonski Brod

- Titulli i vendit të punës** – Enëlarës servises – (1) realizues
 - Kushtet e përgjithshme:**
 - Dëshmi për shtetësi
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
 - Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
 - Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
 - Shifra:** DEZ 04 04 A04 001
 - Lloji i arsimit:** Arsim fillor ose të mesëm
 - Përvoja e punës:** me ose pa përvojë pune
 - Pagesa -12.005,00 denarë
- Titulli i vendit të punës** – Person për larje dhe hekurisje – (1) realizues
 - Kushtet e përgjithshme:**
 - Dëshmi për shtetësi
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
 - Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
 - Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
 - Shifra:** DEZ 04 05 A01 005
 - Lloji i arsimit:** Arsim fillor ose të mesëm
 - Përvoja e punës:** me ose pa përvojë pune
 - Pagesa -12.005,00 denarë

Për të gjitha vendet e punës: Orë të punës në javë: 40 orë dhe orari i punës me fillim në ora 07,00 deri në ora 15,00.
- ditët e punës prej ditë së hënë deri ditën e premte.
- afati për paraqitje 5 ditë duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.
- Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
- lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme për përmbushje të kushteve të kërkuara në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, të parashtrorin në arkivin e IPKÇF "7-mi Septemvri" Makedonski Brod, në rr. "Partizanska" nr. 14, Makedonski Brod.
Telefoni për kontakt: 045/274-349,

LAJMËRIM

Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" në Shkup, informon se më datë 13.06.2018 (e mërkurë) në ora 11, kandidati M-r Aleksandra Angellovska do të mbrojë disertacionin e tij të doktoratës në temë:

"Karakteristikat fenomenologjike të abuzimit seksual të fëmijëve me theks të veçantë të masave të parandalimit, trajtimit dhe mbrojtjes"

Mbrojtja do të mbahet në sallën e takimeve në Fakultetin juridik "Justiniani i parë" – Shkup, Bul. "Goce Dellçev" 9b – Shkup (salla për NNS nën dekanatin)

Nga Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" Shkup

Shpallje

Shtet shtëpia në Gazi Babë me sipërfaqe prej 100m2, posedon 4 dhoma, bodrum dhe oborr, e rinovuar në gjendje shumë të mirë, çmimi 52.000 euro me mundësi për marrëveshje kontakt tel. 078-353-988

MODRIÇ E FTON NEJMARIN TE REALI

LE TË SHOHIM SE ÇFARË MUND TË NDODHË!

“Ne po të presim ty”. Kjo shprehje nxitoi të marrë një buzëqeshje nga braziliani Neymar. Më pas futbollisti i Realit të Madridit u pyet më vonë për thashethemet e transferimit dhe sipas “Globo”, u përgjigj: “Le të shohim se çfarë mund të ndodhë!”, ka thënë Modriç



Luka Modriç u shfaq të inkurajojë Nejmarin për t'u bashkuar me të te Real Madridi. Kroati e bëri këtë pas miqësorës së të dielës, midis Brazilit dhe Kroacisë. Neymar ka qenë i lidhur ngushtë me një rikthim në La Liga, te kampionët evropianë, më pak se një vit nga transferimi i tij rekord prej 222 milionë eurosh nga Barcelona te Paris Sen Zhermen. 26-vjeçari luajti një rol kryesor në “Anfield”, në paraqitjen e tij të parë që nga shkurti, duke ardhur nga stoli e shënuar një gol të shkëlqyer në fitoren 2-0 të Brazilit. Më pas, ai u fotografua nga Federata e Futbollit të Brazilit (CBF) duke shkëmbyer fanellën e nënshkruar me mesfushorin e Real Madridit, Luka Modriç, ku dukej se ai nuk mund t'i rezistonte një aluzioni për një transferim në javët e ardhsh-

me. Ndërsa, shkruanin mesazhe dhe shkëmbyen fanellat në tunelin e stadiumit, pas ndeshjes, Modriç mundi të dëgjohej qartë, duke thënë: “Ne po të presim ty”. Kjo shprehje nxitoi të marrë një buzëqeshje nga braziliani Neymar. Më pas futbollisti i Realit të Madridit u pyet më vonë për thashethemet e transferimit dhe sipas “Globo”, u përgjigj: “Le të shohim se çfarë mund

të ndodhë!”. Neymar, gjithashtu, ka refuzuar të tërhiqet nga spekulimet e Real Madridit në fund, me fokusin e tij të mbyllur vetëm te kombëtarja, përpara Kupës së Botës 2018. Ai u tha gazetarëve, kur u pyet: “Fokusi është tani në ekipin kombëtar brazilian. Mediat po shkruajnë pa kuptim, nuk ia vlen të përgjigjemi për këto zëra”, deklaroi Neymar.

“TUTTOSPORT”

Zidan te Juve, Alegri te Reali i Madridit

Real Madridi i ka bërë një ofertë Massimiliano Alegri për të marrë përgjegjësinë e stolit të kampionëve të Evropës. Kjo është ajo që “Tuttosport” thotë në kopertinën e vet të hënën. Kjo media torineze thotë se Florentino Perez e ka kontaktuar trajnerin aktual të Juventusit për t'i përcjellë propozimin e tij. Gazeta në fjalë nuk e konsideron të realizueshme një marrëveshje të tillë, megjithëse nuk e përjashton atë për të ardhmen. Juventus, ndërkohë, do të ishte i interesuar për Zinedin Zidane si trajner, i cili tashmë ka luajtur me bardhezinjtë për pesë sezone, para se të nënshkruante në vitin 2001 për Real Madridin. Allegri ka një kontratë me Juventusin deri në qershor 2020. Ai u ul në stolin e “Zonjës së Vjetër” në sezonin 2014-2015, kur Antonio Conte mori përsipër detyrën e trajnerit të kombëtares së Italisë. Në katër sezonet e tij në stolin e Juventusit, Alegri e ka fituar rregullisht titullin kampion dhe Kupën e Italisë, plus Superkupën e Italisë në sezonin 2015-2016. Në Evropë ka arritur dy herë në finale të Ligës së Kampionëve, në vitin 2015 dhe 2017, kur ranë përballë Barcelonës dhe Real Madridit, respektivisht.

Publicitet

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 pika 7 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare nr. 103/08...67/2017) dhe nenit 71 të Statutit të SHFK “Vasil Gllavinov”, Këshilli i shkollës së SHFK “Vasil Gllavinov” Veles, publikon

SHPALLJE

Për zgjedhje të drejtorit të SHFK “Vasil Gllavinov” Veles

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligjin për marrëdhënie pune, duhet të plotësojnë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional, të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore, të kenë të dhënë provim për drejtor, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe të kenë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Kandidatët për drejtor duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi profesionale (CV)
- program për punë në shkollë për periudhë prej 4 vjet;
- diplomë për arsim të mbaruar sipëror
- certifikatë të shtetësisë
- certifikatë të mjekut
- certifikatë për provim të dhënë për drejtor
- vërtetim për përvojë pune në punë edukativo-arsimore
- Cerifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk u është shqiptuar sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, detyrës ose veprimtarisë
- Vërtetim për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në arkivin e shkollës në adresën Nikolla Karev 2 Veles.

Zgjedhja do të realizohet në afatin e caktuar në nenin 132 të Ligjit për arsim fillor ose më së voni për 45 ditë.

Këshilli i shkollës së
SHFK “Vasil Gllavinov”

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7, ndërsa në lidhje me nenin 128 dhe 132 të Ligjit për arsim fillor, nenit 72 paragrafi 1 alineja 7, nga Statuti i SHF “Gjorgji Sugarev” – Manastir dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Manastirit nr. 08-438/1, Këshilli i shkollës së SHF “Gjorgji Sugarev” – Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të SHF “Gjorgji Sugarev” – Manastir

1. Kandidati për Drejtor të shkollës krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të ketë së paku arsim sipëror dhe të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore;
 - Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore;
 - Të ketë të dhënë provimin për drejtor;
 - Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
2. Me përjashtim, nëse nuk ka të paraqitur kandidat me provim të dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi i cili nuk ka të dhënë provimin për drejtor por obligohet të njëjtin ta japë në afat prej 1 viti nga dita e zgjedhjes për drejtor.
3. Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të paraqesin dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
 - Diplomë për arsim të mbaruar;
 - Vërtetim për përvojë të punës në institucion edukativo arsimor;
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
 - Program për punë për periudhë prej 4 vjet;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

4. Shpallja zgjatë tetë ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor ndërsa zgjedhja do të realizohet në afatet në pajtim me Ligjin për arsim fillor.

5. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme, në original ose kopje të vërtetuara në noter të parashtrihen deri te Këshilli i shkollës së SHF “Gjorgji Sugarev” – Manastir, rr. Dimitar Vllahov nr. 32, Manastir.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.
Tel. 047 222-661.

SHF “Gjorgji Sugarev”
Manastir

Duke vepruar në pajtim me nenin 1 paragrafi 2 të Ligjit për letrat me vlerë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015 dhe 23/2016), nenit 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015), Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë në vijim publikon këtë:

LAJMËRIM

Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë bën dorëzimin e me publikim publik të akteve që nuk ka arritur t'i dorëzojë edhe atë:

1. Vendimi nr. PRK UP 03-31 e datës 28.03.2018 deri te Shoqëria SKENPOINT SHA Shkup me seli në rr. “Pero Nakov” pn, (Kompleksi MZT), 1000 Shkup.

Ftohet personi i lartpërmendur që në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij lajmërimi të paraqitet në lokalet e Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë së dhe të marrë aktin e lartpërmendur.

VËREJTJE: Palët paralajmërohen se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e rregullt, ndërsa secila pasojë që mund të dalë do ta bartë vet pala.

Numër 03-345/1
30.05.2018
Shkup,

Komisioni për letra me vlerë të
Republikës së Maqedonisë
Kryetar
M-p Nora Aliti

Koha <http://www.koha.mk>

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botimit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup

"Ne nuk jemi vetëm futbollistë, jemi edhe baballarë, kemi zakone të ngjashme dhe jemi pothuajse në të njëjtën moshë. Ne gëzojmë dhe argëtohemi, pimë kafe, ndonjëherë edhe hamë së bashku. Kjo ka rezultuar një marrëdhënie e bukur. Dhe me kalimin e kohës, edhe një besim i madh", pohon Suarez

Luis Suarez ka përshëndetur "aftësinë e pabesueshme", që Lionel Messi të mbetet i bazuar në Barcelonë, pavarësisht nga arritjet e tij rekord. Argentinasi ka marrë nderime të panumërta kolektive, por edhe pesë "Topa të Artë" dhe një shifër mahnitëse prej 552 golash të shënuar me skuadrën katalanase. "Leo është kolegu dhe miku im, një person i mirë dhe një njeri i madh familjar, – tha Suarez për "Kicker". – Është një njeri, me të cilin kam shpenzuar katër sezone të paharrueshme. Unë nuk shoh te Messi atë, që pjesa tjetër e botës sheh. Por, ka momente në fushë, edhe me mua, kur e kuptoj atë, se është një futbollist i madh dhe çfarë gjërash të pabesueshme bën", pohon Suarez.

Sulmuesi uruguaiian thotë se

SUAREZ TREGON SI ËSHTË MESSI DHE PSE NEJMAR IKU NGA BARCELONA



ylli argentinasi e ka ndihmuar atë për t'u përshtatur si duhet te Barça, me veprimet brenda dhe jashtë fushës së lojës: "Ne nuk jemi vetëm futbollistë, jemi edhe baballarë, kemi zakone të ngjashme dhe jemi

pothuajse në të njëjtën moshë. Ne gëzojmë dhe argëtohemi, pimë kafe, ndonjëherë edhe hamë së bashku. Kjo ka rezultuar një marrëdhënie e bukur. Dhe me kalimin e kohës, edhe një besim i

madh. Në futboll është e vështirë të gësh një mik të vërtetë, veçanërisht nëse ai luan në të njëjtin pozicion. Ka shumë ego në një skuadër futbollit, por kjo nuk ndodhi kurrë në grupin tonë te

Barcelona. Kjo është provuar gjatë viteve. Ai, gjithashtu, më ndihmoi për të fituar "Këpucën e Artë". Nuk ka xhelozë mes nesh, vetëm krenari për ndarjen e gjërave me një mik", shtoi më tej futbollisti nga Uruguai. Kishte një kohë, kur Suarez dhe Messi u bënë pjesë e një "tridentit" të frikshëm sulmues te Barcelona, me yllin brazilian, Neymar, duke u bashkuar me ta në njësinë shkatërruese, të quajtur "MSN". Megjithatë, ai duhej të largohet për te PSZH në verën e vitit 2017, pasi vendosi të bëhej një transferim rekord botëror prej 222 milionë eurosh. Suarez pretendon se Neymar kishte dyshime nëse ishte duke bërë zgjedhjen e duhur, përpara se të nisej drejt Francës, por 26-vjeçari është mbështetur për të përmbushur potencialin e tij të padyshimtë me kampionët e Ligue 1. "Ne biseduam me të, Messi dhe unë. Neymar na pyeti për mendimin që kishim, – sqaron Suarez. – Ai kishte dyshime. Ishte këtu për një kohë dhe kishte gjithçka, për të cilën kishte nevojë. Unë nuk mendoj se shkoi për paratë te PSZH. Neymar ka synime të tjera, që dëshiron t'i arrijë në Paris", përfundoi Suarez.

Seferi, futbollist i ri i FC Prishtina

Shkup, 6 qershor - Sulmuesi i skuadrës së minifutbollit Shkupi, Erkan Seferi, në të ardhmën do të vesh fanellën e skuadrës së Prishtinës. Seferi do të sjell freski në sulmin e skuadrës së Prishtinës, e cila këtë sezon pretendon që të futet në garë edhe për titullin kampion të Superligës së Kosovës. "FC Prishtina një kohë më të gjatë tashmë dëshiron të më shihte në radhët e saj, dhe ja erdhi momenti që të jemi bashkë. Jam i lumtur që do jem pjesë e një klubi mjaft mirë të organizuar, ku shpresojmë në fund ti arrijmë objektivat", tha Seferi për "infOSport.mk. Shkupjani me FC Prishtinën ka nënshkruar për 6 muaj, ndërsa do të jetë kjo hera e dytë që do të luaj në Superligën e Kosovës, pasi edhe vitin e kaluar luajti me ekipin e Junikut.



Reali edhe pa Ronaldon do të mbetet më i miri në botë



Ish-ylli i Real Madridit, Luis Figo, shprehet se Cristiano Ronaldo do të mbetet në kampionët evropianë. E ardhmja e Ronaldos ka dominuar titujt e mediave, që kur 33-vjeçari ka lënë të kuptohet për një largim nga "Bernabeu", pas triumfit të tretë radhazi në Ligën e Kampionëve, muajin e kaluar. Presë herë fituesi i "Topit të Artë", i cili më pas kërkoi falje për komentet e tij pas përfundimit të finales së Kievit, para se të paraqiste shpresë për të ardhmen e tij gjatë paradës së trofeut në Madrid, është lidhur me një kthim te ish-klubi, Manchester Junajted,

por lidhet edhe me kampionët francezë të PSZH. I pyetur për Ronaldon, pasi ekipi legjendar i Real Madridit mundi Arsenalin në "Santiago Bernabeu", Figo tha: "Unë shpresoj që Cristiano të qëndrojë, siç duan të gjithë tifozët e Real Madridit. Një ditë ai do të ndalet së luajturi, ndërsa Real Madridi do të vazhdojë të jetë një nga klubet më të mira në botë", deklaroi Figo. Ronaldo është duke u përgatitur për Kupën e Botës me Portugalinë, e cila do të përballet me Spanjën (15 qershor), Marokun (20 qershor) dhe Iranin (25 qershor) në Grupin B.

Ish-yllit të Nigerisë i vjedhin 11 mijë dollarë

Fillimi i botërorit pritët të sjelli edhe shumë trazira në Rusi. Por edhe pse duhen e dhe 10 ditë që të startojnë duket se problemet kanë nisur. Ish sulmuesi i Nigerisë, Ajaksit dhe Arsenalit, Nvankwo Kanu, i cili kishte mbërritur në Rusi duke shoqëruar kombëtaren e tij. Kanu sapo ka mbërritur në Rusi i janë vjedhur 11 mijë dollarë. Sipas agjencisë së lajmeve "TAS" kjo ngjarje e shëmtuar ka

ndodhur në Aeroportin e Moskës, ku sulmuesi sapo mbërriti nga udhëtimi në Londër. Kanu e ka kuptuar që i mungonin dollarët kur ka mbërritur në Kaliningrad vendi ku do të zhvillohet ndeshja e parë për ekipin e Nigerisë e cila do të përballet me Kroacinë, më datë 16 qershor. Autoritetet ruse kanë identifikuar dhe ndaluar të dyshuarit dhe dollarët i janë kthyer ish-sulmuesit.



DASHI 21. mars - 20. prill
Po çoni përpara disa strategji shumë interesante të cilat do ju lejojnë që të mbyllni në kohë, disa projekte të rëndësishme. Jini të përqendruar gjatë gjithë kohës, pa lënë mënjanë asnjë detaj. Në dashuri, kjo është një periudhë e mirë, për të bërë zgjedhje të rëndësishme, sidomos nëse keni në plan të hidhni një hap drejt zyrtarizimit të lidhjes.

DEMI 21. prill - 21. maj
Keni nevojë për më shumë aleanca, për të kaluar disa pengesa, të cilat momentalisht po ju mundojnë. Mos u tregoni negativ, pasi kjo sjellje mund t'iu pengojë në gjetjen e zgjidhjeve të vlefshme dhe interesante.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Kjo e hënë do të jetë mjaft e rëndësishme për të mbyllur negociata me rëndësi, të cilat i keni nisur prej kohësh. Jini më kurajoz dhe mos u stepni në avancimin e propozimeve të reja.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Do të jeni mjaft të hutuar dhe kjo për shkak të disa keqkuptimeve në dashuri ose në familje, të cilat nuk do ju lejojnë që të përkushtoheni maksimalisht në projektet e nisura prej pak kohësh. Do të keni disa çështje emergjente, të cilat duhet ti zgjidhni sa më parë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Do të jeni mjaft të shqetësuar, për shkak të disa keqkuptimeve që keni patur kohëve të fundit me familjen. Megjithatë mundohuni që të tregoheni sa më diplomatë dhe të hapur për një ballafaqim, si mënyrë për të gjetur zgjidhje të vlefshme. Mos jini shumë të tërhequr në dashuri.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Këshillohet që të mos humbni durimin dhe sidomos të ndiqni direktivat e eporëve tuaj. Cjatë kësaj dite ka disa projekte të cilat do ju lejojnë që të bëni takime të reja. Në dashuri, mundohuni që të jeni më spontan.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Disa kujtime të së shkuarës, do të rikthehen tek ju, duke ringjallur emocione të forta dhe kjo gjë do ju bëjë melankolik. Ndryshimet e kësaj periudhe nuk ju kënaqin, por duhet të bëni durim.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Duhet të mundoheni që të lini mënjanë të gjitha arsyetimet aspak logjike, sidomos kur flitet për dashurinë. Do të jeni shumë impulsiv, kështu që bëni mirë të kontrolloheni, sidomos në fushën e ndjenjave.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Do të arrini të merrni rezultate të mira në vendin tuaj të punës dhe kjo gjë do ju lejojë që të bëni propozime interesante, edhe sa i takon roleve profesionale me përgjegjësi të madhe. Në dashuri ka ardhur momenti për të vepruar.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Do të jetë një ditë e cila ju fton që të ruani qetësinë, sidomos në momentet ku do të jeni nën trysni. Ky moment sugjeron që të keni më shumë kujdes për veten tuaj dhe formën fizike.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Jeni përfshirë në eksperiencën të reja profesionale, të cilat do ju lejojnë që të lëvroni në horizonte të reja, me qëllim arritjen e objektivave që i keni vendosur vetes. Mundohuni të jeni më të vendosur, në mënyrë që të arrini të realizoni një projekt të ri.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Kjo është një periudhë mjaft e rëndësishme, për të rivlerësuar të gjitha nismat tuaja. Do të arrini të shënoni avantazhe të suksesshme. Mundohuni të mos keni shumë pretendime në dashuri ose në familje.

Mensur Mamuti	LUMË I MADH EVROPIAN VOZË E VOGËL DRURI, TINAR	D	ROMAN I JOSIP RELES	QYTET NË DALMACI	NATRIUMI	AKADEMIKU YNE, ALIU	DITA NDRËKOMBËTARE E EKOLOGJISË (... E ...)	BANOR I ASIRISË	KOHA	BIOGRAFI (SHKURT)
GJUAJTJA ME TOPA									BELGIKA TORBAT	
ARTISTI QË PIKTURON KAFSHË										
KOMPANI SPANJOLLE E MODËS, MASIMO					SAMURAJ JAPONEZ I PERIUDHËS EDO, SHIMADA					
DITËN E EKOLOGJISË E CAKTUAN KOMBET ...					KALIUMI					MISËR I ZIER



FUTBOLLISTI SHQIPTAR, ERVIN	S	AKTORI AMERIKAN, HOK	FUSHA E STUDIMIT	DERIVAT I AMONIAKUT	SKITARJA SUEDEZE, PARSON	TECHNICAL KNOCK OUT NJË PARAFJALË				JO NATYROR, ARTIFICIAL
BANOR I KILIT							HAMBURGER SV			
SLLOGANI I THEMELIMIT TË DITËS EKOLOGJIKE							TITULL I VJETER TURK (SHQ.)			
V										
QYTET NË GRECI						AKTORJA KANADEZE, PEJXH SHUMËSI				
FUTBOLLISTI BOSHNJAK, TRAVANÇIQ					NË SASI TË MADHE					

ZGJIDHJET: D, KANONADA, B, ANIMALISTI, DUTI, ITIRO, E BASHKUVARA, MISK, PJATA, ENAK, D, TA, IS, R, STRA, IO, Ç, S, TKO, KILIAN, HSY, VETËM NJË BOTË, LAMIA, ELEN, ANID, SHUMTË.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

6			4		3			2				9	5				2
	7					5					9		8		4	6	
8			5			7			5			1					9
			3											1	5		9
5	1		7		9		2	8	4	5						7	1
2	3				6		5	9	8		1	7					
		5	2	6				1		2				8		4	
							6			3	8		1				
9			2		7			5	7				6	2	9		

Shumë i lehtë: 695473182, 174928536, 823561794, 489352617, 516749328, 237816459, 352684971, 748195263, 961237845. Mesatar: 386954712, 179283465, 542176398, 267841539, 453629871, 891735624, 625398147, 938417256, 714562983.

Lërinë bebet të bëhen pis!

Higjiena e tepruar tek fëmijët në vitin e parë të jetës, mund të ndikojë në zhvillimin e sëmundjeve të rënda. Sipas studimeve të fundit britanike, lufta e paepur kundër mikrobeve mund të shkaktojë dëme të rënda në organizmin e më të vegjëlve. Instituti i Kërkimeve Kancerogjene në Londër pas shumë studimesh këshillon që duhet lejuar kontakti i bebes me çdo gjë që e rrethon për të stimuluar një zhvillim korrekt të sistemit imunitar. Sipas statistikave, 1 në 2000 fëmijë preket nga leukemia dhe rezultoni se një ndër shkaqet kryesore, është pikërisht higjiena e tepruar. Mjekët që kanë kryer 30 vjet studime mbi fëmijët e sëmurë me leucemi, shpjegojnë se sëmundja ka origjinë në tre faza që ndjekin



njëra tjetrën. E para është një modifikim apo gabim në ADN, që mund të jetë krijuar që në barkun e nënës, më pas është higjiena e tepruar dhe së fundi një infeksion qoftë edhe i thjeshtë, që shkakton shpërthimin e sëmundjes, veçanëri

sht në rastet akute. Pra bebet duhet të prekin edhe mikrobe, të bëhen pis, sepse kështu do të forcohet sistemi i tyre imunitar e do të jenë më të shëndetshëm, pasi njeriu ka lindur në natyrë dhe duhet të vazhdojë të qëndrojë pranë saj.



Vendi që ofron 10 mijë dollarë për të jetuar e punuar

Nëse kërkoni një vend për të punuar dhe i qetë, jashtë zhurmës, atëherë, Vermont në SHBA është një vend perfekt. Së fundi, guvernatori i Vermontit ka bërë të ditur një projekt ku do të ofrojnë 10 mijë dollarë për dy vjet për të jetuar në këtë vend, dhe njëkohësisht edhe për të punuar. Lajmi ka bërë bujë në mediat amerikane, përcjell albinfo.ch. Personat që vendosin të shpërngulen në Vermont do të punojnë nga shtëpia për një punëdhënës jashtë shtetit. Sipas këtij programi që do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshëm, personat që shpërngulen do të ndihmohen edhe në mbulimin e shpenzimeve për lëvizje, jetesë dhe punë. Aktualisht Vermont ka buxhetuar fonde për të mbështetur 100 grante për 3 vitet e para dhe 20 punëtorë shtesë çdo vit që nga ajo kohë. Përfituesit e grantit do të marrin 10.000 dollarë për dy vite. Ky projekt ka nisur për shkak të plakjes së popullsisë në Vermont, derisa edhe vendi është mjaft i bukur, kurse gjithashtu edhe takimet po zvogëlohen.

Zbulohet një test gjaku që identifikon 10 lloje të kancerit

Një analizë e gjakut që identifikon fragmente të ADN-së të lëshuar nga disa tipe kanceri, lejon identifikimin e sëmundjes, ende pa u shfaqur. Kjo është një risi e rëndësishme, që, jo rastësisht, shkencëtarët amerikanë e kanë përkufizuar si 'Graali i shenjtë i kërkimit mbi tumoret' Testi, mund të zhvillohet edhe në Europë brenda pesë viteve.

Rezultatet e studimit u prezantuan në konferencën vjetore të Shoqërisë Amerikane të Onkologëve në Chicago. Në studim morën pjesë 1600 persona, mes të cilëve 749 vetë të shëndetshëm dhe 878 të tjerë të diagnostikuar prej pak kohësh me tumor. "Pjesa më e madhe e tumoreve del në pah kur është në fazë të avancuar, por kjo 'biopsi e lëngshme' na jep mundësinë për ta zbuluar muaj apo vite para se të shfaqen simptomat dhe të diagnostikohet", deklaroi doktori Eric Klein nga qendra e Cleveland. "Shpresojmë që ky test të mund të shpëtojë shumë jetë".

Të diagnostikosh sëmundjen me anë të këtij testi, i cili do të duhet të kushtojë rreth 500-1000 paund dhe jep rezultatin brenda 15 ditëve, jo vetëm që eviton teste të paqarta, por lejon që të kurohet në kohë.



Mot ekstrem me stuhi dhe valë të nxehti



Moti prej disa vitesh ka dalë nga normaliteti, duke na ofruar episode ekstreme si në vere ashtu dhe në dimër. Këshilli Kombëtar i Shkencës në Itali, me anë të një studimi të kryer së fundmi ka

nxjerrë në pah se ngjarjet ekstreme si stuhi, valë të nxehti mbase dhe tornado do të shoqërojnë gjatë kësaj vere gjithë Europën.

Ekspertët thonë se vera ka hyrë me

temperatura të larta, e mbase ajo do të përngjasojë me verën e vitit 2003 që ishte e karakterizuar nga thatësira ekstreme. Europa regjistroi temperatura deri në 35 gradë Celsius këtë fundjavë, ndërsa në disa vende të tjera si Pakistani termometri arriti 50 gradë Celsius e cila konsiderohet vlerë rekord. Masat e ajrit, të ngrohta në njërin anë dhe të ftohtat në anën tjetër, thonë ekspertët italianë, vazhdimisht luftojnë për të fituar terrene kështu shkaktojnë fortunë dhe stuhi.

Ekspertët e klimës mendojnë se përplasja e rrymave të nxehta nga Afrika me rrymat e Atlantikut rrezikojnë të sjellin fundjavën e ardhshme breshër, tornado dhe stuhi, kryesisht në pjesën veriore të Italisë. Por kjo situatë sipas tyre ka të ngjarë të vazhdojë edhe gjatë muajve Korrik dhe Gusht.

70 - Titusi dhe Legjioni i tij romak shkatërrojnë murin e mesëm të Jerusalemit

754 - Friezen vret peshkopin Boniface dhe mbi 50 ithtarë

1257 - Krakov, Poloni merr të drejtat e qytetit

1507 - Anglia dhe Holanda nënshkruajnë marrëveshje tregtare

1827 - Turqit pushtojnë Akropolin dhe marrin Athinën gjatë luftës greke për pavarësi

1870 - Zjarri kaplon Konstantinopolin, vdesin 900 persona

1940 - Organizohet Teatri i Zezakëve Amerikan

1940 - Fillon Beteja e Francës në Luftën e II Botërore

1942 - SHBA u shpall luftë Bullgarisë, Hungarisë dhe Rumanisë

1953 - Senati i SHBA-ve refuzon anëtarësimin e PR kinez në KB

1963 - Gjendje rrethimi shpallet në Iran. Arrestohet Ajatollah Homeini

1972 - Tito viziton BRSS

1991 - Mihael Gërbaçov fiton Çmimin Nobel për Paqe

2003 - Nxehtësi e ashpër kaplon Pakistanin dhe Indinë ku temperatura arrinte 50°C (122°F)

2006 - Serbia shpall pavarësinë nga Unioni Serbi-Mali i Zi.



Frika e fluturimit është quajtur aerofobia dhe tregon terrorin e pakontrolluar në udhëtimin ajror. Kjo është më e përhapur sesa besohet: sipas një sondazhi të kryer nga Eurodap (Shoqata Europiane e Çrregullimeve të Panikut), në Itali kap 6 nga 10 persona. Fakti i të qenit në vakum, mundësia e problemeve mekanike të avionit dhe turbullira janë veçanërisht të frikshme. Për të ulur frikën, terapitë psikologjike të sjelljes dhe kurset e organizuara nga linjat ajrore mund të jenë të dobishme.

ASTRITI

- Kjo është e tmerrshme, - bërtiti mësuesja.

- Ti Astrit fle gjithë orën e mësimit. Nga do të mësosh ti!

- Në ëndërr po shikoja pikërisht një orë mësimi, mësuese!



Tradicionalistët janë pesimistë për të ardhmen dhe optimistë për të shkuarën. (Lewis Mumford)



KALENDARI HISTORIK 5 QERSHOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS